



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 407 Akti

Nr. 519 Vendimi  
Tiranë, më 25.3.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Brunilda Bekteshi** Kryesuese  
**Firdes Shuli** Relatore  
**Suela Zhegu** Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në datën 15.2.2022, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova dhe në datën 24.3.2022, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seance dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Kastriot Gramshi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kastriot Gramshi, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 24.3.2022 kërkoi konfirmimin në detyrë. Referuar çdo prove të administruar gjatë këtij procesi, ky trup gjykues,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në periudhën 1999 - 2003 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pas një shkëputjeje disavjeçare, në vitin 2014 ka filluar të ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë të cilën e ka ushtruar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Ai i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara: (i) nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 26.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Kastriot Gramshi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bektashi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Në datën 10.1.2020, ky vendim i është njoftuar subjektit në rrugë elektronike dhe në datën 13.1.2020 konfirmoi marrjen e e-mail-it, duke u shprehur se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 20.1.2022, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit administrativ dhe me provat e administruara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kastriot Gramshi; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur

shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**6.** Në datën 20.1.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 3.2.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

**7.** Në datën 2.2.2022, përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrje afati për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, pasi ishte në pritje të informacionit të nevojshëm nga SHBA-ja.

**8.** Me vendimin numër 3 të datës 2.2.2022, trupi gjykues vendosi pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe shtyrjen e afatit të depozitimit të parashtrimeve deri në datën 10.2.2022, brenda orarit zyrtar, duke pasur të drejtën për të paraqitur çdo provë e parashtrim edhe në ditën e seancës dëgjimore.

**9.** Në datën 10.2.2022, subjekti i rivlerësimit, pasi ishte njohur me aktet e dosjes në datën 24.1.2022, dërgoi me anë të postës shpjegimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ.

**10.** Me vendimin nr. 4, date 11.2.2022 trupi gjykues vendosi kalimin e çeshtjes ne seancë dëgjimore në datë 15.02.2022, vendim i cili iu njoftua subjektit po ne kete date.

**11.** Në datën 15.2.2022, u zhvillua seanca e parë dëgjimore në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

**12.** Pas zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 15.2.2022, nga ana e trupit gjykues u pa e nevojshme të bëhen hetime administrative shtesë në lidhje me kriterin pasuror. Me vendim nr. 5, datë 18.2.2022, Komisioni vendosi riçeljen e hetimit administrativ për kriterin pasuror.

**13.** Në datën 23.3.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë, si dhe kalimin në seancë dëgjimore në datën 24.3.2022. Në datën 24.3.2022, u zhvillua seanca e dyte dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

**14.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces administrativ kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**15.** Parashikimet e pikës 2, të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në nenin 4, pika 5 dhe nenin 52, pika 1, të tij, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit sipas parimeve thelbësore që përfaqësojnë elementet e një procesi sa më objektiv mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**16.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr.84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse të vlerësimit të këtyre aftësive.

**17.** Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi për subjektin e rivlerësimit Kastriot Gramshi, që nuk është bazuar dhe as ka qenë ndikuar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

#### **Vlerësimi i pasurisë**

**18.** Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 28.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2014, me nr.indeksi \*\*\* dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private 2014 dhe në vijim.

**19.** ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Kastriot Gramshi, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**20.** Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shpresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative; (v) sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar sipas nenit 49 pika 11, të ligjit nr. 84/2016.

**21.** Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën Vetting; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarinimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarinimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

## **Pasuria e parë e paluajtshme e deklaruar në deklaratën Vetting**

**22.** Në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar: “Apartament me sip. 63.50 m<sup>2</sup>, Njësia Administrative \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, godina \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Blerë në datën 7.6.2016. Çmimi i blerjes: 48.000 euro (dyzet e tetë mijë). Pjesa: 50 %. Burimi i krijimit: kursime të akumuluar para emërimit si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 10.7.2014”. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar se është i paqartë burimi financiar i babait të subjektit për shumën e paguar prej 35.000 euro për blerjen e apartamentit në Tiranë në vitin 2016, si dhe mungesë e dokumentacionit justifikues ligjor.

## **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**23.** Në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë dhe statusin aktual të saj, nga aktet<sup>1</sup> në dosje rezultoi se:

- Sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 6.7.2016, shtetasit Kastriot Gramshi dhe Gj. G., kanë blerë nga shtetasit K.T. dhe R.T. një apartament me sip. 63.50 m<sup>2</sup> me adresë: rruga “\*\*\*\*”, godina \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, në vlerën 48.000 euro.

- Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar blerjen e apartamentit në shumën 48.000 euro dhe pjesën takuese 50%, burimin e krijimit, si dhe pagesën për tatimin e shitblerjes së këtij apartamenti në shumën 2.500 USD, të deklaruara, gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

- Sipas certifikatës së pronësisë, lëshuar në datën 18.7.2016, pasuria nr. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 63.50 m<sup>2</sup>, figuron në pronësi të shtetasve Kastriot Gramshi dhe Gj.G. në pjesë secili ½, fakt i konfirmuar edhe ASHK-ja<sup>2</sup>.

- FSHU-ja<sup>3</sup> ka konfirmuar kontratë të energjisë elektrike në emër të abonentit Kastriot Gj. Gramshi, ashtu sikurse konfirmohet dhe vërtetohet edhe në shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

- UKT-ja<sup>4</sup> konfirmon kontratë për furnizimin me ujë në emër të shtetasit Kastriot Gj. Gramshi, ashtu sikurse konfirmohet dhe vërtetohet edhe në shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

**24.** Në lidhje investime të kryera në këtë pasuri, u evidentua se:

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë apartament nga data 1.10.2017 dhe në vijim, si dhe faktin se ka kryer me leje nga organet kompetente ligjore rikostruksionin e apartamentit gjatë viteve 2016 – 2018, në vlerën totale prej 3.009.413 lekësh, duke specifikuar se për pjesën e tij takuese shpenzimet janë në vlerën 22.000 USD. Për të vërtetuar këtë deklaram, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se shuma prej 3.009.413 lekësh është paguar sipas ecurisë së punimeve, gjatë viteve 2017 dhe 2018. Gjithashtu, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar aplikimin për leje kryerje punimesh, pajisjen me leje, si dhe pagesat e vlerës së investimit përkatësisht prej tij dhe babait Gj.G.

<sup>1</sup>Shihni aktet në Aneksin \*\*\* dhe dokumentet bashkëngjitur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirane Jug, në dosjen e Komisionit.

<sup>2</sup>Shihni shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tirane Jug dhe dokumentet bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit dhe aneks \*\*\* në dosjen ILDKPKI-së.

<sup>3</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2020 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2021, të FSHU-së në dosjen e Komisionit, si dhe dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2.

<sup>4</sup>Shihni shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2020, shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, të UKT-së, në dosjen e Komisionit dhe dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2.

- Pranë Komisionit është administruar një denoncim nga shtetasi K.G., i cili pretendon se subjekti ka kryer ndërtim pa leje, pasi sipas tij, nga krahasimi i *ortofoto* të vitit 2015 me atë të vitit 2018, duket qartë ndryshimi në vëllim dhe në sipërfaqe, çka bën të supozosh se sipërfaqja reale e apartamentit është 100 m<sup>2</sup>, pasi është ndërhyrë në fasadë, duke realizuar ballkone të cilat sipas tij janë ndërtime pa leje.

- Duke marrë shkas nga ky denoncim, edhe pse kërkesa për kryerje punimesh në apartamentin objekt verifikimi është miratuar në datën 8.3.2017, ndërsa punimet e rikonstruksionit kanë përfunduar në datën 31.8.2018, pra, pas deklaratës *Vetting*, me qëllim vërtetimin e legjitimitetit të subjektit në kryerjen e punimeve, si dhe kryerjes së investimeve të mundshme përpara përpilimit të deklaratës *Vetting*, në vijim të hetimit administrativ, u pyet disa herë subjekti në lidhje me llojin e punimeve të kryera në këtë apartament, aplikimin e kërkesës për marrjen e lejes së nevojshme për këtë qëllim, etj.

**25.** Në analizë të deklaratimeve dhe dokumenteve shkresore të paraqitur prej subjektit në përgjigje të pyetësorëve 1, 2, 3 dhe 5, në mënyrë të përmbledhur u evidentuan faktet e rrethanat si vijojnë:

**25.1.** Në lidhje me lejimin për kryerjen e punimeve, u vërtetua se:

- Sipas shkresës kthim përgjigje për kryerje punimesh nr. \*\*\*, datë 8.3.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tiranë, ky institucion ka pranuar kërkesën e subjektit për kryerje punimesh në pasurinë apartament.

- Subjekti është pajisur me leje nr. \*\*\*, datë 8.3.2017, të DPPZHT-së nga Bashkia Tiranë, bazuar në kërkesën me nr. aplikimi \*\*\*, që sipas deklaratimeve në përgjigje të pyetësorit nr. 5, është bërë nga inxhinierja E.M., e cila është marrë me procedurat e nxjerrjes së lejes. Edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se marrja e lejes së sipërcituar është kthim përgjigje e kërkesës të dorëzuar elektronikisht me numër \*\*\*, por, sipas *e-mail*-it nga *elejet.info*, bashkëlidhur këtij pyetësori, rezultoi se subjekti kishte bërë kërkesë/deklaratë paraprake për kryerje punimesh me nr. aplikimi \*\*\*, datë 25.2.2017, pranë Bashkisë Tiranë. Siç vërehet, ka një mospërputhje në numrin e aplikimit, për të cilin subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara dhe ka paraqitur dokumente shkresore në parashtrimet e tij, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ (trajtuar në vlerësimin e parashtrimeve në paragrafin 35 të këtij vendimi).

- Me deklaratat<sup>5</sup> e gjashtë banorëve të pallatit, të nënshkruara në fillim të vitit 2017, konfirmohet se nuk kanë pasur asnjë kundërshtim për punimet që do të kryhen në apartamentin me nr. pasurie \*\*\*, në pronësi të shtetasve Gj. dhe Kastriot Gramshi. Nga përmbajtja e këtyre deklaratave, evidentohet se janë specifikuar llojet e punimeve, midis tyre edhe riparimi i ballkoneve, si dhe është shprehur qartë dhënia e aprovimit të secilit prej banorëve për kërkesën e bërë në Bashkinë Tiranë, nga shtetasit Kastriot dhe Gj.G.

- Punimet janë kryer nga zbatuesi i punimeve ing. K.H., me të cilin subjekti ka lidhur kontratë në datën 25.5.2017, ku përcaktohet se punimet do të kryhen në përputhje me lejen Nr. \*\*\*, datë 8.3.2017, të lëshuar nga Bashkia Tiranë.

---

<sup>5</sup>Shihni dokumentet në përgjigje të pyetësorit nr. 5: planvendosjen e apartamentit dhe kopje deklaratash jo noteriale, të shtetasve: G.A. nënshkruar në datën 3.1.2017; A.J. nënshkruar në datën 29.1.2017; A.B. nënshkruar në datën 31.1.2017; A.Q. nënshkruar në datën 2.1.2017; K.G. nënshkruar në datën 1.2.2017; A.B. nënshkruar në datën 3.2.2017.

- Në datën 31.1.2018, është mbajtur procesverbal mbi marrjen në dorëzim të punimeve të kryera nga ing. K.H., ku përcaktohet qartë se punimet janë kryer komfor neneve 6 dhe 7, të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 dhe lejen Nr. \*\*\*, datë 8.3.2017, nga Bashkia Tiranë.

- Sipas situacionit të punimeve, për periudhën 1.6.2017 – 31.1.2018, të përpiluar nga ing. K.H., vlera e punimeve është 3.009.413 lekë.

**25.2.** Në lidhje me periudhat e kryerjes së investimeve për rikonstruksion dhe kontributin e secilit bashkëpronar, u vërtetuan deklaratimet e subjektit sipas të cilit: (i) vlera e investimeve prej 3.009.413 lekësh është paguar në vitet 2017 dhe 2018; (ii) shuma 22.000 USD është paguar prej subjektit, ndërsa shuma 10.000 USD është paguar nga babai i tij. Konkretisht:

- Në DPV-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar punime/arredimi në vlerën 15.000 USD, ndërsa në DPV-në e vitit 2018 ka deklaruar pagesë punimesh në vlerën 7.000 USD, pra, në total 22.000 euro.

- Nga të dhënat bankare pranë “Tirana Bank”, rezultuan të sakta deklaratimet e subjektit në pyetësin nr. 2, për pagimin në rrugë bankare të shumës prej 10.200 USD në vitin 2017 dhe shumës 7.000 USD në vitin 2018, pra, në total prej 17.200 USD, me burim kursime/gjendje në llogarinë e subjektit në SHBA. Sa i takon pjesës së mbetur në shumën prej 4.800 USD, subjekti deklaroi se është paguar *cash* me të ardhura nga qiraja e akumuluar e pasurisë në SHBA, nga 2015 - gusht 2016 (të ardhurat nga qiratë janë trajtuar hollësisht në paragrafin 80-88).

- Sa i takon shumës prej 10.000 USD të paguar nga babai i subjektit dhe burimin e krijimit të kësaj shume, në pyetësin standard dhe pyetësin nr. 5, subjekti ka dhënë shpjegime, sipas të cilave kjo shume është tërhequr nga babai Gj.G., prej një llogarie në emër të babait dhe vëllait K.G. në “Raiffeisen Bank” (në fakt llogaria është në emër të shtetasit K.G.). Nga verifikimet e lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank”<sup>6</sup>, rezulton se deklaratimet e subjektit janë të sakta dhe se babai i tij ka tërhequr në 5 pjesë shumën në total prej 10.000 SHBA, gjatë muajve korrik - gusht 2017, periudhë e cila përkon me një pjesë të faturave të lëshuara dhe të paguara për rikonstruksionin e apartamentit. Balancat e llogarisë në emër të shtetasit K.G. në “Raiffeisen Bank”, janë përfshirë si likuiditet/pasuri e krijuar nga subjekti dhe familja në SHBA, në analizën financiare të tyre për periudhën e qëndrimit në Amerikë.

**26.** Në lidhje me trajtime të mundshme preferenciale në blerjen e pasurisë, sipas udhëzimit nr.4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2016”, për zonën \*\*\* ku ndodhet apartamenti, çmimi në tregun e lirë për periudhën 30.9.2015 – 28.12.2016, është 131.700 lekë/m<sup>2</sup>. Pra, referuar çmimit referencës, apartamenti i blerë do të kushtonte  $63.5 \text{ m}^2 \times 131.700 \text{ m}^2 = 8.362.950 \text{ lekë}$  ose 61.824 euro<sup>7</sup>, ndërkohë që është blerë në vlerën 48.000 euro. Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk ka konfirmuar<sup>8</sup> gjykime nga ana e subjektit të çështjeve civile me palë pjesëmarrëse, shitësit e pasurisë K.T. dhe R.T. Sa i takon këtij konstatimi, subjektit i janë kërkuar sqarime me njoftimin e rezultateve të hetimit (trajtuar në paragrafin 37 të këtij vendimi).

**27.** Në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit të blerjes së pasurisë prej 48.000 euro, nga të dhënat bankare<sup>9</sup> rezultoi se në datën 8.7.2016 janë bërë transfertat me përshkrim për noteren N.Gj., përkatësisht në shumat 13.000 euro nga subjekti dhe 35.000 euro nga babai i tij Gj.G.

<sup>6</sup>Shkresë \*\*\* prot., datë 29.10.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>7</sup>Kursi i këmbimit 1euro = 135.27 lekë, Banka e Shqipërisë, në datën 31.12.2016.

<sup>8</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

<sup>9</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, të “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit.

Bashkëngjitur kontratës së blerjes të apartamentit nr. 3225/692, datë 6.7.2016, ndodhen dhe dokumentet bankarë të “Tirana Bank”, që vërtetojnë transfertat përkatëse<sup>10</sup>.

**28.** Për të dyja shumat pjesë përbërëse të çmimit të shitjes, nga Komisioni u vërtetua origjina e krijimit të tyre, përkatësisht si vijon:

**28.1.** Duke ndjekur origjinën e shumës prej 13.000 euro paguar nga subjekti, u evidentua se ajo e ka zanafillën te depozitimi në *cash* prej tij, i shumës 15.000 USD, në “Tirana Bank”, në datën 7.1.2003. Kjo shumë është investuar dhe riinvestuar në depozitë me afat deri në datën 7.7.2016, kur është maturuar shuma 17.301,66 SHBA. Në DPDFD, dorëzuar në datën 8.8.2014, subjekti deklaruar ka: *“Depozitë ‘Tirana Bank’, dega Shkodër, krijuar në prill të vitit 2003 (ne fakt është në janar) dhe gjendje në datën 10.7.2014, shuma 17.500 USD. Burimi: të ardhura nga paga dhe dhuratë nga prindërit 12.000 USD”*.

- Në datën 8.7.2016, shuma prej 14.430 USD është këmbyer duke u përftuar shuma 13.000 euro<sup>11</sup>, e cila është transferuar fillimisht në një llogari në euro të subjektit dhe në të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në llogarinë e noterit si pagesë për blerjen e apartamentit.

**28.2.** Duke ndjekur origjinën e shumës prej 35.000 euro paguar nga babai i subjektit, u evidentua se ajo e ka zanafillën te disa depozitime *cash* të tij në “Tirana Bank”, të cilat fillojnë qysh në tetor të vitit 2002 dhe vazhdojnë deri në shtator të vitit 2003, duke arritur shumën ~ 60.500 USD. Kjo shumë është investuar dhe riinvestuar në depozita me afat dhe në këtë llogari ka pasur tërheqje dhe depozitime deri sa gjendja e llogarisë në datën 7.8.2016 është bërë 39.833,13 USD. Në këtë datë, pasi shuma 38.850 USD është tërhequr, është këmbyer duke u përftuar shuma 35.000 euro<sup>12</sup>, e cila është transferuar në llogarinë e noterit që ka kryer shitjen e pasurisë. Nga lëvizjet e llogarisë në dollarë të z. Gj.G. në “Tirana Bank”, janë evidentuar veprimet të cilat lidhen me krijimin e shumës 35.000 euro, duke filluar që nga depozitimi i parë. Nga këto veprime ka rezultuar se:

i) Shuma 27.500 USD e depozituar në datën 8.8.2003 rrjedh nga depozita prej 3.259.484 lekë e maturuar, e tërhequr dhe e këmbyer në dollarë, në të njëjtën datë nga Gj.G. në ish-Bankën e Kursimeve. Kjo shumë evidentohet të jetë depozituar gjatë viteve 1997-1998, te Banka e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”)<sup>13</sup> dhe kjo shumë e ka origjinën nga interesat e shumave të investuara deri në fund të vitit 1996 në Bankën Tregtare Agrare.

ii) Shuma prej 27.500 USD, pasi depozitohet te “Tirana Bank”, investohet në depozitë me afat, nga viti 2003 deri në vitin 2013. Në datën 6.9.2013 shtohet shuma 6.000 USD dhe të dyja shumat së bashku investohen dhe riinvestohen deri në korrik të vitit 2016. Në datën 8.7.2016, depozita me afat maturohet së bashku me interesat duke u përftuar shuma prej 38.850 USD. Shuma 6.000 USD, e depozituar nga babai i subjektit në vitin 2013, është përfshirë në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij për periudhën e jetesës në SHBA, para fillimit të detyrës në datën 10.7.2014.

### **Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 48.000 euro**

**29.** Komisioni verifikoi burimin e krijimit të shumës 35.000 euro paguar për blerjen e apartamentit në datën 8.7.2016 nga ana e babait të subjektit Gj.G., duke kryer veprimet hetimore si vijojnë:

<sup>10</sup>Shihni dy mandate transferte nga “Tirana Bank”, në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup>Kursi i këmbimit të përdorur nga banka është 1 USD = 1.11 euro, i cili evidentohet në përshkrimin e transaksionit.

<sup>12</sup>Kursi i këmbimit të përdorur nga banka është 1 USD = 1.11 euro, i cili evidentohet në përshkrimin e transaksionit.

<sup>13</sup>Shihni shkesën nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, nga “Raiffeisen Bank”, paraqitur nga subjekti me përgjigjen e pyetjes 1/1, të pyetësorit nr. 2.



**29.1.** U pyet subjekti, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se *kjo shumë (së bashku me 12.000 euro të dhuruara nga babai në vitin 2003) janë të ardhura të babait të akumuluar nga viti 1992 nga ushtrimi i aktivitetit privat “\*\*\*\*” sh.p.k. me objekt tregtimi i karburanteve dhe nënprodukteve të tyre, deri në vitin 2010 kur i ka dhuruar 100 % aksionet K.G. (vëllai i subjektit) dhe një pjesë e interesave bankare nga investimet në depozita bankare, Banka Tregtare Agrare në shumën afërsisht 3.5 milion në vitin 1996 dhe Banka e Kursimeve nga viti 1997 –2003 në shumën 3.259.484 lekë.. Në janar të vitit 2003, janë depozituar të gjitha kursimet e babait pranë “Tirana Bank”, në vlerën 60.592 USD deri më 8.9.2003, të investuara vazhdimisht në depozita me afat deri në datën 8.7.2016, kur shuma prej 39.800 USD është tërhequr, është këmbyer në euro dhe shuma 35.000 euro është transferuar në llogarinë e shitësit.*

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentet shkresore si vijojnë:

- dokumentacion mbi aktivitetin tregtar të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për vitet 1992 – 2010<sup>14</sup>;
- kopje të dokumentit “pasqyrë e llogaritjes së interesave”, nga Banka Tregtare Agrare për z.Gj.G., për vitet 1995 dhe 1996, nga të cilat ka rezultuar se interesat e përfituara për vitin 1995 janë në vlerën 154.927 lekë dhe për vitin 1996 janë në vlerën 3.255.547 lekë;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2021, nga ISSh-ja Shkodër, mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të Gj.G., për periudhën qershor 1994 – shtator 2010<sup>15</sup>;
- shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, të “Raiffeisen Bank”, e cila informon për depozitat e Gj.G. nga 14.2.1997 – 8.8.2003. Sipas kësaj shkrese informohemi se “Raiffeisen Bank” nuk ka informacion për depozitat e Bankës Tregtare Agrare, pasi kjo bankë i është bashkuar ish-Bankës së Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), në vitin 1997;
- librezë e llogarisë së kursimit të babait të “Tirana Bank”, e cila është çelur në datën 8.10.2002 dhe tregon lëvizjet e llogarisë deri në datën e tërheqjes së saj në datën 8.7.2016, bashkë me librezën respektive nga viti 2003;
- kopje të një depozite me afat 8-mujor, ku shuma 60.592,85 USD është investuar nga 24.1.2003 – 24.9.2003.

**29.2.** Duke qenë se depozitat bankare të babait të subjektit kanë prodhuar interesa në shuma të konsiderueshme, në mungesë të të dhënave për vlerat e tyre, iu kërkua informacion subjektit për vitet 1995-1996 dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar: *“Me sa mbaj mend, në fund të vitit 1996 babai Gj.G. ka patur shumën 20.000.000 lekë. Për shkak të pasigurisë së sistemit, pas vitit 1997, babai ka tërhequr depozitat pranë Bankës Tregtare Agrare duke i depozituar pjesërisht pranë ‘Raiffeisen Bank’, një pjesë është shfrytëzuar për vijimin e aktivitetit/biznesit dhe pjesa tjetër është mbajtur në cash”.* Subjekti ka paraqitur dokumentin *“raporti vjetor 1996 i Bankës së Shqipërisë”*, në të cilin janë pasqyruar përqindjet e interesit të depozitave<sup>16</sup> për vitet 1993 – 1996.

**29.3.** Në analizë të dokumenteve shkresore, evidentohet se: (i) babai i subjektit Gj.G. ka ushtruar aktivitet tregtar për artikuj të ndryshëm import-eksport nga data 17.9.1992 dhe në

<sup>14</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, f. 2-162, në dosjen e Komisionit: vendim i Gjykatës së Rrethit Shkodër nr.\*\*\* regj., datë 17.9.1992, për regjistrimin e Gj.G., akt themelimi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me ortak Gj.G. dhe K.G.; vendim nr. \*\*\* , datë 17.5.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e personit juridik “\*\*\*\*” sh.p.k.; licenca; ekstraktin e QKB-së të printuar në datën 28.9.2021, për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.; prokurë e posaçme nr. \*\*\* , datë 5.9.2003, ku Gj.G. cakton si përfaqësues të tij në lidhje vetëm me firmën private “\*\*\*\*” sh.p.k.; vendimin nr. \*\*\* , datë 2.9.2010, të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për dhurimin e aksioneve K.G.; bilancet e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për vitet 2007 – 2013 dhe 2015 – 2020, vendime të asamblesë së ortakëve; dokumentet për sigurimet shoqërore të shtetasit Gj.G. periudha 1994-2010.

<sup>15</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, f. 143-144, në dosjen e Komisionit.

<sup>16</sup>Shihni faqen 18 të këtij dokumenti.

vijim. Nga data 17.5.1994, e ka ndryshuar emërtimin e aktivitetit të tij, në shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., duke ndryshuar objektin e veprimtarisë në “tregtim të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre”, në të cilën ka qenë administrator dhe ortak së bashku me djalin e tij K.G. me 50% të aksioneve secili; (ii) nisur nga interesat e paguara, babai i subjektit ka pasur depozita në shuma të konsiderueshme qysh në vitin 1995, përderisa në këtë vit është dokumenti i parë që tregon se ka marrë interesa nga Banka Tregtare Agrare.

**29.4.** Nga faqja zyrtare e QKB-së është evidentuar se nga data 17.5.1994, shtetasit Gj. dhe K.G. kanë qenë ortakë me pjesë të barabartë kuotash 50% secili, te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe se në datën 2.9.2010, Gj.G. e ka dhuruar pjesën e tij të aksioneve tek djali i tij, vëllai i subjektit K.G., i cili është bërë aksioner i vetëm me 100% të aksioneve, të drejtë të cilën vazhdon ta ushtrojë deri sot<sup>17</sup>.

**29.5.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, DRT-ja Shkodër, ka informuar se tatimpaguesi “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, i regjistruar në datën 1.7.1996, ka të dhëna mbi qarkullimin, fitimin dhe shpërndarjen e dividendit, duke filluar nga 2000 – 2020. Nga të dhënat e përcjella me këtë shkresë, evidentohet se nuk ka informacion mbi aktivitetin financiar të këtij biznesi qysh nga krijimi i tij, pra, nga data 17.5.1994 dhe deri në fund të vitit 1999, ashtu sikurse nuk ka të dhëna të aktivitetit tregtar “artikuj të ndryshëm import-eksport” i regjistruar nga data 17.9.1992. Ndërsa, DRT-ja Shkodër, nëpërmjet dy shkresave të tjera, informon se nuk disponohen të dhëna dhe dokumentacion për tatimpaguesin “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhat më të hershme se viti 2000<sup>18</sup>.

**29.6.** Për efekt të analizës financiare, subjekti është pyetur për pasuri të tjera të prindërve të tij dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se babai i tij ka në pronësi pasuritë si vijojnë: (i) banesë me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 1659 m<sup>2</sup> (deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*); (ii) pasurinë nr. \*\*\*, sip. totale 835 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 200 m<sup>2</sup> truall, ndërtesë 90 m<sup>2</sup>, ndodhur në M\*\*\*, Shkodër, të shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.8.2019, në vlerën 33.271 USD<sup>19</sup>, për të cilën, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se ka qene pikë karburanti. Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti ka paraqitur disa dokumente<sup>20</sup> nga të cilat duket se babait të subjektit i është dhënë në pronësi ish-SMT, në D\*\*\*, Shkodër dhe se ka ndërtuar mbi këtë pronë një pikë karburanti qysh në vitin 1994, pra, para se babai i subjekti të krijonte depozitat të cilat kanë shërbyer për krijimin e depozitave nga të cilat rrjedh shuma 35.000 euro.

**29.7.** Nga të gjitha sa më sipër, në lidhje me të ardhurat e babait të subjektit Gj.G., rezultoi se shtetasi Gj.G. ka pasur të ardhura për të krijuar shumën prej 35.000 euro, për të kryer pagesën e apartamentit në vitin 2016, pasi, referuar përlllogaritjeve të shumave të depozituara në bankë prej tij gjatë viteve 1995-1996, bazuar në interesat e përfituara dhe normat e interesit të BSH, depozitat e tij në fund të vitit 1996 kanë qenë rreth 20.000.000 lekë/rreth 154.000 USD<sup>21</sup>, sikurse është deklaruar nga subjekti, ndërsa interesat e përfituara në fund të vitit 1996, sipas dokumenteve bankare kanë qenë në vlerën 3.255.547 lekë ose 25.099 USD, duke u përftuar kështu një shumë totale prej rreth 179.000 USD<sup>22</sup>, të cilën babai i subjektit duket ta këtë

<sup>17</sup>Shih ekstraktin historik të kësaj shoqërie në site e QKB: file:///C:/Users/User/Downloads/EkstraktHistorik-11\_1\_2021.pdf

<sup>18</sup>Shih shkresat nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2021, në përgjigje të pyetësorit 3 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2021, të DRT-së Shkodër, drejtuar Komisionit.

<sup>19</sup>DPPPP-ja ka informuar për kontratën nr. \*\*\*, datë 8.8.2019, në vlerën 33.271 USD, e llojit pentore+truall+ndërtesë, me blerës F. N. dhe shitës Gj. N.

<sup>20</sup>Shih dokumentet bashkangjitur përgjigjes së pyetjen 2, te pyetësori nr. 3

<sup>21</sup> Për shkak të fluktacionit shumë të lartë të monedhës USD në ato vite është përdorur kursi mesatar për vitet 1995-2000, 1 USD = 129.71 lekë, Banka e Shqipërisë

<sup>22</sup>Lloji i investimit në këto depozita është pa kapitalizim të interesit dhe vetëm principal ka qenë 154.000 USD.

disponuar në fund të vitit 1996 dhe ta ketë përdorur për të krijuar depozitat gjatë viteve 2002-2003, në total në shumën 60.500 USD, pjesë e së cilës është shuma prej 35.000 euro, që ka shërbyer për pagesën e apartamentit në vitin 2016. Por, duke qenë se nuk u vërtetuan të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, nga biznesi “\*\*\*” sh.p.k., shuma 35.000 euro e paguar nga babai i subjektit për blerjen e apartamentit, nuk është konsideruar si e ardhur me burime të ligjshme në analizën financiare të njoftuar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

**30.** Komisioni verifikoi burimin e krijimit të shumës 13.000 euro paguar për blerjen e apartamentit në datën 8.7.2016 nga ana e subjektit, si vijon:

**31.1** Kjo shumë e ka zanafillën të depozitimi në *cash* prej subjektit të shumës 15.000 USD në “Tirana Bank” në datën 7.1.2003.

**31.2.** Në DPPD-në, dorëzuar në datën 8.8.2014, subjekti ka deklaruar “*depozitë ‘Tirana Bank’, dega Shkodër, krijuar në prill 2003 (në fakt është në janar) dhe gjendje në datën 10.7.2014, shuma 17.500 USD. Burimi: të ardhura nga paga dhe dhuratë nga prindërit 12.000 USD*”. Sa i takon burimit të shumës 12.000 USD dhuruar nga babai në vitin 2003, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kjo shumë vjen nga të ardhura të babait të akumuluar nga viti 1992 prej biznesit, duke i unifikuar burimet në deklaratimet e tij, si për shumën 12.000 USD të dhuruar nga babai i tij, ashtu edhe për depozitimet e këtij të fundit për krijimin e shumës 35.000 euro, çështje e trajtuar më lart.

**31.3.** Bazuar në sa është arsyetuar më sipër, duke qenë se nuk janë vërtetuar të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore nga ana e babait të subjektit, shuma e dhuruar prej 12.000 USD, nuk u konsiderua me të ardhura të ligjshme. Ndërkohë, sa i takon krijimit të pjesës tjetër të depozitës në vlerën prej 3.000 USD, nga analiza financiare për periudhën nëntor 1999 – dhjetor 2002, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga pagat e tij për të krijuar këtë shumë.

### **Barra e provës që i ka kaluar subjektit të rivlerësimit**

**32.** Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/216, subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me pasurinë apartament me sip. 63.5 m<sup>2</sup>, Tiranë, për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, duket se: (i) nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme shuma 13.000 euro paguar nga subjekti; (ii) nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme shuma 35.000 euro paguar nga babai i subjektit; (iii) mbetet e paqarte kur është paraqitur kërkesa nga ana e subjektit në bashki për kryerje punimesh. Referuar mospërputhjeve në deklaratimet e subjektit sa i takon periudhës së kryerjes së investimeve dhe mospërputhjes së numrit të aplikimit në kërkesën e bërë nga subjekti, me numrin e aplikimit në lejen me të cilën është pajisur subjekti me Nr. \*\*\*, datë 8.3.2017, lëshuar nga Bashkia Tiranë, krijohet dyshimi që subjekti ka kryer punime në vitin 2016, pa një leje ndërtimi; (iv) subjekti e ka blerë pasurinë në një çmim më të ulët se çmimi referencë; (v) nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i të ardhurave për krijimin e likuiditetit të paguar *cash* në vlerën prej 4.800 USD, për kryerjen e investimeve, e konsideruar si shpenzim në vitin 2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit bazuar në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm**

**33.** Në lidhje shumat 13.000 euro dhe 35.000 euro, paguar përkatësisht nga subjekti dhe babai për blerjen e pasurisë objekt verifikimi, subjekti kundërshtoi konstatimin e Komisionit, sipas të cilit, këto shuma nuk justifikohen me të ardhura të ligjshme, në vijim të qëndrimit të mbajtur edhe gjatë procesit të rivlerësimit, duke paraqitur pretendimet e tij, renditur në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- të dyja këto shuma e kanë burimin të të ardhurat e babait Gj. G., për shkak të ushtrimit të aktivitetit privat gjatë periudhës 1992 – 1999;
- është në pamundësi objektive për të paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., deri në fund 1999, duke iu referuar përgjigjeve nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2021, të DRT-së Shkodër;
- ka provuar me dokumente që babai i tij ka pasur deri në fund të vitit 1996 shumën 20.000.000 lekë ose 154.000 USD kapital dhe vetëm interesa të gjeneruara nga këto depozita rreth 3.300.000 lekë ose 25.000 USD;
- ka shpjeguar qartë arsyet e tërheqjes së këtyre depozitave nga bankat për shkak të situatës kaotike dhe të pasigurtë të sistemit financiar në vitet 1996 – 1997 dhe se principi i këtyre depozitave është përdorur pjesërisht për aktivitet tregtar dhe pjesërisht është mbajtur në banesë. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se babai i tij ka rifilluar të depozitojë në “Tirana Bank”, në vitin 2002, pas rifitimit të besimit të publikut në sistemin bankar<sup>23</sup>, paratë të cilat ishin në banesë dhe që ishin tërhequr në fund të vitit 1996;
- ka provuar se pjesa e interesave të përfituara nga investimi i depozitave deri në fund të vitit 1996, u depozituan në shkurt të vitit 1997 te Banka Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”) dhe se në datën 8.8.2003, u maturua shuma 3.500.000 lekë e cila u tërhoq dhe u depozitua nga babai në “Tirana Bank”, duke u këmbyer në shumën prej 27.500 USD;
- vetë subjekti ka depozituar në “Tirana Bank”, shumën prej 15.000 USD, në datën 7.1.2003, e përbërë nga 12.000 USD (dhuratë nga babai me të ardhura nga aktiviteti privat) + 3.000 USD nga kursime të tij;
- ka argumentuar dhurimin nga babai të shumës 12.000 USD, ndërkohë që vëllain e tij e ka përfshirë si ortak me 50% të kuotave tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- ka provuar se të dyja depozitat: ajo e tij prej 15.000 USD, si dhe depozitat e babait të tij, kanë mbetur të investuara tek “Tirana Bank” nga viti 2003 – 2016, kur është blerë apartamenti në Tiranë, të cilat së bashku me interesat e gjeneruara kanë krijuar shumat 13.000 euro dhe 35.000 euro, përkatësisht.

**34.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni i çmoi të bazuara pretendimet e subjektit, në lidhje me të ardhura të babait nga aktiviteti privat të cilat kanë shërbyer si burim për pagimin e shumës 35.000 euro në vitin 2016 dhe shumën 12.000 USD dhuruar subjektit të rivlerësimit në vitin 2003, referuar fakteve dhe rrethanave të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, renditur si vijojnë:

**34.1.** U vërtetua ushtrimi i aktivitetit privat i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 1992 – 2010, me objekt të veprimtarisë, tregtimi i karburanteve, veprimtari e cila sipas të dhënave të

<sup>23</sup>Subjekti ka deklaruar se: *“Si rrjedhojë e shembjes së skemave piramidale, publiku mbeti tejet i ndjeshëm ndaj problemeve të sektorit financiar. Këtë e tregon qartë një episod, në mars të vitit 2002 me bankën më të madhe në Shqipëri. Banka kishte një bilanc të pastër. Të gjitha huat e këqija ishin shlyer dhe banka ishte ristrukturuar me paratë e qeverisë. Banka e kishte të ndaluar të jepte hua, kështu që të gjitha aktivet e saj ishin ose në bono qeveritare, aktive të huaja ose kërkesa nga banka qendrore. Banka priste të privatizohej (shpresohet që kjo të ndodhte relativisht shpejt). Pavarësisht nga bilanci i saj i pastër dhe cilësia e lartë e aktiveve, në mars të vitit 2002 filloi të thuhet se banka ishte e paaftë për të paguar dhe se njerëzit duhet të tërhiqnin depozitat e tyre, duke cituar rënien e skemave piramidale. Shkaku i këtyre thashethemeve nuk është i qartë, por për rrjedhojë brenda një muaji banka humbi 12 për qind të depozitave të saj. Pas kësaj gjendja u kthye në normalitet (tërheqjet pushuan), por depozitat nuk u kthyen në bankë. Në pikën kulmore daljet neto ishin 1 për qind e shumës së përgjithshme të depozitave në ditë. Ky është një rast akademik se si një vështrim në bankë mund të shkaktohet nga jo më shumë se sa thashethemet e mbështetura në një histori të vonshme të brengës financiare. Besimi humbet menjëherë, por është i vështirë për t’u rifituar”.*

ditura publikisht, siguron të ardhura të konsiderueshme krahasimisht me veprimtari të tjera tregtare.

**34.2.** Referuar vlerave monetare të depozituara, ndër vite, si dhe lëvizjeve në llogaritë bankare, z.Gj.G. ka krijuar shuma monetare të konsiderueshme të cilat i ka investuar në depozita bankare me afat dhe me interesa të larta, të cilat kanë arritur në shumën 20.000.000 lekë, të cilën e ka tërhequr nga sistemi bankar në fund të vitit 1996 për ta depozituar pjesërisht serish në vitin 2002. Komisioni i çmoi të arsyeshme deklaratimet e subjektit, sipas të cilit kjo shumë pjesërisht është përdorur për biznes dhe pjesërisht është mbajtur si gjendje likuiditeti në banesë prej babait të tij në periudhën 1997 – 2002, për shkak të problemeve të rënda të ditura publikisht, në të cilat kaloi sistemi financiar në Shqipëri gjatë vitit 1996 dhe në vijim, pas rënies së skemave piramidale, situatë të cilën subjekti e ka trajtuar me hollësi në parashtrimet e tij të datës 10.02.2022.

**34.3.** Me qëllim vlerësimin e situatës financiare të z. Gj. G. në një periudhë të largët kohore, sa me afër gjendjes faktike, Komisioni administroi disa dokumente shkresore në lidhje me pasuri të babait të subjektit <sup>24</sup>, nga verifikimi i të cilave rezultoi se ka pasur në pronësi: (i) banesë ekzistuese njëkatëshe e ndërtuar gjatë viteve 1981-1982, e cila është rikonstruktuar dhe është shtuar kati i 2-të (si karabina) në vitin 1995, me sip. 148 m<sup>2</sup>ndërtuar mbi një tokë arë prej 1.659 m<sup>2</sup> e përfituar nga ligji nr. 7501<sup>25</sup>; (ii) pikën e karburantit ndërtuar mbi një sip. totale 835 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 200 m<sup>2</sup> truall dhe ndërtesë 90 m<sup>2</sup>, ndodhur në M\*\*\*, Shkodër, ndërtuar në vitin 1994<sup>26</sup>. Këto pasuri janë krijuar/ndërtuar paralelisht ose më parë se krijimi i depozitave bankare të vitit 1995 dhe 1996, duke përdorur të ardhura të tjera, pasi sikurse është vërtetuar me dokumente bankare, depozitat kanë qëndruar të investuara në Bankën Agrare Tregtare përgjatë viteve 1995 e deri në fund të vitit 1996.

**34.4.** Nisur nga vlera e likuiditeteve në total prej 20.000.000 lekësh, disponuar prej e z. Gj.G. deri në fund të vitit 1996, çmohet se këto likuiditete kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar shumën 35.000 USD, e cila është depozituar në vitin 2003 në “Tirana Bank” dhe është përdorur për të paguar pjesën e tij takuese në blerjen e pasurisë apartament në vitin 2016, ashtu sikurse dhe për t’i dhuruar djalit të tij shumën 12.000 USD në vitin 2003, deklaruar nga subjekti në DPFd-në në gusht të vitit 2014 (e cila është përdorur, gjithashtu, nga subjekti për të paguar

---

<sup>24</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2020, të ASHK-së Shkodër; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020, të RNSH-së; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, të DPPPP-së; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2020, të DSHPTRr-së në dosjen e Komisionit; dokumentet bashkëlidhur te pyetësorët nr. 2 dhe nr.3.; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.10.202, të ASHK-së Shkodër për pasuritë në pronësi të Gj. G.; certifikata të pasurive nr. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, z. k. \*\*\*, në pronësi të Gj.G. si përfaqësues i familjes bujqësore dhe kartelë të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit pemëtore + truall me sip. 1656 m<sup>2</sup>, 200 m<sup>2</sup> nga të cilat 148 m<sup>2</sup> ndërtesë; kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 30.9.1993, të Komunës D\*\*\* për dhënie truall ndërtimi për pikën e karburantit me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>; vendimin nr. \*\*\* prot., datë 3.11.1993, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për dhënie sheshi ndërtimi me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>; vërtetim pronësie, datë 6.6.1994, nga Zyra Hipotekës Shkodër për pikë karburanti ndërtesë dhe sheshi i distributorit por pa përcaktuar sipërfaqen; leje ndërtimi nr. \*\*\* prot., datë 16.2.1995, e Rrethit Shkodër për objektin pikë karburanti në G\*\*\*-D\*\*\*; leje shfrytëzimi, nr. \*\*\* regj., Shkodër më 31.7.2003, objekti: pikë karburanti; adresa G\*\*\*, Komuna D\*\*\*, Shkodër; investitori Gj. G. (bashkëngjitur është i gjithë dokumentacioni përkatës, si aktkolaudimi, vlera e investimit 800.000 lekë, leje ndërtimi, projekti teknologjik, planimetri).

<sup>25</sup>Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

<sup>26</sup>Në përgjigje të pyetjes 2 të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur një vërtetim pronësie datë 6.6.1994 të lëshuar nga Zyra e Hipotekës Shkodër, ku ndër të tjera, citohet se në favorin e Gj. G., pranë kësaj Zyre, në radhorin e pronësisë nr. \*\*\*, datë 6.6.1994, është regjistruar prona pikë karburanti e cila ndodhet në fshatin G\*\*\*, D\*\*\*, Shkodër.

pjesën e tij takuese në blerjen e apartamentit të banimit objekt verifikimi). Për më tepër, origjina e këtyre shumave është e verifikuar nëpërmjet llogarive bankare, zanafilla e të cilave daton në vitin 1995, kur subjekti ka qenë 20 vjeç dhe jo nëpërmjet ndonjë llogarie të hapur rishtazi rreth vitit 2016, kur subjekti ka qenë në detyrë dhe kur është blerë pasuria objekt verifikimi.

**34.5.** Sa i takon legjitimitetit të këtyre të ardhurave, është e vërtete se pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës parashikon se të ardhura të ligjshme konsiderohen ato të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Por, Komisioni krijoi bindjen se subjekti është në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhura nga aktiviteti privat ushtruar nga babai i tij në periudhën 1992 – 2000, sipas nenit 32/2 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme”*. Në rastin konkret, Komisioni është pikërisht përpara faktit të vërtetuar se informacioni i kërkuar nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër, konfirmuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, DRT-ja Shkodër, e cila ka informuar të dhëna për tatimpaguesin “\*\*\*\*” sh.p.k., vetëm pas vitit 2000 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2021, nga DRT-ja Shkodër, sipas të cilës kjo drejtori ka paraqitur dokumentacion duke filluar mbas vitit 2000, ku ka sqaruar se: *“Në arshivën e drejtorisë tonë, për shkak të rikonstruksioneve ndër vite të institucionit, nuk disponohen të dhëna dhe dokumentacion për tatimpaguesin ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. me NIPT \*\*\*, për periudhat më të hershme se viti 2000”*.

Në konsideratë të gjithë sa është arsyetuar më sipër, si dhe referuar vendimit nr.14/202, paragrafi 27, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas të cilit problematikat në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi të vlerësojë të ligjshme të ardhurat nga aktiviteti privat i babait të subjektit, të cilat kanë shërbyer si burim për shumën 35.000 euro paguar prej tij në vitin 2016 dhe shumën 12.000 USD dhuruar subjektit të rivlerësimit në vitin 2003, fakt që afekton analizën financiare, duke e kthyer balancën negative prej 327.318 lekësh, për periudhën nëntor 1999 – gusht 2003, në balancë pozitive prej 976.962 lekësh. Për rrjedhojë, justifikohet blerja e pasurisë objekt verifikimi me të ardhura të ligjshme.

**35.** Në parashtrimet e tij subjekti ka qartësuar situatën në lidhje me mospërputhjet në dy numrat e aplikimit pranë Bashkisë Tiranë për t’u pajisur me leje për kryerje punimesh në banesë, duke vërtetuar se bëhet fjalë për të njëjtin aplikim, i cili është kryer dy herë nga ana e aplikueses, znj. E.M. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2022, lëshuar nga Bashkia Tiranë, e cila ka vënë në dispozicion dokumentacionin e gjeneruar nga sistemi elektronik *e-leje*, për dy aplikimet \*\*\*\* dhe \*\*\*. Në këto informacione vërtetohet se:

- Arkitekte E.M. ka aplikuar në sistemin *e-leje* me nr. aplikimi \*\*\*, protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. \*\*\*, datë 25.2.2017, për punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në emër të Gj.G. dhe Kastriot Gramshi.

- Me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2017, DPPZhT, Bashkia Tiranë ka komunikuar refuzimin e kërkesës për “deklaratë paraprake punimesh”, për arsye se *mungon certifikata e pronësisë ose vërtetimi hipotekor i pronës, bashkëlidhur harta dhe kopja e kartelës shoqëruese, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kopje origjinale, e marrë në tri muajt e fundit*.

- Znj. E. M. ka aplikuar përsëri në sistemin *e-leje* me nr. aplikimi \*\*\*, protokolluar me nr. \*\*\*, datë 3.3.2017, në Bashkinë Tiranë, për punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit, grupi i punës ka konstatuar se kërkesa është në përputhje me ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe DPPZhT-së pranë Bashkisë Tiranë me shkresë nr. \*\*\*, datë 2.3.2017, ka vendosur pranimin e deklaratës paraprake punimesh për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ka provuar se dy aplikimet për leje në Bashkinë Tiranë janë për të njëjtin qellim dhe për të njëjtën pasuri dhe se rikonstruksioni i kryer në banesë është kryer me leje ndërtimi në vitin 2017.

**36.** Pavarësisht sa më sipër u vërtetua dhe u arsyetua, duke marrë shkas nga disa të dhëna të marra nga mediat *online*, në lidhje me punime të kryera pa leje prej subjektit, duke iu referuar, gjithashtu, edhe deklaramentit në DPV-në për vitin 2018, ku subjekti është shprehur: *është bërë e shfrytëzueshme për qëllime banimi dhe pjesa takuese e çatisë së kësaj prone*, me riçeljen e hetimit administrativ për kriterin pasuror, sipas vendimit të trupit gjykues nr. 4, datë 18.2.2022, nga ana e Komisionit janë kryer veprimet hetimore si vijojnë:

**36.1.** Me pyetësin nr. 6, subjektit i është kërkuar: (i) të informojë nëse është pajisur me leje ndërtimi, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 39, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, për pjesën takuese të çatisë, e cila sipas deklaramentit të tij është bërë e banueshme; (ii) të paraqesë foto aktuale të ambienteve të shfrytëzueshme për qëllime banimi në pjesën takuese e çatisë; (iii) të shpjegojë nëse vetëm ai është përdorues i çatisë apo dhe banorë të tjerë të pallatit. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka parashtruar si vijon:

- Sa i takon punimeve në apartament, paraqiti foto dhe ka sqaruar duke ritheksuar se janë kryer punime sipas lejes së Bashkisë Tiranë, të cilat nuk afektonin fasadën e godinës ekzistuese, por kanë qenë thujse vetëm punime të brendshme që nuk ka ndryshuar apo ndikuar në strukturën e saj dhe se punimet nuk kanë krijuar ndërtim të ri në kuptim të germave “a” dhe “b”, të nenit 11, të VKM-së nr. 408/2015.

- Sa i takon përdorimit të çatisë, ka shpjeguar se vetëm ai është përdorues i kësaj pjese të çatisë dhe jo banorë të tjerë dhe se ata nuk kanë shprehur pakënaqësi me ushtrimin e tagrave të bashkëpronësisë, pasi kanë qenë dakord me punimet e kryera prej tij në vitin 2017, duke dhënë pëlqimin në deklaratat përkatëse.

**36.2.** Me qëllim vërtetimit të deklaramenteve të subjektit, Komisioni kërkoi të dhëna nga Bashkia Tiranë, e cila në përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2022, midis të tjerave ka informuar se *pasi është vendosur pranimi i deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve sipas kërkesës së pronarëve për ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, është kryer zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes*. Gjithashtu, shkresa bën me dije se *ligji 107/2014, datë 31.7.2014, i ndryshuar dhe VKM-ja nr.408, datë 13.5.2015, nuk shqyrton përcaktimin e destinacioneve të ambienteve të reja të krijuara pas rikonstruksionit të çatisë*.

Referuar këtij informacioni ligjor dhe në një vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave të rezultuara nga një hetim shterues, si gjatë hetimit administrativ ashtu edhe gjatë atij shtesë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, nuk u vërtetua asnjë prej informacioneve të mediave *online* dhe as të denoncuesit K. G. dhe Komisioni krijoi bindjen se subjekti nuk ka kryer shtesë volumesh ndërtimore në apartamentin objekt verifikimi dhe se për punimet e kryera është pajisur me leje sipas të gjitha rregullave të përcaktuara në dispozitat ligjore.

**37.** Në lidhje me blerjen e pasurisë më lirë se çmimi i referencës, subjekti ka prapësuar se pavarësisht çmimit të kontratës prej 48.000 euro, vlera e shpenzuar për pasurinë është më e lartë, pasi përveç kësaj shume ai dhe babai i tij kanë paguar 823.751 lekë, si pagesë të tatimit mbi të ardhurat nga shitja, plus 32.000 USD shpenzime për rikonstrukcionin e apartamentit të pabanueshëm. Gjithashtu, subjekti ka përfshire si shpenzim edhe vlerën 3.300 euro të qirasë së shtëpisë së përdorur deri sa apartamenti i blerë të bëhej i banueshëm. Duke paguar në total shumën prej 82.000 euro, subjekti pretendon se e ka blerë pasurinë në një çmim më të lartë se çmimi i referencës (61.824 euro).

**37.1** Sa i takon pretendimit për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja, pavarësisht se ky tatim ka qenë detyrim i palës shitëse, sipas kontratës së shitjes së pasurisë të vitit 2016, blerësi ka marrë përsipër të paguajë tatimin për shitjen e pronës. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr.2, subjekti ka shpjeguar: *“Meqenëse shitësit, të cilët nuk janë rezident të përhershëm në Shqipëri dhe kanë qenë në pamundësi për të qëndruar më gjatë, është rënë dakord që blerësit të marrin përsipër pagimin i tatimit mbi çmimin e shitjes, pra, në fakt çmimi i paguar për apartamentin është 48.000 euro + 823.750,58 lekë. Shuma e tatimit është krijuar në këtë mënyrë: shuma 2.500 USD është paguar nga subjekti ndërsa shuma 4.000 USD është paguar nga babai dhe si burim për këtë kanë shërbyer të ardhura të përfituara nga administrimi i pasurive të babait”*.

**37.2** Në mbështetje të pretendimeve, subjekti ka paraqitur si prova shkresore: (i) mandat tërheqje nga “Tirana Bank”, në të cilin evidentohet se në datën 12.7.2016, subjekti ka tërhequr shumën 2.500 USD me përshkrimin “tërhequr cash për pagesën e tatimit mbi shitjen e pasurisë”; (ii) tërheqje nga llogaria e babait të subjektit te “Tirana Bank” të shumës 987 USD, e cila është teprica e shumave të krijuara nga viti 2002 deri në datën 8.7.2016. Nga dokumentet e hipotekës, rezulton se tatimi për kalimin e pronësisë është në shumën 823.750,5 lekë është paguar, shumë e cila u vërtetua të jetë paguar nga subjekti dhe babai i tij, sipas deklarimeve të subjektit. Kjo shumë është konsideruar nga Komisioni si pjesë e çmimit të paguar nga subjekti dhe babai i tij për apartamentin, duke u përlllogaritur si shpenzim në analizën financiare.

**37.3.** Gjithashtu, janë vërtetuar investime në banesë në total në vlerën prej 32.000 USD/3.555.200 lekë<sup>27</sup>, duke e bërë të besueshëm pretendimin e subjektit se ishte pikërisht gjendja ekzistuese e pasurisë në momentin e blerjes, e cila është bërë shkak për blerjen e saj në çmimin 48.000 euro. Në total vlera e shpenzuar për apartamentin objekt verifikimi është 48.000 euro + 823.751 lekë + 32.000 USD ose rreth 80.500 euro<sup>28</sup>, e cila është më e lartë se çmimi i referencës.

Referuar këtyre fakteve, si dhe mungesës së të dhënave për një konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shitësit e pasurisë, në përfundim, nuk u vërtetua që subjekti të ketë përfitur pasurinë objekt verifikimi në mënyrë preferenciale dhe, aq më tepër, për shkak të detyrës.

**38.** Sa i takon shumës 4.800 USD paguar në cash për vlerën e shpenzimeve të investimeve për rikonstrukcionin e banesës, subjekti ka shpjeguar dhe ka vërtetuar bindshëm se kjo shumë nuk është shpenzuar në vitin 2016, por në verën e vitit 2017, pra, pas periudhës së rivlerësimit dhe, për këtë arsye, nuk është përfshirë si shpenzim në analizën përfundimtare të vitit 2016<sup>29</sup>. Gjithsesi, duke qenë se kjo shumë ka qenë me të ardhura nga qiratë e banesës në Amerikë dhe në përfundim të hetimit administrativ Komisioni kishte paqartësi për të ardhurat nga qiratë, pas parashtrimeve me kalimin e barrës së provës, subjekti ka vërtetuar të ardhura të ligjshme nga

<sup>27</sup>Kursi i këmbimit 1 USD = 111.1 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2017.

<sup>28</sup>Kurset e këmbimit midis euros, dollarit dhe lekut, janë marrë nga Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2016.

<sup>29</sup>Shihni analizën financiare në çështjen 99 të vendimit.



qiratë dhe, për pasojë, vërtetohet burimi i ligjshëm i shumes 4.800 USD (trajtuar në vijim të paragrafi nr. 86-88).

**39.** Veç sa më sipër, duke qenë se denoncuesi K.G. është shprehur në lidhje me një kallëzim penal në adresë të subjektit sa i takon pasurisë objekt verifikimi, me kërkesë të Komisionit, SPAK<sup>30</sup> informoi se ndaj shtetasit Kastriot Gramshi ka ardhur material kallëzues nga shtetasi K.G., për të cilin është vendosur të dërgohet për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me kalimin e barrës së provës, subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe dokumente në lidhje me vijimësinë e këtij procedimi penal.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se SPAK i ka dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë procedimin penal të nisur mbi kallëzimin e shtetasit K.G., person nën hetim si i dyshuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe pasi janë kryer veprimet e nevojshme hetimore, në përfundim, kjo prokurori ka disponuar me mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr.\*\*\*. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentet shkresore si vijojnë:

i) Vendim nr. \*\*\* akti, datë 29.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhënë nga gjyqtari Kastriot Gramshi, sipas të cilit është lënë në fuqi masa e sigurimit “arrest në burg”, të caktuar me vendim nr. \*\*\* regj. them., datë 3.10.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj personit nën hetim K.I.G.

ii) Vendim nr. \*\*\* akti, datë 27.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhënë nga gjyqtari Kastriot Gramshi, sipas të cilit është vendosur zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest në shtëpi” dhënë me vendim nr. \*\*\* akti, datë 29.10.2020 (ndryshuar me vendim nr.\*\*\*, datë 11.11.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë), në atë të “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, për personin nën hetim K.G.

iii) Vendim “për mosfillimin e procedimit penal”, datë 5.3.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me kallëzimin e shtetasit K.G., i cili, ndër të tjera, pretendon se shtetasi Kastriot Gramshi ka kryer ndërtim pa leje në apartamentin në pronësi të tij, regjistruar me nr. \*\*\*. Në këtë vendim është arsyetuar: “... nga analiza e fakteve dhe rrethanave të parashtruara sa më sipër rezulton qartë se, pretendimi i kallëzuesit në lidhje me ndërtime pa leje të kryera nga shtetasi Kastriot Gramshi në apartamentin ku banon, nuk qëndron. Për punimet e mësipërme rezulton se shtetasi Kastriot Gramshi është i pajisur me dokumentacionin përkatës për kryerjen e punimeve nga Bashkia Tiranë, konfirmuar kjo me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2017”. Në përfundim është vendosur: mosfillimi i procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr.\*\*\*.

### **Pasuria e dytë e paluajtshme e deklaruar në deklaratën Vetting**

**40.** Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar: “Shtëpi, sip.180 m<sup>2</sup>, \*\*\* N.A., B., New York \*\*\*, (USA), blerë në datën 21.5.02012. Çmimi i blerjes: 290,000 (dyqind e nëntëdhjetë mijë) USD. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: kursime të akumuluar para emërimit si Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 10.7.2014, si dhe kredi e marrë nga W.F. Bank”. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. Referuar dokumentacionit të paraqitur për shtëpinë e banimit në SHBA, subjekti dhe vëllai i tij janë financuar me kredi në shumën 261.000 USD, pjesën tjetër e kanë investuar bashkërisht.

<sup>30</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2021, të SPAK në dosjen e Komisionit.

## Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

**41.** Në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie dhe deklaratimet e subjektit, nga aktet në dosje<sup>31</sup>, u vërtetua se:

- Me kontratë shitje rezidenciale, në datën 17.2.2012, vërtetohet se J.G. dhe D. B. D., në cilësinë e palës shitëse i kanë shitur Kastriot Gramshi dhe K.G. pasurinë, banesë në çmimin prej 290.000 USD<sup>32</sup>.

- Në DPFP-në e vitit 2014, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me burim: *pagim kësti fillestar prej 29.000 USD, Kredi nga W.F. Bank në vlerën 261.000 USD*, vlerën e pasurisë në shumën 290.000 USD, si dhe pjesën takuese të tij 50 %.

- Sipas dokumentit Second Rider to Contract of Sale/Shtojcë e dytë e kontratës së shitjes e firmosur nga palët, ato bien dakord që shitësit do të lirojnë blerëseve ambientet deri në datën e mbylljes së transaksionit ose rreth datës 10.4.2012. Blerësit bien dakord që shitësi mund të përdori pjesën e paradhënies të nevojshme për qiranë.

- Bashkëlidhur shtojcës së kontratës, shtojca A dokumenti Titull nr.\*\*\*, datë nuk ka, përcaktohet qartësisht pasuria që po blihet për të cilën do të paguhet siguracion.

- Me dokumentin Conventional Commitment Letter/Letër e standarde angazhimi, drejtuar Kastriot dhe K.G. nga W.F. Bank, këta shtetas njoftohen mbi aprovimin e shumës së kredisë prej 217.500 USD.

- Me dokumentin shkresor Real Property Transfer Report / Raport mbi transferimin e pasurisë së paluajtshme, datë 2.5.2012, përcaktohen palët në kontratë, data e kontratës më 17.2.2012, data e transferimit më 21.05.2012 dhe çmimi i shitjes 290.000 USD.

- Me dokumentin shkresor New York Record Retrieval, INC/regjistrim pasurie, vërtetohet regjistrimi dhe titulli i pronësisë në emër të blerësve Kastriot dhe K.G., në datën 7.6.2012.

- Me dokumentin Truth-in-lending disclosure/vërtetim fillestar për dhënien e huas, datë 17.2.2012, me kreditor W.F. Bank N.A., huamarrës Kastriot dhe K.G., përcaktohet shuma e huas financiare, përqindja vjetore dhe mënyra e pagesës.

- Me shkresën Escro account disclosure Statement/njoftim për pagesat e kredisë, lajmërohen kredimarrësit nga W.F. Home Mortgage, mbi vlerën e kështit që do të paguhet.

- Me shkresën Notice of property value/Lajmërim mbi vlerën e pasurisë, datë 15.1.2016, Departamenti i Financës së qytetit të New York, informon për vlerën e tregut.

Bazuar në të gjitha të dhënat e vërtetuara me dokumentet si më sipër, të paraqitura të përkthyer, noterizuara dhe të legalizuara me vulë apostille, vërtetohet përfitimi në mënyrë të ligjshme i pasurisë objekt verifikimi në vitin 2012, e financuar në masën 75% nëpërmjet një kredie të marrë nga W.F. Bank N.A.

**42.** Në lidhje me likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë, u konstatua se:

**42.1.** Sipas kontratës së shitjes, datë 17.2.2012, çmimi prej 290.000 USD do të paguhet në këtë mënyrë: (i) me nënshkrimin e kontratës paguhet shuma prej 29.000 USD si kapar; (ii) shuma prej 261.000 USD, sipas parashikimeve të paragrafit 3 do të paguhet nëpërmjet një kredie

<sup>31</sup>Shihni aneks \*\*\* në dosjen ILDKPK-së, si dhe dokumentet bashkëngjitur në përgjigje të pyetësorit nr. 1, 2 dhe 3.

<sup>32</sup>Shihni kontratën e plotë në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

bankare; (iii) sipas parashikimeve të paragrafit nr. 7, pagesa e çmimit të blerjes do të bëhet ose në *cash* për shuma deri në 1.000 USD ose me çek bankar.

**42.2.** Në DPFD-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar vlerën e kredisë në shumën 261.000 USD, ndërkohe që, sipas dokumentit “Conventional Commitment Letter”/letër standarde e angazhimit<sup>33</sup> drejtuar Kastriot dhe K.G. nga W. F. Bank, këta shtetas njoftohen mbi aprovimin e shumës së kredisë prej 217.500 USD.

**42.3.** Siç vërehet ka një mospërputhje sa i takon shumës së kredisë në kontratën e shitjes së pasurisë dhe deklarimin e subjektit në DPFD-në e vitit 2014, ku vlera është 261.000 USD dhe dokumentit Conventional Commitment Letter/letër standarde e angazhimit, ku vlera e kredisë është në shumën 217.000 USD. Nisur nga kjo mospërputhje është pyetur subjekti për kohën dhe shumën e aprovuar dhe të disbursuar të kredisë.

**42.4.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara si vijon:

*“Pagesa e kështit të parë (down payment) ka qenë 29.000 USD ose 10% e vlerës së shitjes së pasurisë, sikurse e kërkuar nga banka që do të jepte kredisë. Kjo pagesë është kryer nga subjekti për llogari të zyrës avokatore P\*\*\* & Associates PLLC As. Attorneys, sikurse pasqyrohet në çekun bankar të datën 16.2.2012.*

- *Shuma e kredituar nga W. F. Bank ka qenë 217.500 USD dhe sipas procedurës së kredidhënies, prona u vlerësua dhe banka vendosi që shuma e financimit të ishte 217.500 USD.*

- *Me qëllim finalizimin e kontratës së shitblerjes u kërkuar nga banka që diferenca e çmimit të blerjes së pronës me pagesën e 29.000 USD dhe me shumën e kredisë, pra,  $290.000 - 217.500 = 43.500$  \$, duhej të mbulohej nga pala blerëse. Meqenëse nga ana e palës blerëse (subjekti dhe vëllai i tij) është rënë dakord që të vijohej me procedurën e blerjes së kësaj pasurie, shuma 46.638,43 USD është paguar nga vëllai i subjektit K.G., për llogari të B.F. (banka kredituese e shitësit të pronës), sikurse pasqyrohet në çekun bankar të datës 21.5.2012.*

Për të mbështetur deklaratimet e mësipërme, subjekti ka paraqitur disa dokumente<sup>34</sup> nëpërmjet të cilave provohen burimet që kanë shërbyer për blerjen e shtëpisë në vlerën 291.000 USD.

**42.5.** Nga deklaratimet e subjektit dhe dokumentet e paraqitura prej tij, rezultoi se: (i) çmimi i blerjes së pasurisë prej 290.000 USD është paguar në periudhën 16.2.2012 – 21.5.2012, kur subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues; (ii) kjo shumë është paguar me kredi bankare në vlerën 214.362 USD<sup>35</sup> dhe nga pjesa e mbetur prej 75.638,43 USD, shuma 29.000 USD është paguar me lidhjen e kontratës si paradhënie në datën 16.2.2012, ndërsa pjesa tjetër prej 46.638,43 USD është paguar në datën 21.5.2012, nga vëllai i subjektit K.G.; (iii) pjesa e përballuar me kredi bankare është në vlerën 217.500 USD dhe jo në vlerën 261.000 USD, sikurse e parashikon kontrata e shitjes dhe sikurse subjekti ka deklaruar në DPFD-në e vitit 2014. Siç vërehet ka pasaktësi në deklaratimet e subjektit në këtë deklaratë sa i takon pjesës së përballuar me kredi bankare. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, vërehet se subjekti nuk ka kryer deklarime në lidhje me vlerën e aprovuar të kredisë dhe pjesën e përballuar prej tij dhe vëllait të tij K. G., duke u mjaftuar vetëm me deklarimin e çmimit të blerjes së pasurisë.

<sup>33</sup>Ky dokument është paraqitur nga subjekti pranë ILDKPKI-së, bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

<sup>34</sup>“Njoftimi i termave të kredisë”, nga W. F. Bank, ku evidentohet se shuma e kredisë së aprovuar nga kjo bankë është 217.500 USD, kohëzgjatja 240 muaj, interesi vjetor 4.25% dhe kësti mujor 1.346,84 USD; “njoftimi mbi kostot e kredisë”, në W. F. Bank, datë 21.5.2012 nga ku evidentohet se shuma e disbursuar në llogarinë e bashkëkredimarrësve K. dhe Kastriot Gramshi në datën 21.5.2012, është 215.528,17 USD; kopje të çekut të Ch. Bank nr. \*\*\* të datës 16.2.2012, ku provohet pagesa e shumës 29.000 USD nga Kastriot Gramshi; kopje të çekut të Ch. Bank nr. \*\*\* të datës 21.5.2012, ku provohet pagesa e shumës 46.638,43 USD nga K. G.

<sup>35</sup>Shuma e mbetur nga kredia prej 217.500 USD, pasi janë zbritur të gjitha komisionet e bankës.

**42.6.** Pavarësisht se pagesa e shumë prej 46.638,43 USD është kryer në rrugë bankare në datën 21.5.2012 nga vëllai i subjektit K.G., në përgjigje të pyetësorit 2 dhe 3, subjekti ka pohuar se pjesëmarrja e të vëllezërve në këtë pronë është 50% me 50% dhe se çdo shpenzim që ka lidhje me pasurinë dhe kredinë e marrë është ndarë në mënyrë të barabartë midis tyre, duke u përballuar me kursimet e dy familjeve përkatëse. Ky deklaram duket i besueshëm referuar fakteve: (i) blerës janë të dy vëllezërit; (ii) kredia është marrë nga të dy vëllezërit; (iii) këstet e kredisë janë paguar nga të dy vëllezërit; (iv) e gjithë familja ka jetuar bashkërisht nga viti 2003, kur është shpërngulur në SHBA dhe deri në momentin e blerjes së shtëpisë.

### **Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë**

**43.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi: (i) kursime të akumuluar para emërimit si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 10.7.2014; si dhe (ii) kredi të marrë W. F. Bank, analizuar në mënyrë specifike si vijojnë:

**43.1. Në lidhje me burimin kredi bankare,** nëpërmjet dokumentit “letër standarde angazhimi nga W. F. Bank”, drejtuar Kastriot dhe K.G., banka ka njoftuar kredimarrësit për aprovimin e shumë së kredisë prej 217.500 USD. I pyetur nga Komisioni, subjekti ka paraqitur dokumente të plota nga të cilat ka rezultuar se shuma e kredisë së aprovuar nga kjo bankë është 217.500 USD, kohëzgjatja 240 muaj, interesi vjetor 4.25% dhe kësti mujor 1.346, 84 USD dhe se disbursimi është bërë në datën 21.5.2012, në shumën 215.528,17 USD. Në përfundim të hetimit administrativ është provuar marrja dhe përdorimi kredisë prej 217.000 USD, si një nga burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

**43.2. Në lidhje me burimin kursime të akumuluar** të cilat kanë shërbyer për: (i) pagesën e kaparit/paradhënies prej 29.000 USD në datën e lidhjes së kontratës së shitjes më 16.2.2012; si dhe (ii) shumë 46.638, 43 USD, paguar në datën 21.5.2012, prej vëllait të subjektit (por me të ardhura të të dyve), nga ana e Komisionit janë kryer disa veprime hetimore nga të cilat, është konstatuar se:

- Në DPDFD-në e vitit 2014, në rubrikën *Përshkrimi i të ardhurave*, subjekti ka deklaruar të ardhura për periudhën mars 2005 – nëntor 2008, në shumën 154.700 USD, si pedagog në departamentin e biznesit në G. I. T., New York dhe të ardhura prej 157.273 USD, për periudhën shkurt 2009 – korrik 2014, pedagog në Departamentin e Drejtësisë Penale (*criminal justice*) në ASA College<sup>36</sup> New York.

- Nga dosja e ILDKPKI-së janë administruar dokumente mbi të ardhura të përfituara nga subjekti<sup>37</sup> dhe konkretisht U.S Individual Tax Return/Deklarata e të ardhurave dhe e kthimit të taksave) për vitet 2005 – 2009, 2015 dhe Tax Return Script/Shënim për kthimin e taksave, për vitet 2010 – 2014.

- Gjatë hetimit administrativ nëpërmjet disa pyetësorëve, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion më i plotë me qëllim evidentimin e kursimeve të mjaftueshme të krijuara në SHBA, për të paguar pjesën e pambuluar me kredi bankare. Gjithashtu, pavarësisht faktit se shuma prej 46.638,43 USD është paguar në datën 21.5.2012, prej vëllait të subjektit K. G., duke qenë se janë vërtetuar fakte dhe rrethana që kjo shumë është paguar në mënyrë të barabartë nga subjekti dhe vëllai i tij, nga ana e Komisionit është kërkuar informacion mbi përbërjen faktike të familjeve së tyre Amerikë, si dhe informacion në lidhje me të ardhura dhe shpenzime

<sup>36</sup>Sipas informacionit në internet rezulton në College Catalog të ASA Gramshi Kastriot si instruktor (shih-<https://www.asa.edu/ep-content/uploads/2018/09/ASA-College-Catalog-NY-Vol23-with-addendums.pdf>)

<sup>37</sup>Shihni aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

të tjera të së gjithë familjes gjatë periudhës së qëndrimit në SHBA. Konkretisht u administruan të dhënat si vijojnë:

**a.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ai dhe familja e tij, kanë shkuar në SHBA në këtë mënyrë: subjekti ka shkuar në datën 18.8.2003, pas një muaji kanë shkuar edhe prindërit, vëllai K. G. ka shkuar në prill të vitit 2004, bashkëshortja e subjektit në mars të vitit 2005, si dhe bashkëshortja e vëllait në gusht të vitit 2011. Subjekti ka sqaruar se deri në momentin e blerjes së shtëpisë (maj 2012), ata kanë jetuar të gjithë së bashku dhe se shpenzimet janë mbuluar solidarisht, ndërsa pas blerjes së shtëpisë, ai me familjen e tij dhe dy prindërit, kanë jetuar në apartamentin 2 dhe vëllai me bashkëshorten e tij në apartamentin 1.

**b.** Në lidhje me situatën familjare të vëllait në momentin e blerjes së shtëpisë në SHBA, subjekti ka deklaruar se: “ .. *lidhja e martesës së vëllait është bërë më 31.12.2003, por bashkëjetesa reale është kur bashkëshortja e vëllait ka shkuar në Amerikë në gusht të vitit 2011. Sipas subjektit, jetesa e saj në Shqipëri është siguruar nga prindërit e saj dhe nuk është kërkuar asnjë lekë nga vëllai i subjektit, as për kohën që ka jetuar në Shqipëri dhe as për udhëtimin drejt SHBA-së*”.

**c.** Në lidhje me shpenzimet për kontrole shëndetësore, përfshirë dhe ato të lindjes së fëmijëve, subjekti deklaroi se ato janë mbuluar tërësisht nga kartat e shëndetit/siguracioni shëndetësor i secilit prej anëtarëve të familjes. Subjekti paraqiti si provë kopjen e kartës së shëndetit të vitit 2011, në emër të bashkëshortes si nëna e fëmijëve.

**d.** Sa i takon të ardhurave familjare, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore<sup>38</sup> për vete dhe familjarët e tij.

**e.** Për efekt të analizës financiare, Komisioni në vijim i ka kërkuar subjektit të dhëna dhe dokumente mbi: (i) gjendjet e llogarive bankare të të gjithë pjesëtarëve të familjes për periudhën 2005 deri në vitin 2015<sup>39</sup>; si dhe (ii) certifikatë familjare të vëllait të tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur certifikatë familjare të vëllait K. të datës 21.10.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile D\*\*\*, Shkodër, ku pjesë përbërëse e familjes rezultojnë dy persona, K. G. dhe bashkëshortja e tij M. L. Gjithashtu subjekti ka deklaruar se bankat, ku ai dhe çdo pjesëtar i familjes kanë llogari bankare, ruajnë dhe japin informacion për gjendjen e llogarive bankare deri në shtatë vite. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore<sup>40</sup>.

---

<sup>38</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, f. 244-270. Deklarimet vjetore të taksave për periudhën 2007 – 2017 pranë zyrës së tatim taksave të shtetit të New York *Internal Revenue Service* (IRS), ku gjenden të pasqyruara të ardhurat familjare, përlllogaritja e taksave në bazë të legjislacionit të shtetit të New York dhe legjislacionit Federal të SHBA-së, si dhe vlera e taksave të rimbursuara, sipas rastit; dokumenti i raportimit të të ardhurave vjetore pranë IRS (*Income Tax Return*) të depozituara në zyrën e taksave nga kontabilistja e miratuar S. B., në të cilin pasqyrohen të ardhurat vjetore dhe rimbursimi i taksave; deklarimet vjetore të taksave nga viti 2005 – 2016 të vëllait K. G.; deklarimet vjetore të taksave të babait Gj. G. për vitet 2007 – 2009 dhe pensionin e tij për vitet 2014 – 2018; paga e babait në Shqipëri si administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., nga viti 2000 deri në vitin 2010; librezë e pensionit të nënës në Shqipëri ku pasqyrohet masa e pensionit të saj në vlerën 9,140 lekë/muaj nga data 1.7.2010; certifikatë martese e subjektit, sipas së cilës ai është martuar në datën 31.7.2003; certifikatë martese e vëllait K. G., sipas së cilës ai është martuar në datën 31.12.2003; kopje e kartës së shëndetit të vitit 2011 në emër të bashkëshortes si nëna e fëmijëve.

<sup>39</sup>Subjekti ka gjeneruar të ardhura nga viti 2005 dhe ai së bashku me familjen e tij të ngushtë janë kthyer përfundimisht në Shqipëri në korrik të vitit 2015.

<sup>40</sup>Dy ekstrakte të llogarisë bankare të Gj. G. në Ch. Bank, për periudhat 29.11.2014 – 24.12.2014 dhe 28.11.2015 – 24.12.2015; dy ekstrakte/përmbledhje të të gjitha llogarive bankare të vëllait K. G. në Ch. Bank për periudhat 14.11.2014 – 10.12.2014 dhe 11.12.2015 – 13.1.2015; e-mail nga Ch. Bank, në të cilën kanë llogari të gjithë pjesëtarët e familjes, ku njoftohet se kjo bankë nuk mund të japë informacion për një periudhë më të largët se 7-

f. Meqenëse në dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 3, por edhe më parë, nuk ka pasur informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjektit dhe familjarëve të tij para vitit 2014, u ripyet subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 4, deklaroi se *...llogarinë e parë bankare e hapur pranë Ch. Bank, USA, në gusht të vitit 2004, e cila vijon dhe sot të jetë aktive. Ndërsa, në nëntor të vitit 2013 nga bashkëshortja është hapur llogaria bankare pranë TD Bank, SHBA, e cila vijon dhe sot të jetë aktive. Babai me ka informuar që kemi pasur në fillim rreth 20.000 USD, të ardhura në momente të ndryshme mbërritje në Amerikë nga secili nga ne, por siç shpjegova më lart, llogarinë e parë e kemi hapur në 2004. Duke qenë periudhë e gjatë dhe pa qëllim mbajte shënimesh, nuk mund t'ju dokumentoj një gjë të tille.*

g. I pyetur nga Komisioni nëse ka blerë automjete në SHBA, subjekti dhe familja e tij, të ndryshme nga ato të deklaruara, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se ai dhe familja e tij ka pasur në pronësi vetëm dy automjete: (i) automjet tip BMW, viti i prodhimit 1999, blerë në datën 22.6.2005, në SHBA, në çmimin 13.000 USD<sup>41</sup>; dhe (ii) automjeti që vijon të jetë në përdorim nga vëllai i tij, tip BMW, viti i prodhimit 2009, dhuruar vëllait K. G. nga punëdhënësi i tij, automjet i regjistruar në emër të K.G. në datën 21.12.2015. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumente<sup>42</sup> që provojnë pronësinë e automjetit të vëllait të tij dhe dhurimin e automjetit të tij dhe ka shpjeguar, gjithashtu, se të gjithë anëtarët aktive të familjes kanë përdorur transportin publik.

h. I pyetur se me çfarë të ardhurash ka jetuar ai dhe familja e tij nga viti 2003 deri në vitin 2005, vit kur subjekti ka paraqitur dokumente mbi të ardhurat në SHBA, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se ai ka filluar punë në shtator të vitit 2003 dhe ka bërë deklarinë e parë pranë IRS në mars të vitit 2005, për të ardhurat shtator 2003 - dhjetor 2004. Këto të ardhura kanë qenë në vlerë të përafërt me ato të vitit 2005, pasi në këto vite ai ka bërë të njëjtën punë. Subjekti ka deklaruar se: *“... për shkak të kohës së gjatë si dhe zhvendosjeve nga një adresë banimi në tjetrën, deklarata për periudhën shtator 2003 – dhjetor 2004, si dhe një sërë dokumentesh të tjera (përfshirë dhe disa deklarime të taksave të babait dhe vëllait apo statement bakare) nuk janë ruajtur, pasi nuk është menduar se ato do të mund të nevojiteshin në një moment tjetër...dhe se...kam qenë në pamundësi objektive të prezantimit të tyre pranë Komisionit... Pamundësia për të vënë në dispozicion të Komisionit informacionin mbi të ardhurat e mia për periudhën shtator 2003 – dhjetor 2004, sikurse dhe të një informacioni të tillë (për disa vite) për babanë dhe vëllain, nuk duhet konsideruar nga Komisioni si një periudhë pa të ardhura, madje mund t'ju them që ky ka qenë burimi i shpenzimeve të përditshme për gjithë familjen tonë”.*

## **Analiza financiare**

**44.** Bazuar në të gjitha informacionet nga aktet e administruara si më sipër, sa i takon mundësisë së subjektit dhe vëllait të tij, për të krijuar shumën 29.000 USD në datën 16.2.2012 dhe shumën 46.638, 43 USD në datën 21.5.2012, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare, bazuar në metodologjinë kumulative, për periudhën 1.1.2005 – 21.5.2012, sipas të cilës, duket se subjekti dhe familja e tij, nuk kanë patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shumën 75.638 USD për blerjen e shtëpisë së tyre, për shkak të një balance negative prej 131.085 USD, sikurse treguar në tabelën vijuese.

---

vjeçare; e-mail nga TD Bank si dhe një ekstrakt nga “termat dhe kushtet e TD Bank”, ku kanë llogari subjekti dhe bashkëshortja e tij, ku evidentohet se afati ligjor i marrjes së informacionit është 7 vjet.

<sup>41</sup>Ky mjet është deklaruar në deklaratën *Vetting*, trajtuar në paragrafët 60-62 të këtij vendimi.

<sup>42</sup>Certifikatë pronësie të mjetit tip “BMW”, në emër të K.G. me datë lëshimi më 21.12.2015; faturë nga organizata “\*\*\*”, të dërguar me e-mail në të cilin ka rezultuar se në vitin 2018, subjekti e ka dhuruar mjetin e tij tip “BMW”, blerë në vitin 1999.

| <i>Përshkrimi – në dollarë amerikanë (USD)</i>                                | <i>Periudha 2005 – 21.5.2012</i> |
|---|----------------------------------|
| <b>Pasuri</b>   | <b>487 468</b>                   |
| Shtëpi 180 m <sup>2</sup> , New York-USA, paguar më 21.5.2012 b/pronar me 50% | 290 000                          |
| Autoveture BMW ***, blerë më 22.6.2005 (në N. Y.)                             | 13 000                           |
| Blerë makinë nga babai në Shqipëri në vitin 2009                              | 10 109                           |
| Likuiditete në banka të familjes  | 174 359                          |
| <b>Detyrime</b>   | <b>217 500</b>                   |
| Kredi nga W. F. Bank disbursuar në datën 21.5.2012                            | 217 500                          |
| <b>Pasuri neto</b>  | <b>269 968</b>                   |
| <b>Të ardhura dokumentuar</b>   | <b>534 288</b>                   |
| Të ardhura familjare të subjektit   | 262 778                          |
| Të ardhura nga paga e vëllait K. G.   | 206 414                          |
| Të ardhura nga paga e vëllait K. G. në Shqipëri                               | 2 822                            |
| Të ardhura nga dividendi për shoqërinë “***” sh.p.k., në Shqipëri             | 3 298                            |
| Të ardhura nga paga dhe pensioni i babait në SHBA                             | 31 483                           |
| Të ardhura babait nga Shqipëria   | 25 498                           |
| Të ardhura nga pensioni i nënës në Shqipëri                                   | 1 995                            |
| Prurje të babait nga Shqipëria  | 0                                |
| <b>Shpenzime</b>  | <b>395 406</b>                   |
| Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare                                    | 238 599                          |
| Qira banese 1.500 USD/muaj dhe 1.800 USD/muaj                                 | 139 800                          |
| Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS për Subjektin                          | 6 068                            |
| Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS për familjen e origjinës familja       | 7 800                            |
| Shpenzime për marrjen e kredisë   | 3 138                            |
| <b>Mundësia për kursime</b>   | <b>-131 085</b>                  |

Në këtë analizë, janë përfshirë:

i) Pasuritë e familjes: automjetet e blera në SHBA në qershor të vitit 2005 dhe Shqipëri në vitin 2009; banesa e blerë në shumën 290.000 USD, në datën 21.5.2012; likuiditetet e vëllait dhe babait të subjektit në Shqipëri të krijuara pas vitit 2005; gjendjen e llogarive bankare të likuiditeteve në SHBA, për të gjithë anëtarët e familjes<sup>43</sup> në momentin e blerjes së shtëpisë në datën 21.5.2012.

ii) Të ardhurat: paga e subjektit dhe vëllait të tij nga viti 2005, sipas deklaratave të të ardhurave në SHBA<sup>44</sup>; të ardhurat e vëllait K. G. në Shqipëri nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.<sup>45</sup>; të ardhurat e babait të subjektit në SHBA për vitet 2007 – 2009<sup>46</sup> dhe paga e tij në Shqipëri<sup>47</sup>; pensioni i

<sup>43</sup> Meqenëse bankat në SHBA e ruajnë informacionin deri në 7 vjet, subjekti nuk ka mundur të paraqesë gjendje llogarish bankare para vitit 2013 (për vetë) dhe 2014 (për vëllain). Kështu, është kryer një vlerësim nga ana e Komisionit, duke pasur si pikënisje: (i) balancën e llogarive bankare të vëllait të subjektit në fund të vitit 2014 dhe të subjektit në fund të vitit 2013; (ii) duke përllogaritur mundësinë kursyese të secilit prej vëllezërve, nga 21 maj deri 31 dhjetor të vitit 2012 dhe për vitet 2013 e 2014. Në bazë të këtyre përllogaritjeve, ka rezultuar se në datën 21.5.2012, gjendja e depozitave në bankat në SHBA ka qenë: për subjektin 90.421 USD dhe vëllain e tij 76.924 USD.

<sup>44</sup> Shih dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, f. 218-230.

<sup>45</sup> Vëllai i subjektit merr pagë si administrator dhe dividendin e shpërndarë si ortak me 100% të kuotave, pas vitit 2010. Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, nga Drejtoria Rajonale Shkodër, në dosjen e Komisionit.

<sup>46</sup> Shih dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, faqe 164-172,

<sup>47</sup> Shih shkresën nr. \*\*\*, datë 6.10.2021, nga Drejtoria Rajonale e ISSH-së Shkodër, në dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, faqe 143-144, ku pasqyrohet paga e tij si administrator deri në vitin 2010.

nënës në Shqipëri. Nuk është përfshirë si e ardhur shuma 60.000 USD e deklaruar nga subjekti në pyetësin nr. 4<sup>48</sup> e marrë nga familja kur ka shkuar në SHBA, pasi nuk ka provuar burimin e ligjshëm të kësaj shume.

iii) Për shpenzimet është mbajtur parasysh që ata kanë jetuar së bashku deri në momentin e blerjes së shtëpisë, duke përfshirë: shpenzimet e jetesës për të gjithë familjen sipas standardit në SHBA<sup>49</sup> dhe përbërjen familjare; shpenzimet e qirasë<sup>50</sup>; komisionet e lidhura me marrjen e kredisë në W. F. Bank; shpenzimet e udhëtimit të subjektit dhe të gjithë anëtarëve të familjes<sup>51</sup>, sipas të dhënave të nxjerra nga sistemi *TIMS*.

### **Barra e provës që i kaloi subjektit të rivlerësimit**

**45.** Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/216, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën konstatimeve, duket se: (i) subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në DPDFD-në e vitit 2014, si dhe në pyetësin standard<sup>52</sup> në lidhje me shumën e kredisë bankare të marrë për blerjen e banesës në SHBA, duke e deklaruar atë në shumën 261.000 USD, pra, në një vlerë më të madhe se vlera e aprovuar dhe e disbursuar e kësaj kredie prej 217.500 USD; (ii) subjekti nuk ka deklaruar pagesën e shumës prej 46.638,43 USD paguar prej tij dhe vëllait të tij, për blerjen e banesës në New York USA, duke u mjaftuar vetëm me deklarimin e pagesës së paradhënies në shumë 29.000 USD; (iii) subjekti dhe familja e tij, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar në total shumën prej 75.638,43 USD e cila ka shërbyer si *downpayment*/ pagesë e kryer brenda datës 21.5.2012.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet në pikat (i) dhe (ii) të paragrafit 45 më sipër**

**46.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka pretenduar se deklarimet në DPDFD-në e vitit 2014, si dhe në pyetësin standard, të shumës e kredisë bankare në vlerën 261.000 USD, ndërkohë që vlera e aprovuar dhe e disbursuar e kësaj kredie ka qenë prej 217.500 USD, është bërë me qëllimin për të krijuar konsistencë dhe jo konfuzion, duke iu përmbajtur kushteve thelbësore të kontratës së shitjes së pasurisë, sipas të cilës vlera e blerjes prej 290.000 USD, përbëhet nga *downpayment*/kapar 29.000 USD dhe 261.000 USD kredi bankare. Ndërsa, në seksionin “detyrime”, ai ka deklaruar vlerën e kredisë 217.500 USD. Subjekti deklaroi që kjo ka qenë mënyra se si e ka kuptuar formularin e deklarimit në vitin 2014, deklarim i cili ka vijuar edhe në pyetësin standard, duke ndjekur të njëjtën logjikë. Në vijim të argumenteve të tij, subjekti vijon të parashtrijë që pasi është pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ai ka sqaruar të gjithë situatën duke paraqitur edhe çeqet e paguara për përfundimin e transaksionit për blerjen e shtëpisë.

Siç vërehet, subjekti e pranon që kjo mënyrë deklarimi është një pasaktësi e kryer nga ana e tij, por në mënyrë të paqëllimshme dhe në asnjë e rast për të fshehur ose mosdeklaruar veprimet apo pagesat e kryera për blerjen e shtëpisë, duke sjellë argumentet e mëposhtme: (i) ai i është

<sup>48</sup>Në përgjigje të pyetjes nr. 2, të pyetësit nr.4, subjekti ka deklaruar *babai me ka informuar që kemi pasur në fillim rreth 20.000 USD, të ardhura në momente të ndryshme mbërritje në Amerikë nga secili nga ne*. Pra, secili prej tyre ka pasur rreth 20.000 USD, në momente të ndryshme të mbërritjes në Amerikë. Kështu, ai, prindërit dhe vëllai, kanë pasur së bashku shumën 60.000 USD.

<sup>49</sup>[CPS Historical Poverty Footnotes \(census.gov\)](http://www.census.gov/hhes/www/cps/cps-historical-poverty-footnotes.html)

<sup>50</sup>Sipas deklarimeve të subjektit në pyetësin standard, qiraja është 1.500 USD, për periudhën 1.1.2005 – 31.8.2010 dhe 1.800 USD, nga 1.9.2010 – 31.7.2012, kohë kur subjekti dhe familja janë zhvendosur në shtëpinë e blerë prej tyre në maj të vitit 2012. Këto vlera janë verifikuar në website nga ku ka rezultuar se ato janë në nivelin e vlerave të tregut të zonës B., New York.

<sup>51</sup>Për periudhën e analizuar janë përfshirë subjekti me bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij, vëllai dhe bashkëshortja e tij dhe dy prindërit.

<sup>52</sup>Shih përgjigjen e pyetjes 9, te pyetësi standard.



përmbajtur gjithnjë kushteve thelbësore të kontratës së shitjes së datës 17.2.2012 dhe kushteve të pagesës të përcaktuara në të; (ii) *downpayment*/kapar ka qenë 29.000 USD, sikurse është deklaruar, ndërsa pjesa tjetër nuk quhet *downpayment*/kapar, por pagesë e diferencës nga vlera e kredisë që banka aprovoi; (iii) pagesat për shumën 46,638.43 USD, janë veprime të kryera në kohë reale, me çek bankar dhe të pandryshueshme; (iv) ka qenë ai vetë që ka paraqitur dokumente bankare ku evidentohet se shuma e financuar e kredisë është 217.500 USD, me dorëzimin e DPDFD-në e vitit 2014 ashtu edhe *Vetting*; (v) DPDFD në gusht të vitit 2014 ka qenë deklarimi i tij i parë dhe ai nuk ka pasur as eksperiencë në plotësimin e formularëve as kohë të mjaftueshme për të analizuar dhe kuptuar qartë formularin e deklarimit.

### **Vlerësimi i Komisionit, arsyetuar mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**47.** Në analizë të parashtrimeve të subjektit, Komisioni arsyeton se:

**47.1.** Është e vërtetë se në DPDFD-në e vitit 2014, subjekti si burim për blerjen e pasurisë në vlerën 290.000 USD ka deklaruar pagimin e këstit fillestar prej 29.000 USD, si dhe kredi nga W.F. Bank në vlerën 261.000 USD. Gjithashtu, është vërtetuar se vlera e aprovuar dhe e disbursuar kredisë ka qenë 217.500 USD, dhe se *downpayment*/kapari prej 29.000 USD është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa diferenca prej 46.638,43 USD është paguar në datën 21.5.2012, me pjesëmarrje të barabartë nga dy vëllezërit në investimin e tyre dhe në lidhje me pagesën e kësaj vlere subjekti nuk ka kryer deklarime.

**47.2** Por, me qëllim një vlerësim sa me objektiv dhe ligjor të deklarimit të pasaktë të vlerës së kredisë dhe mungesës së deklarimit të pagesës 46.638,43 USD në datën 21.5.2012, për blerjen e shtëpisë në New York, Komisioni i është referuar këtyre fakteve:

- Në kontratën e shitjes së pasurisë, datë 17.2.2012, si vlerë e përballuar me kredi bankare është shënuar vlera 261.000 USD. Duke qenë se DPDFD-në e plotësuar në vitin 2014, ka qenë e para për subjektin, pasi është rikthyer në detyrë, argumenti i tij se gjatë deklarimit i është referuar shumës së kredisë përcaktuar në kontratën e shitjes dhe për të qenë konsistent me këtë kontratë, vlerësohet i bazuar, deklarim i cili ka vijuar më pas edhe në pyetësorin standard, për të qenë në të njëjtën linjë deklarimesh. Për më tepër në DPDFD 2014, në rubrikën detyrime financiare, subjekti ka deklaruar kredinë në vlerën 217.500 USD, e cila është ekzaktësisht vlera e kredisë së aprovuar nga banka, një fakt që tregon se subjekti nuk ka pasur si qëllim që të fshihte masën e aprovuar të kredisë.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar çmimin e blerjes së shtëpisë prej 290.000 USD me burim kursime të akumuluar para emërimit si gjyqtar në datën 10.7.2014 dhe kredi pranë W. F. Bank, por pa specifikuar shumën e secilit prej burimeve, gjë e cila e bën deklarin e tij jo shterues por jo të pasaktë.

- Po kështu, në deklaratën *Vetting* në rubrikën *detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë tek W. F. Bank, duke specifikuar kohëzgjatjen e saj, normën e interesit, këstin mujor, si dhe shumën e detyrimit të mbetur prej 184.646 USD, detyrim i cili i korrespondon një kredie në shumën fillestare rreth 215.000 USD, fakt që e ben këtë një deklarim të saktë, sa i takon shumës së kredisë së përdorur për blerjen e pasurisë.

- Edhe në mungesë të një deklarimi specifik në deklaratën *Vetting* të shumave të paguara nga kredimarrësit dhe shumës së kredisë, referuar akteve shkresore të paraqitura nga subjekti qoftë përpara Komisionit, qoftë përpara ILDKPKI-së, të cilat vërtetojnë çmimin e blerjes së pasurisë prej 290.000 USD dhe vlerën e kredisë së përdorur prej 214.362 USD, është e qartë se diferenca e paguar nga dy vëllezërit është në vlerën 75.638 USD, dhe është paguar në këtë mënyrë: shuma 29.000 USD është paguar si kapar në datën 16.2.2012 me lidhjen e kontratës dhe shuma 46.638 USD paguar me çek bankar në datën 21.5.2012.

- Komisioni vlerëson pozitivisht faktin që gjatë hetimit administrativ, menjëherë sapo u evidentua se shuma e kredisë bankare të aprovuar ka qenë në vlerën 217.500 USD dhe jo në vlerën 261.000 USD, sikurse subjekti e kishte deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2014, pasi subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente shkresore, brenda afatit të përcaktuar, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ai ka dhënë shpjegime të plota e shteruese bazuar në dokumente shkresore, duke vërtetuar shkaqet e kryerjes së pagesës prej 46.638 USD nga vëllai i tij dhe duke pranuar se kjo shumë është përbashkuar me shpenzime të përbashkëta, ndonëse pagesa ishte kryer vetëm prej vëllait të tij.

**47.3.** Bazuar në këto fakte dhe rrethana, Komisioni i çmoi bindëse pretendimet e subjektit duke vlerësuar se:

(i) deklarimi i kredisë së marrë nga W. F. Bank si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt verifikimi jo në vlerën 217.500 USD por në vlerën 261.000 USD, në DPFĐ-në e vitit 2014 (dhe pyetësorin standard), është bërë duke iu referuar përcaktimit të kontratës së shitjes së datës 17.2.2012, ndërkohë që në rubrikën detyrime financiare të DPV-së për vitin 2014, subjekti ka deklaruar saktësisht kredinë në vlerën 217.500 USD;

(ii) mosdeklarimi në DPFĐ-në e vitit 2014, por edhe në vijim në pyetësorin standard, i shumë prej 46.638 USD paguar nga vëllai i subjektit në datën 21.5.2012, nuk është bërë me qëllim fshehjen e kësaj pagese, por për të qenë në të njëjtën linjë me kontratën e shitjes me datë 17.2.2012, sidomos në kushtet kur është vërtetuar se pagesa e kësaj shume është kryer me çek në rrugë bankare, një fakt lehtësisht dhe tërësisht i evidentueshëm. Për më tepër, në përfundim të procesit, u vertetua se subjekti dhe vëllai i tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për të kryer këtë pagese brenda datës 21.5.2012, çështje e trajtuar në vijim, në paragrafët 48 dhe 49 të këtij vendimi.

(iii) Për rrjedhojë, pasaktësitë e evdientuara të cilat nuk kanë sjellë asnjë pasojë, nuk mund të përbejnë shkak për penalizim të subjektit. Në këtë vlerësim, Komisioni i referohet edhe qëndrimit tashmë të konsoliduar nga Kolegji dhe praktikës së Komisionit, të cilat konsiderojnë se pasaktësitë në deklaratimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore<sup>53</sup>, në rastet kur nuk kanë sjellë pasojë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet në pikën (iii) të paragrafit 45.**

**48.** Sa i takon konstatimit se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar në total shumën prej 75.638,43 USD, pagesë e kryer brenda datës 21.5.2012, subjekti ka kundërshtuar këtë konstatim duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

**48.1** Subjekti ka pretenduar se ka paraqitur dokumentacion për të ardhura të tjera të tij dhe familjarëve të tij gjatë viteve të qëndrimit në SHBA dhe konkretisht:

---

<sup>53</sup>Në vendimin nr. 22, datë 16.9.2019, paragrafi 19, i Kolegjit, arsyeton se: “*Trupi gjykues, megjithëse e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se deklaratimet periodike të subjektit kanë pasaktësi, vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, pasaktësitë në deklaratimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore*”. Në vendimin nr. \*\*\* datë 15.12.2019, subjekti D. M., i Komisionit arsyeton se: “*Në pikëpamjen formale, mungesa e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasuri të bashkëjetuesit në deklaratat periodike për vitet 2012 dhe 2013, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo interesi privat të subjektit të rivlerësimit dhe as të bashkëjetuesit dhe si të tilla nuk janë konsideruar si shkak për penalizim të saj*”.

i) kthimin e taksave nga shteti amerikan për Kastriot dhe M. G. në vlerën totale 31.637 USD<sup>54</sup> dhe në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka paraqitur dokumentet e kthimit të taksave *Tax return* për vitet 2007 – 2015;

ii) kthimin e taksave nga shteti amerikan për vëllain e tij K. G. në vlerën totale 4.018 USD dhe në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka paraqitur dokumentet e kthimit të taksave *Tax return* për vitet 2010 deri 2012<sup>55</sup>.

iii) të ardhura të babait të tij Gj. G., për periudhën qershor 2004 – qershor 2014, duke argumentuar se në lidhje me këto të ardhura:

- ka mundur të paraqesë deklaratë të ardhurash nga *IRS* vetëm për vitet 2007-2008-2009, megjithëse babai i tij ka punuar qysh kur ka mbërritur në SHBA, por është në pamundësi objektive të paraqesë deklaratë nga *IRS* për vitet e tjera deri në 2012, kur është blerë pasuria. Në mbështetje të këtyre pretendimeve ka paraqitur legjislacionin amerikan për detyrimin kohor të ruajtjes së dokumentacionit nga 3 deri maksimumi 10 vjet<sup>56</sup>;

- ka vërtetuar që babai ka përfutur pension të parakohshëm duke filluar nga datë 12.6.2014<sup>57</sup>, duke paraqitur legjislacionin amerikan, i cili parashikon dy kushte kumulative për marrjen e pensionit të cilat janë: (a) mbushja e moshës 62 vjeç; dhe (b) pasja e të paktën 10 vjet punë<sup>58</sup>.

iv) subjekti kërkon që Komisioni të përdorë metodën e analogjisë dhe të konsiderojë të ardhura të babait të paktën nga qershor 2004, në vlerën 10.494 USD në vit që është vlera mesatare e pagës për vitet 2007-2009, vite kur subjekti ka mundur të ruajë dhe ka paraqitur dokumentacion. Konkretisht, subjekti kërkon që të ardhurat e babait deri në datën 21.5.2012, të konsiderohen në shumën 77.834 USD, në vend të 31.483 USD, të prezantuara në analizën financiare të Komisionit.

**48.2.** Subjekti ka parashtruar se shuma në total që kanë marrë me vete kur kanë shkuar në SHBA ka qenë 20.000 USD (e cila ka shërbyer për shpenzimet fillestare në Amerikë) dhe jo 60.000 USD, sikurse është kuptuar dhe përllogaritur nga Komisioni në rezultatet e hetimit, duke theksuar se lejimi i hyrjes në SHBA presupozonte marrjen me vete të shumave monetare të caktuara. Burimi i kësaj shume ka qenë të ardhura të biznesit të babait ndër vite.

**48.3.** Subjekti ka kundërshtuar shpenzimet e jetesës të përllogaritura nga Komisioni për çdo vit, nga viti 2005 deri në maj të vitit 2012, duke u ndalur në dy momente: (i) shpenzimet për një person duhet të përllogariten si përpjesëtimore midis shpenzimeve familjare dhe jo si shpenzime të një personi kur ai jeton më vete; (ii) vëllai i tij ka punuar në restorant (provuar me deklaratën e të ardhurave vjetore *IRS*) dhe ka ngrënë atje dy vakte ditore. Në këtë mënyrë subjekti ka ripërllogaritur shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, nga e cila rezulton se ato janë 217.900 USD dhe të reduktuara me 26.700 USD, krahasimisht me ato të përllogaritura nga Komisioni.

**48.4.** Subjekti ka kërkuar që të rishikohen përllogaritjet e kryera nga Komisioni, për të përcaktuar gjendjen e llogarive bankare të tij dhe të familjarëve në datën 21.05.2012 dhe 31

<sup>54</sup>Shih dokumentet e sjella në seancën dëgjimore të datës 15.2.2022.

<sup>55</sup>Shih faqe 284-290, te dokumentet e sjella me parashtrimet e subjektit.

<sup>56</sup>Shih <https://www.irs.gov/individuals/transcript-types-and-ways-to-order-them> në të cilën përcaktohet se kopja e dokumentit të taksave (Tax Account Transcript) tregon të dhëna bazike si statusin e regjistrimit, të ardhurat e taksueshme dhe llojet e pagesave, gjithashtu tregon ndryshimet e bëra. Kopja e dokumentit është e disponueshme për vitin aktual dhe 9 vitet e mëparshme tatimore nëse individi e kërkon atë përmes internetit, dhe për vitin aktual dhe 3 vitet e mëparshme tatimore nëse në se individi e kërkon atë me postë ose duke telefonuar. Vitet tatimore të shkuara mund të merren duke paraqitur Formularin \*\*\*.

<sup>57</sup>Shih faqe 291-294, te dokumentet e sjella me parashtrimet e subjektit.

<sup>58</sup>Shih faqe 295-294, te dokumentet e sjella me parashtrimet e subjektit.

dhjetor të viteve 2013 dhe 2014, në mungesë të informacionit dhe dokumentacionit shkresor. Kështu, subjekti pretendon se për shkak të shtimit të të ardhurave nga kthimi i taksave të subjektit dhe të vëllait të tij, është rritur aftësia kursyese e secilit, duke ndryshuar kështu edhe gjendja e likuiditeteve që ata kanë patur në banka. Konkretisht, subjekti konkludon se gjendja e llogarive të tij bankare në datën 21.5.2012 duhet të jetë në shumën 79.901 USD<sup>59</sup> dhe gjendja e llogarive bankare të vëllait në datën 21.5.2012 duhet të jetë në shumën 60.725 USD<sup>60</sup>

**48.5.** Subjekti deklaron se, gjithsesi, në rrethanat kur transaksioni për blerjen e kësaj banese i përket një periudhe para detyrës dhe kur ai nuk ka qenë as subjekt deklarues, kjo pasuri nuk i duhet nënshtruar hetimit të thelluar. Ai sjell në vëmendjen e Komisionit praktikën dhe jurisprudencën e konsoliduar të organeve të *Vetting*-ut, të cilat arsyetojnë se *nuk i duhet nënshtruar hetimit të thelluar, burimi i të ardhurave që kanë shërbyer në blerjen e një apartamenti nga subjekti i rivlerësimit, në rastet kur periudha e blerjes së këtij apartamenti i përket një periudhe kur subjekti i rivlerësimit nuk ishte subjekt deklarimi*<sup>61</sup>.

**48.6.** Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur një analizë financiare, për periudhën 2005 – 21.5.2012, sipas së cilës ai dhe familja e tij kanë pasur mundësi të krijojnë shumën e depozitave bankare, si dhe të përballojnë pagesat e kryera për blerjen e shtëpisë, për shkak të një balance pozitive prej 18.340 USD.

**48.7.** Me riçeljen e hetimit administrativ, me qëllim shterimin e hetimit në lidhje me pasuritë e krijuara dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës në SHBA gjatë viteve 2003 dhe 2004, iu kërkua subjektit: (i) të paraqesë çdo dokument shkresor në formën e kërkuar nga ligji, i cili të provonte punësimin e tij dhe familjareve të tij gjatë kësaj periudhe; si dhe (ii) arsyet e hapjes së llogarisë bankare në gusht të vitit 2004<sup>62</sup> dhe vijueshmërinë e saj. Në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti ka parashtruar se:

- Sa i takon të ardhurave të tij dhe familjarëve gjatë viteve 2003 dhe 2004, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me atë gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar edhe një herë se për këto vite nuk disponon dokumentacion provues për të ardhurat e realizuara nga ana e tyre dhe ato kanë qenë mesatarisht në të njëjtat nivele si në vitet pasuese. Subjekti pretendon përsëri se është në kushtet e pamundësisë objektive për t'i siguruar këto dokumente, pasi ato kanë humbur ose nuk janë ruajtur për shkaqe faktike dhe ligjore, duke sjellë në vëmendje afatin maksimal 10-vjeçar të ruajtjes së këtij dokumentacioni edhe nga vetë shteti amerikan<sup>63</sup>. Kujtojmë këtu që subjekti, pavarësisht se ka dhënë shpjegime sa herë i është kërkuar nga Komisioni edhe për periudhën përpara vitit 2005, ka pretenduar që analiza financiare për periudhën e qëndrimit në Amerikë, duhet të fillojë në vitin 2005 dhe jo në vitin 2003, kur ka pasur të dhëna të dokumentuara si dhe referuar faktit se në këtë vit ai ka blerë pasurinë e parë në SHBA, autoveturë.

- Sa i takon hapjes së llogarisë bankare të tij në gusht të vitit 2004, subjekti ka sqaruar se hapja e saj është bërë pas formalizimit të statusit të qëndrimit në SHBA dhe se arsyeja parësore ka qenë për të shmangur kostot financiare për kthimin e çeqeve në *cash*, të pagës së tij. Ai ka

<sup>59</sup> Vlera 90.421 USD e përllogaritur nga Komisioni në datën 21.5.2012; vlera 10.520 USD taksat e rimbursuara në vitin 2013, sipas dokumentit të datës 19.2.2013.

<sup>60</sup> Vlera 76.924 USD e përllogaritur nga Komisioni në datën 21.5.2012; vlera 10.007 USD taksa të rimbursuara në vitin 2013 dhe vlera 6,192 USD taksa të rimbursuara në vitin 2014.

<sup>61</sup> Subjekti i referohet vendimit të formës së prerë nr. \*\*\*, datë 20.5.2021, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit M. L., në lidhje me pasurinë apartament në pronësi ekskluzive të subjektit të rivlerësimit, pa ndonjë mëdyshje arsyeton dhe pohon: "4.19...Komisioni në vijueshmërinë e hetimit mbajti në vëmendje periudhën e krijimit të pasurisë që në këtë rast daton përpara se subjekti i rivlerësimit të niste ushtrimin e detyrës dhe, për rrjedhojë, as edhe nuk ishte subjekt deklarues".

<sup>62</sup> Deklaruar në DPFID plotësuar në gusht të vitit 2014, në deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit administrativ

<sup>63</sup> <https://www.irs.gov/individuals/transcript-types-and-ways-to-order-them>

vazhduar të sqarojë se, gjithsesi, hapja e një llogarie bankare në SHBA është domosdoshmëri dhe komoditet në jetën e përditshme, si dhe në SHBA individi gjendet financiarisht i mbikëqyrur nga sistemi bankar dhe i kontrolluar nga institucionet shtetërore dhe federale të ngarkuara me mbledhjen e taksave, *IRS*. Subjekti deklaron, gjithashtu, se llogaria bankare vijon të jetë aktive dhe gjendja e saj në fund të çdo viti kalendarik reflektohet në DVP-të vjetore.

### **Vlerësimi i Komisionit bazuar në provat e administruara dhe në ligjin e zbatueshëm**

**49.** Në analizë të çdo pretendimi e dokumenti ka paraqitur në parashtrimeve e datës 08.03.2022, në përgjigje të pyetësorit nr. 6, pas riçeljes së hetimit administrativ për kriterin pasuror, si dhe në të dyja seancat dëgjimore, sa i takon mundësisë financiare të subjektit dhe vëllait të tij për të paguar me të ardhura të ligjshme shumën 75.638 USD për blerjen e shtëpisë, Komisioni vlerësoi të bazuara pretendimet e subjektit, rishikoi analizën financiare dhe kreu ndryshimet përkatëse si vijojnë:

- Përfshirjen në rubrikën të ardhura të analizës financiare të shumave të kthimit të taksave nga shteti amerikan për Kastriot dhe M. G., të cilat për periudhën e analizuar 2005 – 21.5.2012, janë në vlerën totale 31.637 USD<sup>64</sup>.

- Përfshirjen në rubrikën të ardhura të analizës financiare të shumave të kthimit të taksave nga shteti amerikan për vëllain e tij K. G. në vlerën totale 4.018 USD.

- Përfshirjen si të ardhura të ligjshme nga puna e babait Gj. G., për vitet 2005, 2006 dhe 2010-2012, vite për të cilat subjekti ka provuar se babai i tij ka punuar, por është në pamundësi objektive të sjellë dokumentacion shkresor për të vërtetuar të ardhura konkrete. Të ardhurat për këto vite janë konsideruar në shumën 10.300 USD/vit, e cila është paga më e ulët e viteve 2007-2009, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion në pyetësorin nr. 2.

- Nga shuma e të ardhurave vjetore të përfituara nga babai, gjykohet se nuk ka punuar me kohë të plotë ose gjatë gjithë vitit. Në këtë konkluzion arrihet, bazuar në këto fakte: (i) duke krahasuar të ardhurat vjetore të Gj. G. me djalin e tij K. G.<sup>65</sup>, i cili ka punuar me kohë të plotë (të ardhurat e këtij të fundit janë 2.5 deri 3 herë më të larta se të babait të tij); (ii) nga verifikimi i sistemit *TIMS* ka rezultuar se Gj.G. dhe bashkëshortja e tij jetojnë midis Shqipërisë dhe SHBA-së. Në këto kushte, të ardhurat e babait të subjektit Gj. G., nga marrja në konsideratë e këtyre pagave, janë në total në vlerën prej 45.392 USD.

- Të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit si administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., janë rishikuar duke u përlllogaritur paga *neto* në bazë të asaj *bruto*, duke zbritur mbajtjet nga ISSH dhe tatimin mbi të ardhurat, në bazë të legjislacionit të kohës<sup>66</sup>.

- Si pasojë e shtimit të të ardhurave si më sipër, është rritur aftësia kursyese e subjektit dhe e vëllait të tij, duke sjellë kështu edhe ndryshimin e gjendjes së likuiditeteve që secili nga vëllezërit kanë pasur në banka në datën 21.5.2012. Kështu, në mungesë të dokumentacionit bankar, duke ruajtur të njëjtën metodologji të aplikuar në rezultatet e hetimit dhe duke shtuar të ardhurat të tjera të provuara nga subjekti në parashtrimet e tij, gjendja e llogarive bankare të tij në datën 21.5.2012, është përlllogaritur të jetë në vlerën 64.092 USD dhe gjendja e llogarive bankare të vëllait në këtë datë, në vlerën 64.288 USD. Në total, gjendja e likuiditeteve në banka në datën e blerjes së pasurisë më 21.05.2012 ka qenë në vlerën 128.380 *Vetting*.

<sup>64</sup>Shih dokumentet paraqitur në seancën dëgjimore të datës 15.2.2022.

<sup>65</sup>Krahasimi është i mundur me vëllain e subjektit, pasi ky i fundit ka paraqitur të ardhura personale sikurse edhe babai i tij.

<sup>66</sup>Referojuni ligjit nr. 9766, datë 9.7.2007, për pagesën e TAP i cili ka hyrë në fuqi nga data 1.8.2007 dhe është aplikuar deri në vitin 2013 dhe VKM-së nr. 700, datë 18.6.2009, për kontributin e punëmarrësit në pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 11,2%.

- Shuma prej 20.000 USD<sup>67</sup>, e marrë me vete nga subjekti dhe familjarët e tij, kur kanë hyrë në SHBA, është konsideruar si e shpenzuar për mbulimin e shpenzimeve fillestare të familjes gjatë vendosjes së tyre, gjatë viteve 2003 dhe 2004. Meqenëse këto 2 vjet nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit në SHBA, ato nuk e afektojnë analizën financiare (çështje e trajtuar në vijim).

- Shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare, janë rishikuar duke marrë parasysh pjesërisht pretendimet e subjektit në parashtrimet e tij dhe duke i përlllogaritur ato bazuar në metodologjinë, sipas të cilës shpenzimet e një personi janë përpjesëtimore midis shpenzimeve familjare dhe jo si shpenzime të një personi kur ai jeton më vete. Ndërsa, pretendimi për të zbritur shpenzimet e vëllait me 2/3 për shkak se ai ka punuar në restorant, nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, pavarësisht se pohimet e subjektit duket se janë të vërteta<sup>68</sup>, pasi shpenzimet e jetesës në të cilat është bazuar Komisioni janë minimumi jetik zyrtar në SHBA, i cili presupozon një kosto minimale jetese nga i cili nuk mund të kryhen reduktime.

- Sa i takon shpenzimeve të jetesës së prindërve të subjektit, ato janë përlllogaritur sipas ditëve të vitit që ata kanë jetuar përkatësisht në SHBA dhe Shqipëri, deri sa edhe shpenzimet e udhëtimit të tyre midis dy vendeve janë përfshirë në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij të madhe. Në këtë mënyrë, shpenzimet e jetesës së familjes për periudhën 2005 – 21.5.2012 kanë rezultuar në vlerën 215.624 USD, në vend të vlerës 238.599 USD, të përlllogaritura nga Komisioni në rezultatet e hetimit.

**49.1** Sa i takon periudhës për të cilën është kryer analiza financiare e subjektit dhe e familjes së tij në SHBA, është çmuar nga Komisioni që ajo të fillojë nga viti 2005, sikurse është konsideruar edhe në rezultatet e hetimit dhe jo nga gusht të vitit 2003<sup>69</sup> referuar fakteve e rrethanave si vijojnë:

i) subjekti nuk ka krijuar pasuri në vitet 2003 dhe 2004 dhe as likuiditete të mbartura në deklaratën *Vetting* dhe, në këto kushte, Komisioni nuk mund të ketë objekt hetimi periudhën gusht 2003 – dhjetor 2004;

ii) llogaria bankare e subjektit e çelur në gusht të viti 2004<sup>70</sup> është bërë për arsye praktike dhe jo për të krijuar pasuri/likuiditete;

iii) subjekti nuk ka pretenduar që të ardhurat e periudhës gusht 2003 – dhjetor 2004 të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie të tij;

iv) në DPFD-në e vitit 2014 dhe në vijim, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI dokumente shkresore që vërtetojnë të ardhura nga viti 2005 dhe, në vijim, çka tregon se sipas deklarimeve të tij këto të ardhura kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të tij dhe jo të ardhura të viteve 2003 dhe 2004;

v) nga dokumentet mbi të ardhurat e subjektit për vitet 2010 – 2013 rezulton se dokumentet *Tax Return Transcript* janë kërkuar dhe printuar prej tij në vitin 2014<sup>71</sup>, vit kur subjekti ka pasur mundësinë që teknikisht të kishte printuar edhe të ardhurat për vitin 2004 (afati 10-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit nga IRS). Fakti që nuk e ka bërë këtë, përforcon bindjen se

---

<sup>67</sup>Në rezultatet e hetimit, Komisioni kishte kuptuar dhe përlllogaritur që subjekti dhe familja e tij kishin marrë me vetë në SHBA në vlerën 60.000 USD.

<sup>68</sup>Nga dokumentet e IRS mbi të ardhurat e vëllait K. G., nga viti 2005 deri 2012, ka rezultuar se ai punon në E\*\*\* Restaurant.

<sup>69</sup>Kohë kur subjekti dhe në vijim familja e tij janë zhvendosur në SHBA.

<sup>70</sup>Deklaruar në DPFD-në e vitit 2014, në pyetësorin standard dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 6, me parashtrimet e hetimit shtesë.

<sup>71</sup>Në fund të fletës së dokumenteve mbi të ardhurat vjetore, evidentohet se ato janë kërkuar dhe printuar nga sistemi elektronik i IRS në datën 8.5.2014

subjekti ka dashur të deklarojë se burimi i krijimit të pasurive të tij në SHBA, janë të ardhurat nga viti 2005 e në vijim. Ndërkohë, i pyetur nga Komisioni, në lidhje me të ardhura të periudhës gusht 2003 – dhjetor 2004, si në parashtrime, ashtu dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti me të drejtën ka deklaruar se sot është në pamundësi objektive ti dokumentojë këto të ardhura<sup>72</sup>.

vi) veç sa më sipër, Komisioni nuk mund të anashkalojë faktin që si periudha gusht 2003 – dhjetor 2004, ashtu dhe periudha 2005 – 2012, kur është blerë pasuria, i përkasin periudhës jashtë ushtrimit të detyrës dhe kur subjekti ka qenë në SHBA. Referuar qëndrimin të mbajtur nga Komisioni në disa vendime të formës së prerë<sup>73</sup>, pozita e subjekteve të rivlerësimit nuk mund të rëndohet me qëllim provueshmërinë e ligjshmërisë së pasurive me të ardhura të cilat nuk janë krijuar dhe as nuk lidhen me periudhën e rivlerësimit kalimtar e në këtë mënyrë subjektet e rivlerësimit nuk mund të penalizohen për këtë arsye.

**49.2** Në përfundim të procesit, duke marrë në konsideratë disa nga pretendimet dhe dokumentet shkresore përshkruar e arsyetuar si më sipër, me pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në analizën financiare dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, u vërtetua se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar shumën 75.638 USD deri në datën 21.5.2012 për blerjen e shtëpisë, pasi në analizën financiare të rishikuar nga ana e Njësisë së Shërbimet Ligjor, balanca negative bëhet nga -131.085 USD, në + 11.596 USD.

### **Pasuria e tretë e paluajtshme e deklaruar në deklaratën Vetting**

**50.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *pasuri e paluajtshme me sip. 14,190 m<sup>2</sup>, D\*\*\*, Shkodër. Vlera papërcaktuar. Pjesa takuese: 25 %. Burimi i krijimit: përfituar me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991.*

ILDKPKI-ja ka konstatuar se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti përputhet me përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër. Sa i përket deklaratimit të sipërfaqes nga subjekti, ka diferenca me dokumentacionin dhe nuk është i qartë deklarimi. Gjithsesi, toka është përfituar nga ligji nr.7501 “Për tokën”.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**51.** ASHK-ja Drejtoria Vendore Shkodër<sup>74</sup> ka konfirmuar se nuk rezulton të ketë të dhëna për subjektin dhe personat e lidhur me të, bashkëshortja dhe fëmijët. Ndërsa në aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së, rezultojnë dy kartela të pasurive sipas të cilave, në pronësi të përfaqësuesit të familjes/babait të subjektit Gj. N. G. janë regjistruar: (i) pasuria nr.\*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit arë me sip. 6010 m<sup>2</sup>, sipas AKT \*\*\* dhe \*\*\* sipas LNQershor 98, në adresën S\*\*\*-D\*\*\*, Shkodër; (ii) pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit arë me sip. 3.104 m<sup>2</sup>, në adresën S\*\*\*-D\*\*\*, Shkodër.

**52.** Duke qenë se në këto kartela, sipërfaqja e tokës bujqësore në total ka qenë më e vogël se sipërfaqja që subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, u pyet subjekti, i cili në përgjigje të

<sup>72</sup>Në parashtrimet e tij, subjekti përsërit të njëjtin qëndrim që ka mbajtur gjatë hetimit administrativ se ai dhe familjarët kanë punuar sapo kanë shkuar në SHBA dhe se ka deklaruar në fillim të vitit 2005 për të ardhura të gjeneruara gjatë viteve 2003-2004, por nuk mund t'i gjenerojë ato për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumentacionit nga IRS.

<sup>73</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 20.5.2021, prgf, 4.19, i Komisionit, parashikon se: “Komisioni në vijueshmërinë e hetimit mbajti në vëmendje periudhën e krijimit të pasurisë që në këtë rast daton përpara se subjekti i rivlerësimit të niste ushtrimin e detyrës dhe, për rrjedhojë, as edhe nuk ishte subjekt deklarues”; vendimi nr.\*\*\*, datë 22.4.2021, prgf.1.26, i Komisionit: “...në raport me rrethanat e paraqitura, se hetimi mbi burimet e kësaj pasurie .... duke mos qenë në marrëdhënie pune dhe as në detyrë ...në raport me vlerësimin tërësor të procesit, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë kualifikimi ligjor për pozitën e saj si subjekt rivlerësimi”.

<sup>74</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore Shkodër, në dosjen e Komisionit; aneks \*\*\* në dosjen ILDKPKI-së; shkresën kthim përgjigje ASHK DV Shkodër dokumentet e pyetësorit nr. 2.

pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se në fakt janë katër kartela pasurie, duke paraqitur shkresën nr.\*\*\* prot., datë 7.10.2021, të ASHK-së Drejtoria Vendore Shkodër, ku sipërfaqja totale e pasurie rezulton në 14.190 m<sup>2</sup> dhe, konkretisht, në emër të shtetasit Gj. N. G. (babai i subjektit) figurojnë pasuritë: (i) pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 3442 m<sup>2</sup>, certifikuar në datën 28.7.2003; (ii) pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit pemëtore me sipërfaqe 1659 m<sup>2</sup> nga të cilat 200 m<sup>2</sup> truall nga ku 148 m<sup>2</sup> ndërtesë, e certifikuar në datën 28.7.2003; (iii) pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit arë me sip. 3104 m<sup>2</sup>, e certifikuar në datën 28.7.2003; (iv) pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit arë me sip. 5985 m<sup>2</sup>, e certifikuar në datën 28.7.2003.

**53.** Bazuar në sa më sipër, u vërtetua se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar sipërfaqen reale prej 14,190 m<sup>2</sup> përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, pasuri e cila është regjistruar në katër pasuri të ndara që në vitin 2003. Gjithashtu, subjekti paraqiti dhe certifikatën e gjendjes familjare, datë 1.8.1991, të përbërë nga katër anëtarë, subjekti, prindërit dhe vëllai.

**54.** Në lidhje me përdorimin e tokave bujqësore, subjekti ka shpjeguar se administrohen nga xhaxhai i tij dhe nuk ka deklaruar asnjë të ardhur të siguruar prej tyre. Gjithashtu, subjekti deklaroi se prindërit e tij kanë në pronësi dhe banesën e tyre me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 1659 m<sup>2</sup>, nga të cilat 200 m<sup>2</sup> janë truall dhe 148 m<sup>2</sup> ndërtim.

**55.** I ripyetur nga Komisioni në lidhje me periudhën e ndërtimit të pasurisë, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se shtëpia është ndërtuar nga babai i tij në vitet 1981-1982 dhe në vitin 1995 është ngritur kati i dytë vetëm si karabina (muret dhe çatia), kat i cili është i pabanueshëm edhe sot. Në lidhje me kontributin e tij mbi ndërtimin, subjekti shpjegoi se nuk ka kontribuar, pasi në vitet 1981-1982 ka qenë 6-7 vjeç dhe në vitin 1995 ka qenë student. Pra, sipas subjektit, investimet në këtë banesë janë kryer para vitit 2003 dhe pas këtij viti deri në vitin 2014 subjekti ka qenë në SHBA. Për të vërtetuar këto deklaratime, subjekti ka vënë në dispozicion certifikatën e pronësisë ku rezulton që pasuria është regjistruar FAMILJAR në vitin 2003, foto të jashtme të banesës dykatëshe dhe foto të brendshme të katit të dytë të papërfunduar.

**56.** Referuar sqarimeve e dokumenteve të paraqitura, nisur dhe nga fakti që subjekti është larguar në SHBA në vitin 2003 (pasi pasuria ishte regjistruar), ku ka qëndruar deri në korrik të vitit 2014, vërtetohet se subjekti nuk ka kryer investime në këtë pasuri.

**57.** Në përfundim të hetimit administrativ, pavarësisht se nuk ka pasur problematika për këtë pasuri, subjekti nuk ka deklaruar në DPV-të, ndër vite, bashkëpronësinë në 25% të pasurive të pandara mbi tokën arë, si pjesë përbërëse e familjes bujqësore mbi pasuritë toka arë të përfituara nga ligji nr. 7501. Sipas nenit 52 të ligjit nr.84/2016, subjekti duhet të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

**58.** Në parashtrimet e tij subjekti deklaroi se mosdeklarimi në DPFV-në e vitit 2014 ka qenë një pakujdesi për shkak të harresës dhe padijenisë, duke qenë hera e parë për plotësimin e një deklaratë pasurie dhe, si e tillë, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e pjesës së tij takuese. Sipas tij, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, deklarata *Vetting* është provë dhe saktësia e deklaratave periodike është e rëndësishme për të kuptuar gjendjen reale financiare të subjektit dhe për të vërtetuar nëse ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë. Në argumentet e tij subjekti i është referuar jurisprudencës së organeve të *Vetting*-ut dhe vendimit nr. 32/2019, të Kolegjit.

**59.** Në analizë të deklaratimeve të subjektit dhe gjithë rrethanave të çështjes, në kushtet kur nuk kanë rezultuar dyshime e problematika në lidhje me pasurinë objekt verifikimi dhe as



kontribute të subjektit në investimin mbi të, Komisioni i vlerësoi të bazuara pretendimet sipas të cilave, subjekti e ka deklaruar pjesën e tij takuese prej 25 % në deklaratën *Vetting* dhe nga dokumentacioni zyrtar i depozituar gjatë hetimit<sup>75</sup> ka rezultuar se kjo pasuri është përfituar nga ligji nr. 7501. Në këto kushte, mosdeklarimi i 25% të pjesës takuese të subjektit në tokën e përfituar nga ligji nr. 7501 dhe banesën e ngritur mbi një nga sipërfaqet e përfituara nga babai i tij si kryefamiljar të krijuara përpara vitit 2003, nuk duhet kualifikuar si deklarim i pamjaftueshëm të kriterit pasuror dhe nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra.

### **Pasuri të luajtshme të deklaruara në deklaratën *Vetting***

**60.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *autoveturë BMW, viti i prodhimit 1999, me targa \*\*\*. Blerë në datën 22.6.2005, aktualisht në \*\*\* N. A., B., New York \*\*\*, (USA). Çmimi i blerjes 13,000 (trembëdhjetë mijë)USD. Pjesa takuese: 100 %.* Nuk është deklaruar burimi.

ILDKPKI-ja ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti konfirmon automjetin e deklaruar, por jo vlerën monetare të paguar për të. Subjekti ka paraqitur dokumentacion të pjesshëm sa i përket automjetit tip BMW që ka në SHBA, blerë në vitin 2005.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**60.1.** Sipas certifikatës së pronësisë lëshuar në datën 22.6.2005 nga shteti i New York-ut, mjeti BMW, model i vitit 1999, rezulton në pronësi të shtetasit Kastriot Gramshi. Në DPDFD-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar si burim për këtë mjet *të ardhura nga pagat*. Nuk ka një akt shkresor që të vërtetojë çmimin e blerjes se mjetit.

**60.2.** Ky mjet është blerë gjatë periudhës që subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe banonte në SHBA. Nga dokumentet e administruara, duket se deri në qershor të vitit 2005, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë automjetin në vlerën 13.000 USD (kjo vlerë i është referuar deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*).

| <i>Përshkrimi – në dollarë amerikanë (USD)</i>       | <b>Viti 2005</b> |
|--|------------------|
| <b>PASURI</b>  | <b>13 000</b>    |
| Autoveturë tip BMW ***, datë 22.6.2005 (në New York) | 13 000           |
| <b>TË ARDHURA dokumentuar</b>                        | <b>54 672</b>    |
| Të ardhura familjare të subjektit                    | 28 880           |
| Të ardhura nga paga e vëllait K. G.                  | 24 394           |
| Të ardhura babait nga Shqipëria                      | 1 398            |
| <b>SHPENZIME</b>                                     | <b>46 191</b>    |
| Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare           | 27 591           |
| Qira banese 1.500 USD/muaj                           | 18 000           |
| Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i> , subjekti            | 600              |
| <b>Mundësia për kursime</b>                          | <b>-4 519</b>    |

**60.3.** Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me këtë mjet, sipas nenit 53 të ligjit nr.84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve, duket se: (i) në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka provuar me dokumentacion vlerën e blerjes së automjetit në vitin 2005, si dhe nuk ka deklaruar sipas ligjit burimin e të ardhurave me të

<sup>75</sup>Shih dokumentet bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2021, të ASHK-së Shkodër.

cilat është blere ky mjet; (ii) nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e tij, për shkak të një balance negative prej në vlerën 4.519 *Vetting*.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**61.** Sa i takon mungesës së të dhënave për vlerën e mjetit në momentin e blerjes, subjekti ka parashtruar se nuk ka një dokument për të provuar vlerën e mjetit, pasi e ka dhënë këtë mjet për donacion në vitin 2018, ashtu sikurse ka vërtetuar gjatë hetimit administrativ, me aktin *faturë zyrtare të organizatës \*\*\**, datë 10.4.2018<sup>76</sup>, sipas të cilës vërtetohet dhurimi i makinës BMW 5, series 1999. Gjithashtu, subjekti ka kundërshtuar balancën negative, duke parashtruar se nuk është dakord që Komisioni në analizën e vitit 2005 nuk ka përfshirë kursimet e familjes së tij deri në fund të vitit 2004 në SHBA, pasi ai, vëllai dhe babai kanë punuar menjëherë pasi kanë shkuar në Amerikë. Sidoqoftë, edhe nëse në analizën përfundimtare nuk do të konsideronim të ardhura për vitet 2003-2004, sikurse Komisioni kishte vepruar në përfundim të hetimit administrativ, ulja e shpenzimeve të jetesës, si dhe marrja në konsideratë të të ardhurave nga puna e babait për vitin 2005, pranuar nga Komisioni në vlerën 10.300 USD, sikurse arsyetuar në paragrafin 49 të këtij vendimi, ndryshon balancën negative të vitit 2005 nga vlera 4.519 USD në një balancë pozitive në vlerën prej 9.903 USD.

**62.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *autoveturë tip “Daimler Benz”, viti i prodhimit 1993, me targa \*\*\**, në pronësi të Gj. G. (babi). Në përdorim.

ILDKPKI-ja ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTR-së. Subjekti ka paraqitur dokumentacion që vërteton pronësinë e babait të tij mbi automjetin tip “Daimler Benz”, por nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për vërtetimin e deklarimit të tij se e përdor këtë automjet.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**63.** DPSHTRr-ja<sup>77</sup> ka konfirmuar se shtetasi Gj. N. G., i datëlindjes 15.10.1951 ka të regjistruar në pronësi të tij mjetin me targa \*\*\*. Mjeti “Mercedes-Benz, tip \*\*\*”, shasia \*\*\*, me targa \*\*\*, është blerë nga shtetasi Gj.G. në shumën 950,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 6.6.2009. Sipas lejes së qarkullimit rrugor lëshuar në datën 10.6.2009, targa e mjetit ka qenë \*\*\*. Sipas lejes së qarkullimit rrugor lëshuar në datën 14.7.2016, targa e mjetit ndryshoi në \*\*\*.

**63.1.** Subjekti nuk ka paraqitur dokument që vërteton përdorimin e këtij mjeti. Sa i takon periudhës së blerjes së mjetit, viti 2009, subjekti nuk ka qenë në detyrë, por banonte në SHBA. I pyetur për kohën, arsyen dhe nëse ka dokument që vërteton lejimin e përdorimit të mjetit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti deklaroi se ka filluar ta përdorë këtë mjet nga janari i vitit 2015 për nevojat familjare dhe meqenëse është përdorur brenda Shqipërisë, nuk ka qenë i nevojshëm pajisja me dokument përdorimi të noterizuar.

**63.2.** Vlera e blerjes së këtij mjeti në datën 6.6.2009, kur subjekti ka qenë në SHBA, është përfshirë në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij për periudhën 2005 – 2009, nga e cila ka rezultuar se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e tij.

| <i>Përshkrimi – në dollarë amerikanë (USD)</i>       | <i>Periudha 2005 - 2009</i> |
|--|-----------------------------|
| <b>Pasuri</b>  | <b>23 109</b>               |
| Autoveture tip BMW ***, datë 22.6.2005 (në New York) | 13 000                      |
| Blerë makinë nga babai në Shqipëri, viti 2009        | 10 109                      |

<sup>76</sup>Shih dokumentet e paraqitura në pyetësorin nr. 5.

<sup>77</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

|  |                |
|--|----------------|
| <b>Të ardhura dokumentuar</b>  | <b>373 628</b> |
| Të ardhura familjare të subjektit  | 188 325        |
| Të ardhura nga paga e vëllait K. G.  | 132335         |
| Të ardhura nga paga dhe pensioni i babait në SHBA                              | 31 483         |
| Të ardhura babait nga Shqipëria  | 21 845         |
| <b>Shpenzime</b>   | <b>248 844</b> |
| Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare                                     | 149 776        |
| Qira banese 1.500 USD/muaj   | 90 000         |
| Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i> për subjektin                    | 4 268          |
| Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i> për familjen e origjinës familja | 4 800          |
| <b>Mundësia për kursime (kumulative)</b>                                       | <b>101 676</b> |

Edhe kjo analizë ka ndryshuar pozitivisht për shkak të marrjes në konsideratë të të ardhurave të tjera të paraqitura nga subjekti me parashtrimet e tij dhe si rezultat i rishikimit të shpenzimeve, por sidoqoftë kjo nuk e afekton analizën financiare dhe, për rrjedhojë, edhe vlerësimin e Komisionit.

**64.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Depozitë “Credins Bank”, krijuar në tetor të vitit 2014 dhe gjendje në datën 31.12.2017 (e ka shkruar vitin gabim, pasi duhej 2016). Vlera: 19,608 lekë (nëntëmbëdhjetë mijë, gjashtëqind e tetë); Vlera: 1,273 euro (një mijë, dyqind e shtatëdhjetë e tre). Pjesa takuese: 100 %. Burimi: të ardhura nga paga”*.”

ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se sipas shkresës<sup>78</sup> nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2017, të “Credins Bank”, shtetasi Kastriot Gj. Gramshi ka dy llogari në këtë bankë, në lekë dhe në euro, balanca e të cilave në datën 31.12.2016 është në shumat e deklaruara nga subjekti. Deklarimi i subjektit përputhet me gjendjet e llogarive të mësipërme.

**65.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *depozitë në “Tirana Bank”, krijuar në datën 04/2003 dhe gjendje në datën 1.1.2017. Vlera: 10,339.66 (dhjetë mijë, treqind e tridhjetë e nente/66) USD. Pjesa takuese: 100 %. Burimi: të ardhura nga qiraja”*.

ILDKPKI-ja ka konstatuar se ka pasaktësi në deklarinimin e burimit të depozitës me gjendje 10.339 USD, pasi në vitin 2014 ka deklaruar si burim të ardhurat nga pagat dhe dhuratë nga prindërit, në shumën 12.000 USD, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim të ardhurat nga qiraja. Referuar kontratës së paraqitur qiraja ka filluar nga viti 2015 dhe banesa në SHBA është blerë në vitin 2012.

**65.1.** Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se “Tirana Bank”<sup>79</sup> ka konfirmuar se shtetasi Kastriot Gj. Gramshi ka llogari në dollarë në shumën e deklaruar nga subjekti në datën 31.12.2016.

**65.2.** Nga verifikimi i të dhënave bankare rezultoi se gjendja e llogarisë në datën e deklaratës *Vetting* është krijuar nga një transfertë në shumën 10.000 USD e kryer nga vëllai i subjektit në datën 27.7.2016, në “Tirana Bank”. Në pyetësorin standard, subjekti ka sqaruar se kjo transfertë është bërë për mbulimin e shpenzimeve mbi rikostruksionin dhe arredimin e apartamentit të subjektit në Tiranë, ajo është bërë nga vëllai, pasi subjekti ka qenë fizikisht jashtë SHBA-së. Ndërsa në pyetësorin nr. 2, subjekti ka deklaruar se ia ka kthyer këtë shumë vëllait të tij në datën 1.9.2016, përmes transfertës *online* nga llogaria e tij në Ch. Bank në llogarinë e vëllait në të njëjtën bankë në SHBA, e cila konsiderohet si transfertë brenda një shteti dhe kështu është

<sup>78</sup>Shih aneks \*\*\* në dosjen ILDKPKI-së.

<sup>79</sup>Shih shkresë nr. \*\*\* port., datë 6.5.2020 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 01.10.2021, të “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit; aneks \*\*\* në dosjen ILDKPKI-së.

e mundur edhe pa prezencën fizike të personit që e kryen transfertën. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur lëvizjet e llogarisë së tij në Ch. Bank, ku duket tranferta në dalje nga llogaria e subjektit për kthimin e shumës 10.000 USD. Meqenëse llogaria e subjektit në Ch. Bank furnizohet me të ardhura nga qiraja në New York<sup>80</sup>, burimi i deklaruar i subjektit në deklaratën *Vetting* “të ardhura nga qiraja” është i saktë. Ndërsa, në DPFD-në e vitit 2014, subjekti e ka deklaruar këtë llogari te “Tirana Bank”, në shumën 15.000 USD, si dhe burimin e krijimit të saj. Origjina e kësaj llogarie, burimi për krijimin e saj dhe tërheqja e saj në korrik të vitit 2016 për blerjen e pasurisë në Tiranë, janë trajtuar ne paragrafët 28.1, 33 dhe 34 të këtij vendimi. Për rrjedhojë, konstatimi i ILDKPKI-së nuk qëndron dhe deklarimi i subjektit është i saktë.

**65.3.** Sa i takon ligjshmërisë së burimit për krijimin e gjendjes së llogarisë bankare prej 10.339,66 USD në datën 31.12.2016 e krijuar në mënyrën e sipërshpjeguar, ajo është deklaruar të ketë si burim të ardhurat nga qiraja e banesës së subjektit në New York, të ardhura të cilat, bazuar në dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ, në përfundim të këtij hetimi, nuk u konsideruan të ardhura të ligjshme, pasi nuk dukej të ishin deklaruar në *IRS* për vitin 2016. Për rrjedhojë, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti i është bërë me dije se, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar depozitën objekt shqyrtimi.

**65.4.** Pas parashtrimeve që subjekti paraqiti, Komisioni vlerësoi se subjekti ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, lidhur me të ardhura nga qiratë e banesës në SHBA dhe, për rrjedhojë, pas analizës së rishikuar, pasi janë marrë në konsideratë edhe disa pretendime të subjektit në lidhje me analizën financiare, u vërtetua se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të vërtetuar krijimin e depozitës objekt verifikimi (shihni arsyetimin për të ardhurat nga qiratë në paragrafët 86-88).

**66.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Depozitë Ch. Bank (New York, USA), krijuar në gusht të vitit 2004 dhe gjendje në datën 13.12.2016. Vlera: 82,684.64 (tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër/64) USD. Pjesa takuese: 100 %. Burimi: të ardhura nga paga*”.

ILDKPKI-ja ka konstatuar se deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar. Subjekti ka pasur ndërprerje punësimi në Shqipëri për periudhën nga 2003 – 2014 dhe ka deklaruar të ardhura në SHBA, që do të trajtohen te deklarimi i tyre.

Në DPFD, subjekti e ka deklaruar këtë llogari si të çelur në gusht të vitit 2004 dhe gjendjen e saj në datën 10.7.2014 (data e emërimit të subjektit në detyrë) në shumën 97.614,28 USD. Nga verifikimi i dokumenteve të Ch. Bank të paraqitura nga subjekti me pyetësorin standard, ka rezultuar se shtetasi Kastriot Gj. Gramshi ka llogari në dollarë në shumat përkatëse të deklaruara nga subjekti në DPFD dhe në deklaratën *Vetting*.

Deklarimi i subjektit përputhet me gjendjen e llogarisë në datat 10.7.2014 dhe 13.12.2016<sup>81</sup> (burimi i kësaj llogarie është trajtuar në vijim në paragrafin 68).

**67.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *depozitë TD Bank (New York, USA), krijuar në nëntor të vitit 2013 dhe gjendje në datën 31.12.2016. Vlera: 263.51 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre/51)USD. Pjesa takuese: 50 %. Burimi: të ardhura nga paga.* ILDKPKI-ja ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.

<sup>80</sup>Të ardhurat e subjektit në SHBA nga gusht të vitit 2015, përbëhen nga qiraja e banesës në New York, kohë pas të cilës ai dhe familja e tij, jetojnë në Shqipëri.

<sup>81</sup>Bazuar në statement bankar të Ch. Bank, NY, kjo është data më e afërt me datën 31 dhjetor.

Në DPFD, subjekti e ka deklaruar këtë llogari si të çelur në nëntor të vitit 2013 dhe gjendjen e saj në datën 10.7.2014 (data e emërimit të subjektit në detyrë), në shumën 12.736,66 USD. Nga verifikimi i dokumenteve të TD Bank të paraqitura nga subjekti me pyetësorin standard, ka rezultuar se shtetasit Kastriot dhe M. G. kanë një llogari dyemërore në dollarë, të cilat kanë rezultuar të jenë në shumat përkatëse të deklaruara nga subjekti në DPFD dhe në deklaratën *Vetting*.

Deklarimi i subjektit përputhet me gjendjen e llogarisë në datat 10.7.2014 dhe 13.12.2016. (burimi i kësaj llogarie është trajtuar në vijim në vijim në paragrafin 68).

**68.** Sa i takon te ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e depozitave përshkruar në paragrafët 66 dhe 67 të këtij vendimi, në vlerën totale prej 110.351 USD, krijuar gjatë qëndrimit të subjektit në SHBA, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke përdorur metodologjinë kumulative, e cila fillon nga viti 2005 – 10.7.2014, kur subjekti është emëruar në detyrë. Sipas kësaj analize treguar në tabelën vijuese, duket se subjekti dhe familja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i krijuar këto depozita.

| <i>Përshkrimi – në dollarë amerikanë (USD)</i>                                     | <i>2005 – 10.7.2014</i> |
|--|-------------------------|
| <b>PASURI</b>  | <b>513 397</b>          |
| Shtëpi me sip. 180m <sup>2</sup> , New York, SHBA, datë 21.5.2012, b/pronar me 50% | 290 000                 |
| Autoveturë BMW ***, datë 22.6.2005 (New York)                                      | 13 000                  |
| Blerë makinë nga babai në Shqipëri, në vitin 2009                                  | 10 109                  |
| Depozituar babai te “Tirana Bank”  | 6 000                   |
| <i>Shtesa/pakësime /likuiditete</i>  | <i>110 351</i>          |
| <b>Detyrime</b>  | <b>233 414</b>          |
| Kredi nga W. F. Bank disb., më 21.5.2012   | 217 500                 |
| Shlyerja e kredisë në SHBA nga qershor i vitit 2012                                | -12 076                 |
| Kredi studentore tek Mohela  | 27 990                  |
| <b>Pasuri neto</b>   | <b>279 983</b>          |
| <b>Të ardhura të dokumentuara</b>  | <b>628 147</b>          |
| Të ardhura familjare të subjektit  | 354 000                 |
| Të ardhura nga paga e vëllait K. G.  | 206 414                 |
| Të ardhura nga paga e vëllait K. G. në Shqipëri                                    | 2 822                   |
| Të ardhura nga dividendi i shoqërisë “***” sh.p.k., në Shqipëri                    | 3 298                   |
| Të ardhura nga paga dhe pensioni i babait në SHBA                                  | 31 483                  |
| Të ardhura babait nga Shqipëria  | 25 498                  |
| Të ardhura nga pensioni i nënës në Shqipëri  | 4 632                   |
| Prurje të babait nga Shqipëria   | 0                       |
| <b>Shpenzime</b>   | <b>504 318</b>          |
| Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare <sup>82</sup>                           | 306 704                 |
| Qira banese 1.500 USD/muaj dhe 1.800 USD/muaj                                      | 139 800                 |
| Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i> , subjekti  | 7 690                   |
| Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i> , familja   | 10 200                  |
| Shpenzime për marrjen e kredisë  | 3 138                   |
| Paguar interesi i kredisë në W. F.   | 8 796                   |
| Shpenzime studimi të bashkëshortes   | 27 990                  |
| <b>Mundësia për kursime</b>  | <b>-156 153</b>         |

<sup>82</sup>Familja Gramshi ka shkuar në SHBA në këtë mënyrë: subjekti në gusht 2003, pastaj dy prindërit e tij, vëllai K.G. në prill të vitit 2004, bashkëshortja e subjektit në mars 2005 dhe bashkëshortja e vëllait në gusht të vitit 2011, të cilët kanë jetuar të gjithë së bashku deri në momentin e blerjes së shtëpisë (maj 2012) dhe shpenzimet janë mbuluar solidarisht. Pas blerjes së shtëpisë, subjekti me familjen e tij dhe dy prindërit, kanë jetuar në apartamentin 2 dhe vëllai me bashkëshorten e tij në apartamentin 1.

Vlen për t'u theksuar se në këtë balancë negative përfshihet edhe pamundësia e subjektit për të paguar shumën 75.638 USD, për blerjen e apartamentit në SHBA, në vitin 2012 (trajtuar në paragrafin 44 të këtij vendimi).

**69.** Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**70.** Në parashtrimet e veta subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer për të gjithë periudhën e qëndrimit të tij në SHBA, duke kërkuar rishikimin e saj në mënyrë që analiza t'i afrohet sa më shumë realitetit dhe situatës faktike ekonomike deri më 10.7.2014, kur është kthyer për të rifilluar detyrën. Këtë kundërshtim, subjekti e bazon në të njëjtat shpjegime të hollësishme dhe argumente të parashtruara në analizën financiare të paraqitur prej tij, deri në momentin e blerjes së shtëpisë në SHBA më 21.5.2012 (trajtuar më sipër). Ndërsa, për periudhën 21.5.2012 – 10.7.2014, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka prapësuar se në analizën financiare: (i) duhet të përfshihen shumat e taksave të rimbursuara nga shteti amerikan te subjekti gjatë viteve 2013 dhe 2014, duke përllogaritur kështu vlerën totale të rimbursimit nga taksat vetëm për familjen e tij, për periudhën e analizuar në shumën 48.556 USD; (ii) duhet të përfshihen të ardhurat nga puna e babait deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit për pension, si dhe të ardhurat nga pensioni për periudhën qershor 2014 e në vijim; (iii) për vitet 2012 dhe 2013 të ardhurat nga paga e babait të njihen sa paga mesatare e tri viteve që disponohet dokumentacion, pra 10.494 USD/vit; (i) për vitin 2014 të ardhurat duhet të jenë në shumën 12.447 USD, duke u përllogaritur paga e babait për 6 muaj, deri në qershor, dhe pas qershorit të njihet pensioni i parakohshëm i pleqërisë në masën 1.200 USD/muaj.

**70.1.** Për të mbështetur pretendimet e mësipërme, subjekti i referohet dokumenteve të cilat janë listuar dhe analizuar në paragrafin 48 të këtij vendimi, si edhe akteve shkresore si vijnë: (i) dy shkresa “njoftim pagese” që mbajnë datën 6.6.2014, lëshuar nga Dega e Sigurimeve Shoqërore e shtetit të New Yorkut, drejtuar prindërve të subjektit Gj. dhe D. G. (edhe nëna e subjektit merr pension për shkak të punës së bashkëshortit të saj në SHBA), të cilat njoftojnë se ata do të fillojnë të paguhet me pension në shumën 268 USD/muaj<sup>83</sup> nga data 12.6.2014; (ii) *statement* bankar të llogarisë së shtetasve Gj. dhe D. G. në Ch. Bank, New York, ku evidentohet se shumat e pensionit të kredituara në këtë llogari janë 1.143 USD në dhjetor të vitit 2016 dhe 1.257 USD në nëntor të vitit 2021.

**70.2** Në analizë të çdo parashtrimi të subjektit, Komisioni çmoi të bazuara disa nga pretendimet e tij, duke vlerësuar rishikimin e analizës financiare me ndryshimet si vijnë:

- përfshirjen te të ardhurat të shumave të kthimit të taksave nga shteti amerikan për subjektin për vitet 2013 dhe 2014;

- përfshirjen te të ardhurat e vlerave: (i) pagat prej 10.300 USD të babait të subjektit për vitin 2013; (ii) pagat për 6 muaj prej 5.150 USD për vitin 2014; (iii) të ardhura nga pensioni të prindërve për 6 muaj në vlerën 1.608 USD;

- rishikimin e shpenzimeve të jetesës duke konsideruar përbërjen familjare të subjektit për vitet 2013 dhe 2014, bazuar në metodologjinë e shpenzimeve përpjesëtimorë të një personi te shpenzimet familjare. Për prindërit, shpenzimet janë përllogaritur sipas ditëve të vitit që ata kanë jetuar, përkatësisht, në SHBA dhe Shqipëri.

**70.3.** Në përfundim të procesit, pas rishikimit të analizës financiare të dërguar me rezultatet e

---

<sup>83</sup>Përbërë nga 171 USD/muaj për shtetasin Gj. G. dhe 97 USD/muaj për shtetasen D. G.

hetimit administrativ, rezultoi se balanca negative nga vlera 156.153 USD u bë + 1.820 USD dhe, për rrjedhojë subjekti ka pasur mundësi të krijojë depozitat objekt verifikimi me të ardhura të ligjshme të krijuara në SHBA.

### **Detyrimet financiare**

**71.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Hua e dhënë nga S. P. (kunata) në shumën 20.000 USD, pa interes dhe pa afat te caktuar, për pagesë e detyrimeve (tuition + interesa) ndaj M. (SHBA). Shuma 20.000 USD*”.

**71.1** Në lidhje me këtë hua, rezultoi se:

- Subjekti, në DPV-në e vitit 2015, ka deklaruar *hua të dhënë nga S. P. (kunata) në shumën 20.000 USD, pa interes dhe pa afat për pagesë e detyrime (tuition + interesa) ndaj M. (SHBA).*

- Në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti ka deklaruar se në korrik të vitit 2015, nga kunata S.P. është kryer pagesa e shumës 20.000 USD për llogari të M., SHBA, e cila ka shkuar për mbylljen e huas/kredisë studentore marrë nga bashkëshortja e subjektit. Në këtë pyetësor deklaroi se huaja e mbetur ndaj znj. S.P. është likuiduar në shumën 15.000 USD dhe mbetet për t'u paguar vlera prej 5.000 USD. Bashkëngjitur ka paraqitur një letër të datës 20.1.2020, të firmosur nga znj. S. P., e cila konfirmon deklaratimet e subjektit.

- I pyetur mbi të ardhurat e shtetasve S. P. që kanë shërbyer për dhënien e huas dhe për përbërjen familjare të saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti deklaroi se në përbërjen familjare të saj janë shtetasit V. P., S. P. dhe dy vajzat e tyre, si dhe ka paraqitur kopje të deklaratimit të të ardhurave të shtetasve V. e S. P., sipas IRS-së, për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Në analizë të dokumenteve të paraqitura ka rezultuar se për vitin 2015, huadhënësja S.P. ka pasur të ardhura familjare në shumën 265.412 USD dhe shpenzime për një familje me katër persona në shumën 24.257 USD, çka provon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 20.000 USD.

**71.2.** Sa i takon shlyerjes së këtij detyrimi financiar, subjekti ka paraqitur një *statement* bankar për llogarinë e shtetasve M. dhe Kastriot Gramshi në TD Bank, New York<sup>84</sup>, ku rezultojnë katër transfertat dalëse drejt llogarisë së shtetasve V. dhe S. P., secila në shumën 5.000 USD, përkatësisht, në datat 17.7.2018, 9.1.2019, 8.1.2020 dhe 6.7.2021.

**72.** Komisioni ka kryer hetimet si vijojnë në lidhje me huan e marrë nga bashkëshortja e subjektit nga M. (SHBA):

**72.1** Nga verifikimi i DPV-ve rezultoi se:

- Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, subjekti ka deklaruar huamarrje për vazhdimin e studimeve universitare ndaj M.-s dhe detyrimin e pashlyer në shumën 37.037.68 USD.

- Në DPV-në e vitit 2014 deklaroi shumën e shlyer prej 8.437.68 USD dhe gjendjen e detyrimit në shumën 28.600 USD.

- Në DPV-në e vitit 2015 deklaroi shumën e shlyer prej 28.532.19USD dhe gjendjen e detyrimit 0 (zero).

- Në DPV-në e vitit 2018, subjekti ka deklaruar shlyerje të shumës 5.000 USD dhe detyrim të mbetur 15.000 USD.

- Në DPV-në e vitit 2019, subjekti ka deklaruar shlyerje të shumës 5.000 USD dhe detyrim të mbetur shumën 10.000 USD.

---

<sup>84</sup>Shih dokumentet bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, f. 327-331, në dosjen e Komisionit.

- Në DPV-në e vitit 2020, subjekti ka deklaruar shlyerje të shumës 5.000 USD dhe detyrim të mbetur shumën 5.000 USD.

**72.2.** Subjekti e ka deklaruar këtë detyrim edhe në pyetësonin standard duke vënë në dispozicion dy ekstrakte të lëvizjeve bankare në TD Bank, ku rezultojnë të jenë kryer dy transferta me nga 5.000 USD/secila, në llogari të shtetasës S.P., një në datën 17.7.2018 dhe një në datën 8.1.2020.

**72.3.** Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti ka deklaruar se detyrimi ndaj M. USA, është mbyllur që më 18.6.2015, si dhe paraqiti disa dokumente shkresore<sup>85</sup> nëpërmjet të cilave kishte rezultuar se shtetasja M. G. nuk ka asnjë detyrim ndaj M.-s.

**72.4** Meqenëse nga dokumentet e paraqitura nuk dilnin të qarta shumat dhe koha e marrjes së kësaj huaje studentore, subjektit iu kërkua informacion i mëtejshëm, si dhe kontrata e kredisë studentore. Në përgjigje të pyetësonit nr. 3, subjekti shpjegoi se *bashkëshortja e tij ka studiuar pranë P. University në vitet 2006 – 2008 dhe një pjesë e tarifës së universitetit është mbuluar nga shteti, një pjesë nga bursa dhe diferenca me kredi studentore. Kjo kredi nuk paguhet gjatë ndjekjes së studimeve por në fund të tyre, ajo nuk paguhet në universitet, por detyrimi transferohet dhe mblidhet nga një institucion i specializuar që në këtë rast është M. Për këtë arsye nuk ka kontratë kredie formale dhe një listëpagesë fikse ose variable, por detyrimi shlyhet vetëm në llogarinë e vënë në dispozicion nga ky institucion, në këtë rast M. dhe në mënyrën që zgjedh studenti. Gjithashtu, subjekti sqaron se bashkëshortja e tij M.G. ka kryer 2 pagesa që sollën mbylljen totale të detyrimit te M.*

Deklarimet e mësipërme të subjektit hedhin dritë mbi situatën e këtij detyrimi, si edhe mbi dokumentet e paraqitura më parë nga subjekti në pyetësonin nr. 2, nga analiza e të cilave ka rezultuar se deklaratimet e subjektit përputhen me provat e administruara. Shumat e paguara për shlyerjen e kredisë së marrë nga bashkëshortja e subjektit te M. janë përfshirë në analizën financiare të periudhës së qëndrimit në SHBA.

**73.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *“Kredi ndaj W. F. Bank, USA deri në datën 1.12.2016. Shuma 184,646 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë) USD. Shtëpi banimi, \*\*\* N. A., B., New York 10461, (SHBA), blerë më 21.5.02012. Shlyerja fillon më 21.5.2012 dhe përfundon më 21.5.2032. Interes fiks 4.250%, kësti mujor (përfshirë principal + interesa) 1,879.30 USD”.* Trajtuar në paragrafin 43.1.

**74.** Sa i takon shlyerjes së kësaj kredie, nga verifikimi i DPDFD/DPV-ve ka rezultuar se:

- Në DPDFD-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Kredi për blerje shtëpi banimi, sip. 160 m<sup>2</sup> (SHBA) në W. F. Bank, më 21.5.2012, në shumën 261.000.00 USD me afat 20 vjet. Shuma e detyrimit të mbetur 217.500 USD. Shlyerja fillon në datën 21.5.2012 dhe mbaron në datën 21.5.2032, me interes fiks 4.250 %/vit dhe me këst mujor 1.346.84 USD plus taksë sigurimi pasurie mbi pronën e paluajtshme 4.000 USD/vit”.*

- Në DPV-në e vitit 2015 në rubrikën *përshkrimi i detyrimeve* nuk deklaroi në lidhje me këtë kredi, por në rubrikën *përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit* deklaroi *shtëpi banimi, \*\*\**

---

<sup>85</sup>Account Home dhe Account Summary ku evidentohet gjendja e kredisë studentore te M. më 30.7.2014; shlyerja totale e detyrimit ndaj M.-s; konfirmim me e-mail dërguar shtetasës M. G. datë 13.6.2015, ku njofton që është kryer pagesa në favor të M.-s në shumën 20.000 USD nga shtetasja S. P. përmes Ch. Bank; konfirmim me e-mail, dërguar nga shtetasja M. G., datë 19.6.2015, për pagesën prej 8.532.19 SD, në favor të M.-s, nga shtetasja M. G. përmes TD Bank; gjendja e shtetasës M. G. në institucionin kreditor M., e cila nuk ka asnjë detyrim. Këto dokumente ndodhen bashkëlidhur pyetësonit nr. 2, f. 317-322, në dosjen e Komisionit.



*N. A., B., New York \*\*\* (SHBA), blerë në datën 21.2.2012. Burimi i krijimit kredi mbetur ndaj W. F. Bank deri në datën 31.12.2015, në vlerën 190.000 USD.*

- Në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar kredi ndaj W. F. Bank, SHBA. Gjendja e detyrimit 184.646 USD deri në datën 1.12.2016, si dhe ka përshkruar të dhënat e kredisë bankare.

- Në DPV-në e vitit 2017 ka deklaruar kredi ndaj W. F. Bank, SHBA dhe deri në datën 1.12.2017 janë shlyer interesat në shumën 7.623.42 USD dhe taksa të tjera në shumën 5.454.24 USD, gjendja e detyrimit në shumën 183.257.82 USD.

- Në DPV-në e vitit 2018 ka deklaruar kredi ndaj W. F. Bank, SHBA dhe deri në datën 1.12.2018 janë shlyer interesat në shumën 7.623.42 USD dhe taksa të tjera në shumën 5.454.24 USD.

**75.** Me qëllim vërtetimin e deklarimeve të subjektit dhe evidentimin e mundësisë së tij financiare për shlyerjen e kësteve me të ardhura të ligjshme, u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

**75.1** Subjektit iu kërkua *statement* bankar/vërtetim ku të evidentohen pagesat e kryera për shlyerjen e kredisë për çdo vit kalendarik, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka paraqitur dokumentin “llogaria rrjedhëse për pagesat e kredisë për shtëpi/*Mortgage Interest Statement*”, që tregojnë pagesën e kështit të kredisë për periudhën 2013 – 2020.

**75.2.** I pyetur për saktësimin e kësteve të paguara për kredinë, si dhe nëse shuma prej 4.000 USD, e paguar si shpenzim për kredinë, është pjesë e kështit të paguar të kredisë apo paguhet më vete, subjekti ka sqaruar se: “... sipas kontratës së kredisë me W. F. Bank, pagesa mujore mbi principalin dhe interesat është 1,346.84 USD. Rritja e kështit të kredisë ndër vite është rezultat i ndryshimit të politikave ekonomike që kanë të bëjnë me rritjen e taksës mbi pronën dhe atyre lokale. Për këtë shkak, në totalin e tyre, pagesat mujore (kësht kredie + taksat + sigurimet) kanë variuar nga 1.879 USD/muaj për vitin 2016 në 2.000 USD/muaj për vitin 2020. Shuma 4.000 USD së bashku me kështin e kredisë përbejnë shumën e cituar më lart, e ndarë në baza mujore dhe e shprehur bashkë me pagesën e kështit, si një pagesë mujore respektive”.

**75.3.** I pyetur në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për pagimin e kësteve të kësaj kredie, pas kthimit të tij në Shqipëri në korrik të vitit 2014, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: “... duke filluar nga data 1.8.2015 dhe në vijim, apartamenti i dytë të shtëpisë së ndodhur në adresën e mësipërme (\*\*\* N. A., B. NY \*\*\*), është i lëshuar me qira. Nga ky moment dhe në vijim, administrimi i pasurisë bëhet nga bashkëpronari, vëllai K.G. Te Banka Ch. është një llogari e përbashkët e imja e vëllait vetëm për funksion pagesave të kredisë. Qiraja merret cash dhe i depoziton K. në bankë të llogaria e përbashkët për të paguar kështet e kredisë. W.F. e tërheq me urdhër automatik nga Ch. Bank. Vëllai administron të gjithë fluksin e parasë së qirasë dhe kredisë, pasi ai është atje dhe e administron. Vëllai paguan 1.000 USD e vet (50% e kështit) dhe depoziton dhe 1.000 USD (nga 1.800 USD që merr qiranë sot). Diferencën ose e marr cash kur unë ose bashkëshortja shkojmë atje, ose i hedh te llogaria e përbashkët e më pas e bëjmë transfertë në llogarinë time personale”. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur tri kontrata qiraje, të cilat fillojnë nga data 1.8.2015 deri sot, në vlerë qiraje mujore 1.700 USD.

Bazuar në të gjitha dokumentet e administruara, u vërtetua se deklarimet e subjektit në lidhje me shlyerjen e kredisë janë të sakta. Shpenzimet për shlyerjen e kredisë janë përfshirë në analizën financiare të kryer, si për periudhën e qëndrimit në SHBA ashtu edhe në Shqipëri.

## Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur

**76.** Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit M. P. G. ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj. Shtetasja M. G. ka plotësuar deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014 dhe në DPV-të e viteve 2014 – 2018.

**77.** Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën *përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit*, znj. M. G. ka deklaruar: “*Depozitë TD Bank (New York, SHBA), krijuar në nëntor të vitit 2013; gjendje në datën 31.12.2016. Vlera: 263.51 USD (dyqind e gjashtëdhjetë e tre/51). Pjesa 50 %.*”. Kjo është llogari e përbashkët me subjektin dhe është trajtuar në pikën 68 të vendimit.

**78.** Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën *përshkrimi i të ardhurave* znj. M. G. ka deklaruar: “*Z.Ch., \*\*\* S. O. A., S. \*\*\*, O. Florida, \*\*\*. Vlera: 12.736.66 (dymbëdhjetë mijë, shtatëqind tridhjetë e gjashtë/66) USD*”. ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e bashkëshortes për vitin 2014 në SHBA, për shumën e deklaruar 12.736 USD.

**78.1** I pyetur nga Komisioni për të dokumentuar këtë të ardhur në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka punuar për shoqërinë Z. Ch., Inc, me kohë të pjesshme dhe se pagesat javore për punën e kryer janë bërë në llogarinë në TD Bank New York. Subjekti ka deklaruar se nuk mund të provojë kalimin e pagave me lëvizje të llogarisë bankare, pasi kanë kaluar 7 vjet dhe është në pamundësi të marrjes së informacionit bankar. Për të mbështetur deklaratimet e tij, subjekti ka paraqitur një e-mail nga TD Bank dhe ekstrakt nga “Termat dhe kushtet e TD Bank”, ku evidentohet afati ligjor i marrjes së informacionit<sup>86</sup>.

**78.2** Ndërkohë, që në pyetësorin standard, subjekti kishte bashkëngjitur edhe dokumentin që vërteton lëvizje bankare të llogarisë së shtetasve M. dhe Kastriot Gramshi, nga data 14.6.2014 deri në 13.7.2014, nga ku evidentohen 4 kreditime javore nga shoqëria “Z. Ch.”, brenda kësaj periudhe. Pavarësisht se shuma totale e kreditimeve prej 1.344.37 USD përbën vetëm pagën e një muaji, duket se bashkëshortja e subjektit ka marrë pagë nga kjo shoqëri gjatë vitit 2014. Megjithatë të ardhurat e bashkëshortes janë pjesë e deklaratës së të ardhurave vjetore në New York për vitin 2014, të cilat janë në total në shumën 40.142 USD, vlerësohet se deklaratimet e subjektit mbi këto të ardhura janë të sakta. Sidoqoftë, të ardhurat familjare të subjektit janë bazuar në deklaratën e të ardhurave vjetore, ku përfshihen të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij.

**79.** Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën *përshkrimi i detyrimeve* znj. M.G. ka deklaruar: “*Huamarrje nga M. (U.S.A) për vazhdimin e studimeve të larta (Tution) pranë P. University në shumën 37.037.68 USD*” (trajtuar hollësisht në 71-72 të vendimit).

## Në lidhje me të ardhurat

**80.** Në rubrikën të ardhura të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiratë e banesës në SHBA. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar të ardhura nga qiratë që nga data 1.8.2015 e në vijim, në vlerën mujore 1.700 USD<sup>87</sup>, si dhe ka paraqitur tri kontrata

<sup>86</sup>Dokumentet e paraqitura me pyetësorin nr. 3, f. 67-70, në nenin 4(x) është e shprehur qartë se koha e lejuar për të pasur akses mbi informacionin nga kjo bankë, është 84 muaj (7 vjet).

<sup>87</sup>Vlera e qirasë ka qenë 1.700 USD/muaj për periudhën 1.8.2015 – 20.7.2020 dhe pas kësaj date është bërë 1.800 USD/muaj, dokumente të paraqitura në faqen 271-281, të pyetësorit nr. 2.

qiraje. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit, rezultoi se:

- Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën të ardhura, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e apartamentit kati 2 (\*\*\*) N. A., B., New York, \*\*\*), pas shlyerjes së pagesës mujore (mortgage) për periudhën gusht 2015 – 31.8.2016, shuma 9.800 USD.

- Në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 1.800 USD.
- Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 9.800 USD.
- Në DPV-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 8.500 USD.
- Në DPV-në e vitit 2018 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 8.500 USD.
- Në DPV-në e vitit 2019 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 8.900 USD.
- Në DPV-në e vitit 2020 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 9.500 USD.

**81.** Duke qenë se këto të ardhura nga qiraja në SHBA, janë deklaruar si burim për kryerjen e disa shpenzimeve, si dhe shlyerjen e detyrimeve financiare të subjektit, me qëllim vërtetimin e tyre si të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nga Komisioni u ndërmorën disa veprime hetimore. Konkretisht:

**81.1** U pyet subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se në deklaratimet vjetore të të ardhurave (ekuivalente me DIVA-n), ai ka deklaruar si të ardhura familjare vlerën e mbetur nga qiratë pas pagesës së kështit të kredisë në bankë, duke u shprehur se<sup>88</sup>: “... edhe pas transferimit nga New York në Tiranë, gjatë periudhës së bërjes së taksave (15 janar – 15 prill), si shtetas amerikan që jeton jashtë SHBA-së, deklaroj të ardhurat familjare për efekt taksash. Si të ardhura familjare deklarohen paga ime, paga e bashkëshortes dhe të ardhurat neto nga qiraja e apartamentit. Theksoj se e ardhura neto përfaqëson diferencën e qirasë mujore (1.700 USD – sot 1,800 USD) pas pagesës së pjesës takuese prej 50% të kështit mujor/kredi hipotekore (variuar nga 950 USD – 1.000 USD). E thënë ndryshe, të ardhurat neto nga qiraja e deklaruar çdo vit është në shumën (700 USD – 800 USD X 12 muaj). Pra, këto janë të ardhurat familjare të deklaruara çdo vit në momentit e deklarimit të taksave pranë Internal Revenue Service (IRS). Të ardhurat familjare si më lart cituar, në të njëjtën mënyrë dhe format, janë deklaruar dhe pasqyruar në deklaratat e interesave private periodike/vjetore”. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur formularët e deklarimeve mbi të ardhurat në SHBA, për vitet 2015 dhe 2016, periudhë kur të ardhurat e tij në SHBA përbëhen nga qiraja e banesës në New York.

**81.2.** Pasi i është kërkuar të qartësojë se çfarë përfaqëson çdo zë në këto formulare, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar njësoj si në pyetësorin nr. 2, duke i paraqitur këto deklarata të përkthyer në gjuhën shqipe. Sa i takon pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga qiratë, subjekti ka sqaruar: “... duke qenë shtetas amerikan ai vazhdon të kryejë deklarin të të ardhurave të tij në SHBA, edhe pse është rezident në Shqipëri. Këto të ardhura, në bazë të legjislacionit mbi taksat (the Internal Revenue Code)<sup>89</sup> për shkak të shumës së përfituar nga qiratë janë të përjashtuara nga taksat. Kështu, të ardhurat familjare të deklaruara periodikisht pranë Internal Revenue Service (IRS) janë dukshëm larg kufirit minimal të parashikuar nga ky legjislacion dhe, për këtë arsye, shteti amerikan i ka rimbursuar subjektit taksa në vitet 2015 dhe 2016 ...”<sup>90</sup>. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur tre *statement* bankare në të cilat pasqyrohen kthimet e taksave (*tax return*) në vitet 2015 dhe 2016.

<sup>88</sup>Shih pyetësorin nr. 2, përgjigjia e pyetjes 6/h.

<sup>89</sup>Në bazë të rregullave të sanksionuara në legjislacionin e sipërcituar, taksapaguesi amerikan që është rezident në një vend tjetër dhe që gjatë një viti realizon të ardhura më pak se shuma e përjashtuar nga taksimi sipas ligjit, (p.sh. në vitin 2019 kjo shumë ka qenë 105.900 USD), plotëson formën \*\*\*, [www.irs.gov/Form2555](http://www.irs.gov/Form2555).

<sup>90</sup>Subjekti ka sqaruar mënyrën e funksionimit të sistemit të tatim-taksave në SHBA duke vënë në dukje se pas përfundimit të sezonit të taksave, të dhënat e hedhura në sistem verifikohen nga IRS-ja dhe sipas rastit bëhen korrektimet përkatëse, në bazë të faktit nëse tatimpaguesi ka paguar më pak ose më shumë taksa gjatë periudhës

**81.3.** Në vijim është pyetur për vitet 2017 – 2020<sup>91</sup> dhe subjekti ka paraqitur deklaratimet tatimore për këto vite, si dhe “deklaratat përmbledhëse të taksave federale” për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

**82.** Nga analiza e dokumenteve të paraqitura nga subjekti, nga sqarimet e tij, si dhe nga verifikimet e kryera në adresat *website* të referuara nga subjekti mbi legjislacionin amerikan për taksat, në lidhje me të ardhurat nga qiraja pas datës 1.8.2015, kur pasuria është dhënë me qira, ka rezultuar se: (i) për vitin 2015 ka paraqitur deklaratën tatimore të IRS-së<sup>92</sup>; (ii) për vitet 2016 – 2018, subjekti ka paraqitur deklaratë përmbledhëse të taksave federale<sup>93</sup>.

**83.** Në tabelën vijuese janë treguar në mënyrë të përmbledhur të ardhurat e deklaruara në SHBA, të cilat përbehen nga: (i) të ardhurat e gjeneruara në Shqipëri, që nuk taten<sup>94</sup>; dhe (ii) të ardhura nga qiraja që janë të shprehura *neto*, pra, pasi nga ato janë zbritur pagesat e kësteve të kredisë në bankë, sikurse ka shpjeguar subjekti gjatë hetimit administrativ<sup>95</sup>.

| Vitet                      | 2016   | 2017   | 2018   |
|----------------------------|--------|--------|--------|
| Të ardhurat në total (USD) | 11.761 | 15.910 | 22.369 |
| Nga të cilat nga qiraja    | 8.400  | 8.445  | 8.177  |

**84.** Në lidhje me të ardhurat nga qiraja e banesës në SHBA, nga përfaqësuesi i ONM-së është depozituar një opinion i vënë në dispozicion me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2022, i cili rekomandon Komisionin në lidhje me: (i) të ardhurat që vijnë nga qiraja e përfituar në SHBA; (ii) cilin nga dokumentet duhet të konsiderohet si deklaratë provuese e kryer pranë IRS-së<sup>96</sup>. Më konkretisht, më poshtë janë paraqitur disa fakte dhe konkluzione të arritura nga vëzhguesi ndërkombëtar, të ndara sipas viteve:

- Për vitin 2015: në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar në ILDKPKI të ardhurat nga qiraja në SHBA, në shumën 1.800 USD dhe në mbështetje të këtij deklarimi ka dorëzuar dokumentin “të ardhurat individuale në SHBA për vitin 2015” (*tax return*), ku evidentohet se rreshti i 17-të i kësaj deklarate është bosh, gjë që tregon se subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga qiraja pranë IRS-së.

- Për vitin 2016: në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar në ILDKPKI të ardhurat nga qiraja në SHBA në shumën 9.800 USD dhe në mbështetje të këtij deklarimi ka dorëzuar dokumentin “të ardhurat individuale në SHBA për vitin 2016” (*tax return*), ku evidentohet se rreshti i 17-të është bosh, gjë që tregon se subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga qiraja pranë IRS-së. Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka paraqitur një dokument të ri

---

tatimore në shqyrtim. Në rast të pagimit të një shume më të madhe sesa ajo takuese, bëhet rimbursimi apo kthimi i shumës së paguar më tepër, ndryshe e njohur si *tax refund*. Përveç kësaj arsyeje shteti krediton edhe përfitime të tjera si, deri në 2.000 USD për çdo fëmijë minore që mbahet nga familja (*The Child Tax Credit*); taksapaguesit që kanë të ardhura të moderuara kualifikohen për pagim të moderuar të taksave dhe përfitojnë rimbursim (*Earned Income Tax Credit - EITC or EIC*); trajtim i diferencuar për shpenzimet e kryera për qëllime ndjekjeje të studimeve të larta (*American Opportunity Tax Credit*).

<sup>91</sup>Shih pyetjen 6 të pyetësorit nr. 5.

<sup>92</sup>Shih dokumentet bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, f. 245.

<sup>93</sup>Në përgjigje të pyetjes 6, të pyetësorit nr. 5.

<sup>94</sup>Në deklaratat përmbledhëse të taksave federale/*Federal Income Tax Summary* tregohet qartësisht skontimi (shprehja me minus) e të ardhurave të gjeneruara në Shqipëri, duke treguar se ato nuk taten në SHBA.

<sup>95</sup>Shih përgjigjen e pyetjes nr.6/e të pyetësorit nr. 2.

<sup>96</sup>International Revenue Services ka funksionin e zyrës së tatim-taksave, e cila mbledh dhe monitoron deklaratimet e të ardhurave personale të çdo shtetasi dhe rezidenti në SHBA.

“përmbledhje e të ardhurave federale”, ku evidentohet se të ardhurat nga qiraja, honoraret, pjesëmarrjet në shoqëri, truste për vitin 2016, janë në vlerën 8.400 USD.

- Ndodhur në këto rrethana të reja dhe duke pasur dy dokumente, që japin informacion kontradiktor në lidhje me të ardhurat nga qiraja për vitin 2016, vëzhguesi ndërkombëtar mendon se dokumenti i parë i paraqitur nga subjekti “të ardhurat individuale në SHBA për vitin 2016” (*tax return*), është dokumenti i saktë dhe zyrtar i dorëzuar pranë IRS-së, ndërkohë që dokumenti i dytë nuk duket të jetë një dokument ligjor, i deklaruar pranë IRS-së dhe i lëshuar prej saj. Nën këtë këndvështrim, vëzhguesi ndërkombëtar rekomandon Komisionin, që të mos i përfshijë në analizën financiare të ardhurat nga qiraja për vitet 2015 dhe 2016, derisa ato nuk janë provuar që janë deklaruar pranë IRS-së. Subjekti duhet të paraqesë seksionin E të formës 1040 (për vitin 2016), për të provuar që të ardhurat nga qiraja janë deklaruar pranë IRS-së. Subjekti ka paraqitur “të ardhurat individuale në SHBA” (*tax return*) për vitet 2017 dhe 2018, ku evidentohet se ai ka deklaruar në mënyrë korrekte të ardhurat nga qiraja, pranë IRS-së.

- Për vitin 2019: subjekti ka paraqitur “të ardhurat individuale në SHBA” (*tax return*) për vitin 2019, ku evidentohet se ai ka deklaruar të ardhurat nga qiraja, pranë IRS-së. Sidoqoftë, nuk mund të arrihet në një konkluzion final, pa parë seksionin 1 të formës 1040 (për vitin 2019). IMO rekomandon që Komisioni të kërkojë dokumentin e mësipërm për vitin 2019.

- Për vitin 2020: subjekti ka paraqitur “të ardhurat individuale në SHBA” (*tax return*) për vitin 2020, ku evidentohet se ai ka deklaruar të ardhurat nga qiraja, pranë IRS-së. Sidoqoftë, nuk mund të arrihet në një konkluzion final, pa parë seksionin 1 të formës 1040 (për vitin 2020). IMO rekomandon që Komisioni të kërkojë dokumentin e mësipërm për vitin 2020.

**85.** Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e paraqitura me sipër, si dhe referuar opinionit të ONM-së, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit duket se: (i) nuk është provuar me dokumentacion deklarimi i të ardhurave nga qiraja në SHBA në deklaratat tatimore pranë IRS-së për vitet 2015 dhe 2016 dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme; (ii) mbetet e paqartë nëse subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja pranë IRS-së, për vitet 2019 dhe 2020, pasi dokumentacioni provues për këto vite nuk është i plotë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**86.** Në parashtrimet e datës 10.2.2022, subjekti ka pretenduar se të ardhurat nga qiratë në SHBA janë të ligjshme, bazuar në argumentet dhe dokumentet si në vijim:

- Sipas subjektit, deklaratat tatimore ndër vite<sup>97</sup>, pra, edhe gjatë viteve 2015 dhe 2016, janë plotësuar nga një kontabiliste e miratuar. Subjekti sqaron se ligji ngarkon me përgjegjësi kontabilisten për deklarimin e saktë dhe se, konkretisht, në deklaratën e vitit 2016, në formën \*\*\*“*IRS e-file Signature Authorization*”, përcaktohet se kontabilisti është përgjegjës për plotësimin e deklaratës tatimore sipas të dhënave identike të vendosura në dispozicion dhe të dërguara nga tatimpaguesi<sup>98</sup>.

<sup>97</sup>Shih deklaratën e znj. S. B., E. A., datë 1.2.2022, nëpërmjet së cilës deklaroi se është kontabilistja e z. Kastriot Gramshi për 8 vitet e fundit, pra nga viti 2013 (f. 225).

<sup>98</sup>Shih deklaratën “*New York State e-File Signature Authorization for Tax Year 2016*” për format \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, and \*\*\*”, ku kontabilisti deklaroi: “*Duke qenë i vetëdijshëm për përgjegjësinë ligjore, deklaroj se informacioni i përfshirë në këtë deklaratë elektronike të tatimit mbi të ardhurat personale të shtetit të New Yorkut 2016 është informacioni i dhënë nga tatimpaguesi. Nëse tatimpaguesi përmes një personi të tretë më ka vendosur në dispozicion të dhënat tatimore për vitin 2016 për shtetin e New Yorkut në formë të shkruar dhe firmosur nga personi i tretë, deklaroj se informacioni që përmban deklaratat elektronike e shtetit të New Yorkut të vitit 2016 të tatimpaguesit është identik me atë që përmbahet në kopje letre të deklaratës. Nëse jam përgatitësi me pagesë, nën përgjegjësinë ligjore të një deklarimi të rremë, deklaroj se kam plotësuar këtë deklaratë elektronike të tatimit mbi*

- Në periudhën e qëndrimit në Shqipëri, ai ka paraqitur komunikimet me *e-mail* me kontabilisten, të noterizuara, ku evidentohet qartë se subjekti e ka autorizuar kontabilisten të deklarojë të ardhurat e përfituara në Shqipëri, si dhe ato *neto* në SHBA, pas pagesës së kredisë së shtëpisë. *E-mail*-et janë dërguar brenda muajit mars të çdo viti për të informuar të ardhurat e vitit paraardhës.

- Pas marrjes së opinionit nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti ka komunikuar me kontabilisten, e cila ka evidentuar se nuk i ka deklaruar të ardhurat nga qiratë kur subjekti jetonte në Shqipëri. Kontabilistja ka bërë amendimet e duhura, nga të cilat nuk ka lindur asnjë detyrim për t'u paguar ndaj shtetit.

- Në funksion të argumenteve të tij, subjekti ka theksuar se: (i) paplotësia e deklaratave, qartësisht, ka ardhur për shkak se të ardhurat e tij kanë qenë në fashën e të ardhurave të pataksueshme; (ii) kjo e ardhur rrjedh nga kontratat e qirasë duke plotësuar një nga kushtet kumulative të njohjes dhe konsiderimit të të ardhurave të ligjshme; (iii) edhe pas amendimeve të kryera për deklaratimet e viteve kur subjekti është në Shqipëri, nuk ka lindje të detyrimit tatimor, pasi të ardhurat nga qiraja janë nën kufirin minimal, për të cilin paguhen detyrimet tatimore.

- Për këto arsye, në interpretim të pikave 3, 4 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës<sup>99</sup>, subjekti kërkon që Komisioni të njohë si të ardhura të ligjshme, të ardhurat e realizuara nga qiraja në vitin 2015 në shumën 1.800 USD, sikurse është deklaruar në DPV-në e vitit 2015, si dhe ato të vitit 2016 në vlerën *neto* 8.400 USD.

**87.** Për një hetimi shterues për krijimin e bindjes në lidhje me vërtetësinë e *e-mail*-eve të paraqitura bashkëlidhur parashtrimeve, pas riçeljes së hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion *e-mail*-et në *PDF format* ose me *print screen*. Në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti i paraqiti *e-mail*-et në formën e kërkuar nga Komisioni ku dalloheshin qartësisht formati i *e-mail*-eve të subjektit, dërguesi dhe marrësi, data, si dhe çdo detaj tjetër.

**88.** Në analizë të çdo pretendimi dhe dokumenti të paraqitur nga subjekti, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi të bazuara dhe të argumentuara bindshëm pretendimet e subjektit pasi: (i) subjekti ka vërtetuar se ka autorizuar në rrugë elektronike dhe në mënyrë korrekte kontabilisten e tij në SHBA për të deklaruar të ardhurat e tij vjetore si nga qiraja në SHBA ashtu edhe të ardhurat si gjyqtar në Shqipëri; (ii) saktësia e këtyre deklaratimeve pranë IRS-së, është përgjegjësi ligjore e kontabilistit të miratuar dhe subjekti nuk mund të penalizohet për pasaktësi të kontabilistit të emëruar prej tij; (iii) u provua që këto të ardhura nuk taksohen nga shteti amerikan dhe në këto rrethana, mungesa e deklaratimeve nga ana e kontabilistes si dhe, mungesa e një supervizimi nga ana e subjektit të veprimtarisë së kontabilistes për deklaratimet pranë IRS-së, përveç se nuk ka qenë i qëllimshëm, nuk ka sjellë asnjë pasojë. Për rrjedhojë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, të ardhurat nga qiratë në SHBA për vitet 2015 dhe 2016, u konsideruan të ligjshme, duke afektuar kështu analizën përfundimtare financiare për këto vite.

---

*të ardhurat personale të shtetit të New Yorkut të vitit 2016 dhe, sipas njohurive dhe besimit tim, deklarata është e vërtetë, e saktë dhe e plotë. Ky deklaram është i bazuar në të gjithë informacionin e vendosur në dispozicion”.*

<sup>99</sup>Në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, e ardhur e ligjshme do të jetë ajo e ardhur për të cilën provohet se është paguar detyrimi tatimor ose ato të ardhura për të cilat pagimi i tatimit është përjashtuar me ligj.

## Në lidhje me ushtrimin e një aktiviteti privat

**89.** ILDKPKI-ja, ne raportin e saj, ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave private dhe as në deklaratën e rivlerësimit, pjesën zotëruese në kapitalin e shoqërive “A. M.” sh.p.k. dhe “A. P.” sh.p.k. Sipas tatimeve, këto shoqëri rezultojnë me status pasiv, respektivisht, që nga vitet 2011 dhe 2014. Nuk ka informacion lidhur me rezultatin financiar nga veprimtaria e këtyre shoqërive.

**90.** Gjatë hetimit administrativ u kryen verifikime në lidhje me këto dy shoqëri tregtare për të evidentuar aktivitetin e tyre dhe pjesëmarrjen e subjektit në kapitalin e tyre. Me kërkesë të Komisionit, QKB-ja<sup>100</sup> ka konfirmuar se shtetasi Kastriot Gj. Gramshi i datëlindjes 27.5.1975 figuron: (i) ortak zotërues 25 % i kuotave në shoqërinë “A. M.” sh.p.k. me NIPT \*\*\* me status aktiv; si dhe (ii) ortak zotërues 50 % të kuotave në shoqërinë “A. P.” sh.p.k. me NIPT \*\*\*. Lidhur me këto dy shoqëri, u konstatua se:

**90.1.** Sa i takon shoqërisë “A. M.” sh.p.k., sipas ekstraktit dhe aktit të themelimit të kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me NIPT \*\*\*, me seli në Shkodër, si ortakë të saj figurojnë katër shtetas që zotërojnë secili 25 % të kuotave, përkatësisht: subjekti, shtetasi M. H. M.<sup>101</sup> (shtetas amerikan); shtetasja M. M. (lindur në Durrës, shtetase amerikane); shtetasi M. K. (shtetas shqiptar, banues në Shkodër). Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie: “Trajnimi, specializimi i mjekëve, infermierëve, etj.”. Me kërkesë të Komisionit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër<sup>102</sup> informoi se shoqëria rezulton me status pasiv që prej datës 25.2.2011, duke pasqyruar për vitin 2008 fitim/humbje -132,763 dhe për vitin 2009 fitim/humbje 0 (zero) lekë.

**90.2.** Sa i takon shoqërisë “A. P.” sh.p.k., sipas ekstraktit dhe aktit të themelimit të shoqërisë “A. P.” sh.p.k. me NIPT \*\*\*, me seli në Durrës, rezulton se në këtë shoqëri janë 2 ortakë që zotërojnë secili 50% të kuotave, përkatësisht, subjekti dhe shtetasja M. M. (lindur në Durrës, shtetase shqiptare-amerikane). Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie: “prodhim, importim, shitblerje me shumicë dhe pakicë të medikamenteve farmaceutike - mjekësore, etj.” Me kërkesë të Komisionit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës informon se<sup>103</sup>: (i) shoqëria rezulton me status pasiv që prej datës 17.10.2014; (ii) nuk ka deklaruar të ardhura, fitim *neto* dhe humbje; (iii) nuk rezultojnë listëpagesa të deklaruara *online* për periudhën nga data 1. 1.2012; (iv) për periudhën janar 2009 - dhjetor 2011 subjekti ka deklaruar deklaratën e kontributeve shoqërore, të cilat nuk gjenden në DRT-në Durrës, por në arkivin e ISSH-së, nëse janë protokolluar fizikisht nga tatimpaguesi.

**91.** Nga Komisioni u kryen hetime në lidhje me një konflikt të mundshëm të interesit të subjektit me ortakët e shoqërisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti ka ushtruar detyrën, ka konfirmuar<sup>104</sup> se nuk rezultojnë të jetë regjistruar çështje gjyqësore civile apo të jetë dhënë vendim civil nga subjekti i rivlerësimit, në emër të shtetasve M. H. M., M. M. dhe M. K. Po kështu, kjo gjykatë ka konfirmuar se nuk rezulton të jetë regjistruar çështje gjyqësore

<sup>100</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, të QKB-së, bashkëngjitur dhe ekstraktet në dosjen e Komisionit. Akt themelimi nga regjistri elektronik i QKB-së.

<sup>101</sup>Subjekti, në deklaratën para fillimit të detyrës, ka deklaruar të ardhura si pedagog në ASA College New York për periudhën 2.2009 – 7.2014. Sipas informacionit në internet rezultojnë personat M. M. dhe Gramshi Kastriot instructor, në College Catalog të ASA (Shih: <https://www.asa.edu/wp-content/uploads/2018/09/ASA-College-Catalog-NY-Vol23-with-addendums.pdf>).

<sup>102</sup>Shih: anekset \*\*\* dhe \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, të DRT-së Shkodër, në dosjen e Komisionit.

<sup>103</sup>Shih: anekset \*\*\* dhe \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr.\*\*\* prot., datë 4.10.2021, të DRT-së Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>104</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

civile apo të jetë dhënë vendim civil në emër të shoqërive “A. M.” sh.p.k. dhe “A. P.” sh.p.k., nga subjekti i rivlerësimit<sup>105</sup>. Me kërkesë të Komisionit, SPAK-u<sup>106</sup> nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të shtetasve të sipërpërmendur.

**92.** Duke qenë se subjekti ka qenë pjesëtar në kapitalin e shoqërive “A. M.” sh.p.k. dhe “A. P.” sh.p.k., përkatësisht në masën 25% dhe 50% u kërkuan arsyet e mosdeklarimit të kuotave në DPFD-në e vitit 2014, në DPV, si dhe në deklaratën *Vetting*, si dhe i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me zotërimin e kuotave në këto shoqëri tregtare në raport me statusin e tij si magjistrat. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se në dijeninë e tij, gjatë viteve të deklarimit, këto shoqëri kanë qenë me status pasiv dhe, për këtë arsye, kuotat e tij nuk janë deklaruar. Ndërsa në lidhje me zotërimin e kuotave në këto shoqëri tregtare në raport me statusin e tij si magjistrat, ka deklaruar se:

i) Në shoqërinë ‘A. M.’ sh.p.k., Shkodër, është ortak duke zotëruar 25% të kuotave të kapitalit. Administrator i shoqërisë ka qenë shtetasi M. H. M. Kjo shoqëri nuk ka ushtruar ndonjëherë aktivitet dhe ka qenë me statusin pasiv që nga viti 2011. Nga momenti i themelimit, kjo shoqëri nuk ka gjeneruar ndonjëherë të ardhura dhe aq më tepër të përfitojë të ardhura nga fondet publike. Gjithashtu, ka deklaruar se: *“Nga informacioni i gjendur dhe administruar nga QKB-ja, po ashtu edhe nga konfirmimi nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër konfirmohet që unë nga momenti i emërimit në detyrën e gjyqtarit nuk kam firmosur ndonjëherë ndonjë dokument apo vendim në cilësinë e ortakut”*. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, ku vërtetohet se tatimpaguesi “A. M.” sh.p.k. është me status pasiv, duke filluar nga data 25.2.2011.

ii) Në lidhje me shoqërinë “A. P.” sh.p.k. me NIPT subjekti ka deklaruar se paraqitet e njëjta situatë, duke specifikuar: *“... në këtë shoqëri unë rezultoj ortak duke zotëruar 50% të kuotave të kapitalit. Nga momenti i themelimit dhe deri më sot shoqëria nuk ka realizuar ndonjëherë të ardhura nga aktiviteti. Adresa e shoqërisë ka qenë ‘Durrës Lagjja \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, pallati \*\*\*, kati i \*\*\*’ dhe administrator i shoqërisë ka qenë shtetasja M. M. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, për të ardhurat e shoqërisë “A. P.” sh.p.k., ku rezulton se kjo shoqëri ka status pasiv që në datën 17.10.2014 (subjekti ka filluar detyrën në datën 10.7.2014, gjithashtu bëhet me dije se detyrimi i kësaj shoqërie në datën 22.7.2021 është në shumën 396.799 lekë.*

**93.** Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit i janë kërkuar shpjegime të mëtejshme në lidhje me faktin se pavarësisht se shoqëria “A. M.” sh.p.k. ka qenë me status pasiv që në vitin 2011 kur subjekti nuk ka qenë në detyrë, ndërsa shoqëria “A. P.” sh.p.k. është bërë me status pasiv tre muaj, pasi subjekti ka filluar detyrën, subjekti ka qenë dhe është ortak në të dyja shoqëritë dhe ka pasur pjesën e tij takuese në kapitalin e tyre, kuotat e të cilave nuk i ka deklaruar në DPV dhe as në deklaratën *Vetting*. Gjithashtu, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje konstatimin dhe duket se ka vepruar në tejkalim të parashikimit të nenit 143 të Kushtetutës, sipas të cilit “qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private”, si dhe ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 22 i të cilit përcakton se: *“Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike”*.

<sup>105</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

<sup>106</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, në dosjen e Komisionit.



**94.** Në parashtrimet e datës 10.2.2022, subjekti ka deklaruar se: *“Së pari, mosdeklarimi nga ana ime ka qenë pakujdesi dhe i paqëllimshëm dhe se në rastin konkret nga ky mosveprim/mosdeklarim nuk ka ardhur asnjë pasojë. Së dyti, rezulton nga aktet e administruara gjatë hetimit të thelluar se këto shoqëri tregtare janë krijuar shumë kohë para fillimit të ushtrimit të detyrës sime si gjyqtar dhe, për më tepër, ato kanë kaluar në status pasiv. Së treti, në këto rrethana, dhe duke qenë se shoqëritë janë me status pasiv dhe si të tilla nuk gjenerojnë të ardhura, nuk mund të flitet për fitime nga ‘aksionet’ dhe, për rrjedhojë, as për konflikt interesi”.*

Siç vërehet, subjekti mban të njëjtin qëndrim, si dhe gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se shoqëritë janë me status pasiv dhe, si të tilla, nuk gjenerojnë të ardhura dhe nuk mund të flitet për fitime nga “aksionet”. Gjithashtu, pretendon se ai dhe ortakët e shoqërisë nuk kanë qenë në Shqipëri dhe se ai nuk ka nënshkruar asnjë dokument të shoqërisë. Për këto fakte, ka harruar tërësisht ekzistencën e këtyre dy shoqërive në momentin e plotësimit të deklaratës para fillimit të detyrës ashtu edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*. Gjithashtu, deklaroi se është në pamundësi objektive për të hequr dorë apo transferuar kuotat për shkak të mungesës së ortakëve të saj. Për rrjedhojë, sipas tij, nuk ka konflikt interesi dhe as ushtrim të aktivitetit në kundërshtim me detyrën dhe me ligjin.

**95.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se mosdeklarimi i kuotave të të dyja shoqërive nuk ka ndonjë peshë specifike të tillë që të penalizojë subjektin e rivlerësimit, referuar statusit pasiv të tyre dhe faktit të vërtetuar se të dyja shoqëritë nuk kanë gjeneruar të ardhura, si dhe vlerësoi të arsyeshëm pretendimin e subjektit se është në pamundësi objektive për të hequr dorë apo transferuar kuotat për shkak të mosprezencës së ortakëve të tyre në Shqipëri. Po kështu, bazuar në të gjitha sa më sipër është analizuar dhe arsyetuar, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin se subjekti ka vepruar në kundërshtim me nenin 134 të Kushtetutës apo me ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për shkak se nuk u vërtetua që shoqëritë tregtare të kenë ushtruar aktivitet gjatë periudhës kur subjekti ka qenë në detyrën e gjyqtarit.

Është e vërtetë se sipas pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, magjistratit i ndalohet: *“(ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar”.* Por, duke qenë se të dyja shoqëritë nuk u vërtetua të kenë ushtruar aktivitet për shkak të statusit “pezulluar”, nga ana e Komisionit u vlerësua se mundësia për të ndikuar në veprimtarinë e subjektit si magjistrat apo për të krijuar një konflikt interesi është e vogël, për më tepër që gjatë hetimit administrativ Komisioni ka kryer hetime në lidhje me një konflikt interesi të subjektit me të dyja shoqëritë dhe ortakët e saj dhe, në përfundim, nuk kanë rezultuar të dhëna. Gjithsesi, subjekti duhet të marrë masa që të mundësojë largimin e tij nga të dyja shoqëritë tregtare.

### **Konstatime të tjera**

**96.** Në DFPF-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar adresën: *“Rruga ‘\*\*\*’, nr. \*\*\*, Tiranë”.*

I pyetur se çfarë përfaqëson kjo adresë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se me dekretin nr. \*\*\*, datë 10.7.2014, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 9049/2003, brenda afatit njëmuor është bërë dorëzimi i deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës. Në kushtet e mungesës së adresës së banimit permanente (në pronësi apo posedim) është dhënë/shënuar adresa e sipërcituar për efekt

komunikimi, e cila ka qenë adresa e një shoku të tij. Referuar faktit se nuk ka pasur asnjë të dhënë apo dyshime për lidhje të subjektit me pasuri të paluajtshme në këtë adresë, si dhe faktit se që nga data 1.10.2014, subjekti ka deklaruar banimin me qira në adresën e trajtuar në paragrafin 93 në vijim, Komisioni vlerësoi bindëse deklaratimet e subjektit.

**97.** Në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-të e viteve 2014 – 2016 në seksionin nëse disponohet vendqëndrim tjetër, subjekti ka deklaruar dhe adresën: rruga “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*\*, Tiranë. Në lidhje me këtë adresë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, deklaroi se ka banuar në periudhën 1.10.2014 – 31.9.2017. Subjekti ka depozituar kontratë qiraje (jonoteriale) datë 1.10.2014, të lidhur midis qiradhënëses S. B. dhe qiramarrësit subjekti i rivlerësimit, me afat 1-vjeçar për periudhën 1.10.2014 - 30.9.2015 me të drejtë rinovimi, për apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup> për banim, në shumën 35.000 lekë/muaj, ku përfshihen edhe shpenzimet për mirëmbajtje, energji elektrike dhe furnizim me ujë. Këto shpenzime u përfshinë si të tilla në analizën financiare. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka paraqitur një akt shkresor “njoftim për zgjidhje kontrate” datë 1.9.2017, të lëshuar nga qiradhënësjja S. B.

Në drejtim të konfliktit të interesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk ka konfirmuar<sup>107</sup> gjykime nga ana e tij të çështjeve civile me palë S. B.

**98.** Në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar pagesë në shumën 3.850 USD *mbi transportimin me kargo të sendeve personale të familjes (New York, SHBA – Tiranë, Shqipëri), të kryera në Ch. Bank (New York, SHBA)*. Në të njëjtën rubrikë ai ka deklaruar *shpenzime udhëtimi me qëllim vizitë të familjes në New York (SHBA) dhe transferimin e të gjithë anëtarëve të familjes në Tiranë, Shqipëri, të bëra nga Ch. Bank, SHBA*. Të njëjtat deklarime subjekti i ka dhënë edhe në pyetësorin standard, duke specifikuar që këto shpenzime janë bërë dhuratë nga prindërit respektivë në shumën 2.500 USD nga secili, pra në total 5.000 USD. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së Ch. Bank, ka rezultuar se deklaratimet e subjektit përputhen me të dhënat bankare.

Sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer për t’iu bërë dhuratë këto shpenzime nga prindërit respektivë në korrik të vitit 2015, me kërkesë të Komisionit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore për të ardhurat e prindërve të tij. Nga analiza financiare e kryer për prindërit e subjektit, të cilët kanë jetuar së bashku me të në SHBA, ka rezultuar se babai i subjektit nuk ka pasur mundësi t’i japë subjektit shumën 2.500 USD dhe, për këtë arsye, kjo dhuratë nuk është konsideruar si e ardhur në analizën financiare të subjektit për vitin 2015. Me paraqitjen e dokumenteve mbi të ardhura të babait të tij në SHBA, si edhe pensionet e të dy prindërve në Shqipëri, ka rezultuar se babai i subjektit ka pasur mundësi t’i dhurojë djalit të tij shumën 2.500 USD, e cila është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2015.

Sa i takon prindërve të bashkëshortes, subjekti ka sqaruar se ata jetojnë në SHBA nën shërbim të vajzës së tyre S. P., për mirërritjen e fëmijëve të saj, duke nënkuptuar që paguhen nga vajza e tyre, por nuk ka vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë të ardhurat e tyre. Në këto kushte, shuma prej 2.500 USD është përfshirë si shpenzim i kryer nga subjekti. Në parashtrimet e tij subjekti nuk e ka kundërshtuar këtë shpenzim si të kryer prej tij.

**99.** Për efekt të kryerjes së analizës financiare, në pyetësorin nr. 2, subjektit iu kërkua informacion duke vërtetuar me dokumente shkresore se ku ka banuar gjatë periudhave të poshtëshënuara, si dhe në lidhje me përbërjen e familjes. Konkretisht:

- Për periudhën gjatë Shkollës së Magjistraturës, subjekti ka deklaruar se ka qenë akomoduar pranë Qytetit Studenti, godina nr. 2 dhe se gjatë kësaj periudhe (1997 – 1999) është trajtuar me

<sup>107</sup>Shih shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 4.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

bursë nga ky institucion (totali *neto* = 359.687). Subjekti ka paraqitur si provë vërtetimin nr.\*\*\* prot., datë 18.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës.

- Për periudhën nga fillimi i detyrës dhe deri në momentin që është larguar në SHBA, subjekti ka deklaruar se për periudhën 27.9.2000 (data e emërimit për herë të parë në detyrë) – 18.8.2003, ka jetuar me familjen tij të përbërë nga Gj. G., D. G., Kastriot Gramshi dhe K. G., në adresën: S\*\* D\*\*, banesë private, Komuna D\*\*, Shkodër (sot Njësia Administrative D\*\*) Shkodër. Shpenzimet e jetesës janë përballuar solidarisht, megjithëse në pjesën më të madhe nga prindërit.

- Shpenzimet e deklaruara nga subjekti janë përfshirë në analizën financiare në rubrikën shpenzime.

**100.** Në lidhje me mosplotësimin dhe mosdorëzimin në ILDKPKI, të DPV-së për vitin 2003, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se me dekretin nr. \*\*\*, datë 27.9.2000, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe se me vendimin nr. 155, datë 20.5.2004, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është pranuar kërkesa për dorëheqje dhe është vendosur lirimi i tij si gjyqtar.

**100.1** Duke qenë se subjekti ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën nëntor 1999 – tetor 2003, nga Komisioni u kërkua informacion në ILDKPKI, nëse subjekti ka bërë deklaram të pasurisë në kohën që i ka lindur ky detyrim sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. ILDKPKI-ja<sup>108</sup>, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2021, konfirmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar deklaratatë të tjera përveç deklaratave të parafillimit të detyrës në vitin 2014 dhe deklaratave periodike të viteve 2014 – 2020.

**100.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të paraqesë sqarime në lidhje me konstatimin, ku duket se: subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues dhe sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka pasur detyrim deklaramin mbi gjendjen e pasurive deri më 31.12.2003, deklaram të cilin nuk e ka kryer.

**100.3.** Në parashtrimet e veta, subjekti sqaroi se gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë fizikisht në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive të plotësimit dhe depozitimit të këtij formulari pranë institucionit të krijuar rishtazi. Të njëjtin qëndrim subjekti mbajti edhe në seancën dëgjimore.

**100.4.** Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se subjekti ndodhet në kushtet e një pasaktësie në deklaramin për vitin 2003, por çmoi ta konsiderojë këtë pasaktësi pa ndonjë peshë specifike të posaçme për shkak të mungesës së pasojës, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

i) Subjekti, realisht, ka qenë në SHBA në periudhën kur ka pasur detyrimin e plotësimit të deklaratës së interesave private dhe pasurore për vitin 2003 (është larguar në SHBA në datën 18.3.2003), i cili ka qenë deklarami i parë në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Ky ligj ka hyrë në fuqi dhe ka filluar të zbatohet rishtazi më 31.5.2003 dhe deklarami, sipas tij, ka qenë një praktike e re dhe e panjohur për subjektet e rivlerësimit, e cila jo në pak raste ka shkaktuar neglizhenca dhe deklaram të pasakta nga subjekte të rivlerësimit.

---

<sup>108</sup>Shih shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2021-të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

ii) Nuk rezulton që subjekti të jetë penalizuar nga ILDKPKI-ja për moskryerje deklarimi për vitin 2003.

iii) Në pyetësorin standard subjekti ka dhënë sqarime të detajuara dhe ka paraqitur dokumente shkrese në lidhje me çdo pasuri të familjes së tij dhe personave të lidhur, si dhe në lidhje me adresa të banimit gjatë vitit 2003 (dhe jo vetëm), të cilat u gjenden në përputhje me aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

iv) Pas një hetimi të thelluar administrativ nga Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit, nuk rezultuan pasuri/transaksione të dyshimta të subjektit apo personave të lidhur me të në vitin 2003, por edhe përpara këtij viti, çka do të bënte me pasojë negative mosplotësimin e DPFDSë deri më 31.12. 2003.

### Analiza financiare përmbledhëse

**101.** Në përfundim të hetimit administrativ, për të evidentuar mundësinë e subjektit dhe familjes së tij për të krijuar pasuritë/likuiditetet, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën e rivlerësimit nëntor 1999 - gusht 2003 dhe korrik 2014 - dhjetor 2016, përmbledhur në tabelën më poshtë, e cila i është njoftuar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

| Përshkrimi                  | 11/1999 - gusht 2003 | 10.7.2014 - 31.12.2014 | 2015             | 2016              |
|-----------------------------|----------------------|------------------------|------------------|-------------------|
| Pasuri                      | 1 709 179            | 12 241 707             | -1 846 538       | 598 928           |
| Të ardhura dokumentuar      | 1 824 535            | 760 488                | 2 673 436        | 2 469 871         |
| Shpenzime                   | 442 674              | 504 492                | 3 150 744        | 5 528 666         |
| <b>Mundësia për kursime</b> | <b>-327 318</b>      | <b>-11 985 711</b>     | <b>1 369 231</b> | <b>-3 657 723</b> |

**102.** Në parashtrimet e veta, subjekti ka kundërshtuar dhe ka paraqitur prapësimet në lidhje me analizën financiare të cilën e ka ndarë në tri periudha: (i) nëntor 1999 – gusht 2003, kur ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Shkodër; (ii) 2005 – 10.7.2014, kur ka jetuar në SHBA; (iii) datë 10.7.2014 – 31 dhjetor 2016, kur ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Tiranë. Sipas tij, analiza financiare për periudhën e rivlerësimit rezulton me balancë pozitive. Pretendimet dhe dokumentet që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit janë trajtuar hollësisht dhe në mënyrë të detajuar nga Komisioni në këtë vendim, gjatë trajtimit të çdo pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme të subjektit dhe personave të lidhur me të.

**103.** Në përfundim të procesit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka kundërshtuar bindshëm të kundërtën e barrës së provës lidhur me analizën financiare dhe pasi janë analizuar në mënyrë të detajuar dokumentet e paraqitura dhe prapësimet e subjektit, janë marrë në konsideratë një pjesë e konsiderueshme e tyre, përmbledhur shkurtimisht si vijon:

- Për periudhën e parë, është konsideruar me të ardhura të ligjshme dhurata në shumën 12.000 USD, dhënë prej babait të subjektit në janar të vitit 2003, arsyetuar hollësisht në paragrafët 29-34.

- Për periudhën e dytë të qëndrimit në SHBA, janë njohur si të ardhura të ligjshme: (i) shumat e kthyera të taksave subjektit dhe vëllait të tij; (ii) të ardhura të babait të tij nga puna për periudhën qershor 2004 – qershor 2014; (iii) pensionet e prindërve në SHBA, si dhe pensionet e tyre në Shqipëri; si dhe (iv) është bërë rishikimi i shpenzimeve të jetesës duke i përlogaritur

ato sipas metodologjisë proporcionale<sup>109</sup> dhe sipas ditëve të qëndrimit midis SHBA-së dhe Shqipërisë (për prindërit e subjektit), trajtuar hollësisht në paragrafët 48-49 dhe 70 e këtij vendimi.

- Për periudhën e tretë: (i) është konsideruar mbartja e depozitave nga SHBA-ja në shumën 110.351 USD, të krijuara me burime të ligjshme; (ii) janë përfshirë si të ardhura të ligjshme shumat e përfituara nga qiratë e banesës në SHBA për vitet 2015 dhe 2016; (iii) është përfshirë si shpenzim në analizën financiare për vitin 2016, vetëm shuma 2.500 USD, paguar nga subjekti për tatimin mbi të ardhurat nga shitja e apartamentit në Tiranë; (iv) nuk është përfshirë si shpenzim në analizën financiare për vitin 2016 shuma 4.800 euro, pasi rikonstruksioni i apartamentit ka filluar në korrik të vitit 2017, trajtuar hollësisht në paragrafin 25.2 të këtij vendimi.

**104.** Bazuar në sa më sipër, analiza e rishikuar financiare e kryer me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor në procesin e vendimmarrjes, paraqitet me balanca pozitive, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

| Përshkrimi                                       | 11.1999 -<br>gusht 2003 | 10.7.2014 -<br>31.12.2014 | 2015              | 2016              |
|--|-------------------------|---------------------------|-------------------|-------------------|
| <b>Pasuri</b>                                    | <b>1 709 179</b>        | <b>12 241 707</b>         | <b>-1 846 538</b> | <b>598 928</b>    |
| Ap. me sip. 63.5 m <sup>2</sup> , Rr. "*****" TR |                         |                           |                   | 1 758 510         |
| <i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>               | <i>1 709 179</i>        | <i>12 241 707</i>         | <i>-1 846 538</i> | <i>-1 159 582</i> |
| Likuiditete Gjendje                              | 1 709 179               | 13 950 885                | 12 104 347        | <b>10 944 765</b> |
| <b>Të ardhura dokumentuar</b>                    | <b>3 128 815</b>        | <b>13 300 769</b>         | <b>3 942 537</b>  | <b>3 547 507</b>  |
| Të ardhura nga paga e subjektit                  | 1 824 535               | 501 464                   | 1 024 631         | 992 081           |
| Të ardhura nga universiteti "****" Tiranë        |                         |                           | 144 533           | 394 853           |
| Të ardhura nga SHBA puna (bashkëshortja)         |                         |                           | 984 837           |                   |
| Të ardhura nga SHBA qiraja                       |                         |                           | 227 952           | 1 077 636         |
| Rimbursim taksash nga shteti                     |                         |                           | 1 242 085         | 1 081 998         |
| Interesa bankare                                 |                         | 259 024                   | 1 900             | 939               |
| Dhuruar nga babai                                | 1 304 280               |                           | 316 600           |                   |
| Likuiditete të krijuara në SHBA                  |                         | 12 540 281                |                   |                   |
| <b>Shpenzime</b>                                 | <b>442 674</b>          | <b>504 492</b>            | <b>2 724 366</b>  | <b>2 887 819</b>  |
| Shpenzime jetese                                 | 442 674                 | 97 716                    | 672 828           | 1 175 460         |
| Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>                   |                         | 301 776                   | 1 376 538         | 339 784           |
| Qira banese                                      |                         | 105 000                   | 420 000           | 420 000           |
| Shpenzime shkollimi për vajzën G. tek F.         |                         |                           | 127 500           | 307 200           |
| Shpenzime shkollimi për djalin G. F.             |                         |                           | 127 500           | 307 200           |
| Paguar tatimi për shitjen e pasurisë në Tiranë   |                         |                           |                   | 338 175           |
| Shpenzime të tjera/të ndryshme                   |                         |                           |                   | 0                 |
| <b>Mundësia për kursime</b>                      | <b>976 962</b>          | <b>554 570</b>            | <b>3 064 710</b>  | <b>60 760</b>     |

### Vlerësimi përfundimtar i kriterit pasuror

**105.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *Vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e

<sup>109</sup>Kjo metodologji presupozon që shpenzimet e jetesës së një personi janë përpjesëtimore midis shpenzimeve familjare dhe jo shpenzime të barabarta me ato të një personi kur ai jeton më vete.

konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit. Veç këtyre, për një vlerësim pozitiv të kriterit pasuror, Komisioni çmon me rëndësi faktin se në lidhje me këtë subjekt rivlerësimi janë kryer hetime të thelluara edhe për deklarime të kryera pas deklaratës *Vetting*, pikërisht në funksion të krijimit të bindjes së brendshme në lidhje me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve të kryera para kësaj deklarate nga ana e subjektit dhe personave të lidhur. Nga hetimet rezultoi se çdo deklarim pas deklaratës *Vetting* ka qenë në koherencë të plotë dhe në vijueshmëri të deklarimeve që nga viti 2014, kur subjekti ka rifilluar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit dhe deri në deklaratën *Vetting*.

### **Kontrolli i figurës**

**106.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo elemente që cenojnë figurën e tij, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Kastriot Gj. Gramshi.

**106.1** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2021, është kërkuar përditësimi i informacionit për këtë subjekt. Agjencitë ligjzbatuese, me shkresa konfidenciale, kanë informuar se nuk ka pasur të dhëna shtesë në lidhje me këtë subjekt.

**107.** Duke qenë se gjatë procesit të rivlerësimit nuk u evidentuan të dhëna që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit si kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo veprimtari të tjera kriminale, si dhe të dhëna për korrupsion, në përfundim të këtij procesi, subjekti u vlerësua i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

### **Vlerësimi profesional**

**108.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, bazuar në: (i) raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2020; (ii) informacionin e marrë nga burime të tjera të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, analizuar hollësisht më poshtë.

### **Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga KLGJ-ja**

**109.** Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një

sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së. Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë rezultuar problematika. Nga analiza e pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, janë konstatuar disa parregullsi, si vijojnë:

**109.1** Nga KLP-ja është analizuar dosja nr. 2, për çështjen civile nr. \*\*\* regj., datë 21.5.2015 regj., që i përket kërkuases N. E. (T.), personi i tretë DRSSH Tiranë dhe ISSH Tiranë, me objekt: “pasaktësi akti” (dhe vërtetim fakti sipas kërkesëpadisë dhe vendimit të gjykatës), e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2016, me anë të të cilit është vendosur pranimi i kërkesës. Nga aktet e dosjes, ndër të tjera, evidentohet se: (i) në çeljen e seancave gjyqësore ka pasur vonesa nga 12 minuta - 2 orë e 2 minuta, vonesa të cilat janë evidentuar në procesverbalin e seancave gjyqësore, të ardhura për shkak të mbingarkesës së gjyqtarit, ku në një rast kjo vonesë është bërë shkak për largimin e palës së paditur dhe dështimin e seancës gjyqësore; (ii) dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar është dorëzuar në datën 6.4.2016 nga gjyqtari – pas 13 ditëve nga shpallja e vendimit, pra jashtë afatit 10-ditor, të parashikuar nga neni 308, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Civile; (iii) gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka zgjatur gjithsej 10 muaj e 2 ditë, jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit; (iv) ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.6.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 24.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**109.2** Nga KLP-ja është analizuar dosja 3, për çështjen civile nr. \*\*\* regj., datë 16.10.2014 regj., që i përket paditëse M. R., kundër të paditurit shkolla e mesme “Qemal Stafa”, me objekt: *“rregullimi dhe saktësimi i dokumenteve që janë në emrin tim të plota dhe që bien në kundërshtim me regjistrin themeltar të shkollës etj.”*, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.5.2015, me anë të të cilit është vendosur pranimi i padisë. Nga aktet e dosjes, ndër të tjera, evidentohet se: (i) dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar në datën 1.6.2015 nga gjyqtari – pas 19 ditëve nga shpallja e vendimit, ndërkohë që është shtyrë shpallja e arsyetuar e vendimit deri në 5 ditë dhe jo vetëm dispozitivi i vendimit; (ii) vendimi është arsyetuar jashtë afatit të ankimit, por për këtë çështje palët nuk kanë ushtruar ankim ndaj vendimit të dhënë; (iii) gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 21 ditë, jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

**109.3.** Nga KLP-ja është analizuar dosja nr. 5, për çështjen penale (masë sigurimi) nr. \*\*\*, datë 3.5.2015, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi “arrest në burg” me afat 30-ditor, ndaj të dyshuarit L. Xh. për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. s’ka, datë 4.5.2015, me anë të të cilit është vendosur vlerësim arresti në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore çdo të mërkurë ora 13:00”. Nga aktet e dosjes, ndër të tjera, evidentohet se: (i) dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar është dorëzuar 21 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale; (ii) nuk ka vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

**109.4.** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime për sa është konstatuar në analizën e dokumentacionit të tri dosjeve të sipërpërmendura. Në parashtrimet e veta, ashtu sikurse edhe në seancë dëgjimore, subjekti dha shpjegime në lidhje me vonesat dhe parregullsitë e evidentuara duke argumentuar në çdo rast arsyet si: për shkak të njoftimeve të palëve, kërkesave të papërgatitura që bëjnë palët, kohës që u jepej atyre për të sjellë provat, si dhe ngarkesës në punë, e cila ka sjellë si pasojë dhe arsyetimin me vonesë të vendimeve në rastet e evidentuara. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti paraqiti në

seancë dëgjimore provat shkresore si vijojnë: (i) sa i takon dosjes nr. 2, subjekti paraqiti procesverbale nga dosja civile nr. \*\*\*, datë 24.3.2016 dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2016; (ii) sa i takon dosjes nr. 3, subjekti paraqiti procesverbale nga dosja civile nr. \*\*\*, datë 12.5.2015 dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 12.5.2015; (iii) sa i takon dosjes nr. 5, subjekti paraqiti vendimin nr. \*\*\* regj. them. datë 4.5.2015; (iv) kopje të ngarkesë së gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështje të gjykuara: 200 në vitin 2014, 495 në vitin 2015, 524 në vitin 2016; 1228 për periudhën 1.1.2014 - 31.12.2016.

**109.5.** Në analizë të parashtrimeve dhe akteve shkresore të administruara, u konstatua se ashtu sikurse edhe KLP-ja kishte evidentuar në raportin e vet tejkalimin e afateve të gjykimit, dorëzimit me vonesë të vendimeve të arsyetuara dhe shtyrjen e seancave gjyqësore, ka ndodhur në çdo rast për shkaqe objektive e të justifikuara si: mungesës së palëve dhe mosparaqitjes së provave, sjelljes së palëve në proces, periudhës së lejes vjetore gjatë muajit gusht, si dhe për shkak të ngarkesës së lartë sasiore në punë, vërtetuar me dokumentin shkresor të paraqitur si provë shkresore nga subjekti. Po kështu edhe KLP-ja në raportin e vet, është shprehur se subjekti ka gjykuar 468 çështje civile me palë kundërshtarë për një periudhë prej 2 vjet e 3 muaj, kur për 3 vjet kërkohet të jetë jo më pak se 360 çështje. Sa i takon dosjes nr. 5, pavarësisht pretendimeve të subjektit, konstatohet se dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar të dorëzuar jashtë afatit 5-ditor, ka ardhur për shkaqe jo tërësisht të justifikuara, por ky fakt nuk është vlerësuar si shkak që cenon aftësitë profesionale të subjektit, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që ndaj këtij vendimi palët nuk kanë bërë ankim.

**110.** Nga analiza e të dhënave nga burime arkivore, KLP-ja ka konstatuar se sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Kastriot Gramshi janë paraqitur gjithsej 13 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat, 7 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndërsa 4 janë verifikuar. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Kastriot Gramshi përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor. Në lidhje me dy ankesa, Komisioni ka vlerësuar të kryejë hetime të mëtejshme (trajtuar në paragrafët 112 dhe 113 të këtij vendimi).

**111.** Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar pozitivisht subjektin e rivlerësimit, duke renditur në mënyrë të përmbledhur përfundimet për secilin prej kriterëve, si vijon:

### **Për aftësitë profesionale**

**111.1** Njohuritë ligjore: subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor dhe ka njohuri për parimet e përgjithshme të së drejtës, të cilat i përdor në procedurën e gjykimit, gjithashtu sipas rastit, i analizon shprehimisht ato në tekstin e vendimit.

**111.2.** Arsyetimi ligjor: subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimin dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit disponohet e drejta për shpenzimet gjyqësore, si dhe e drejta e ankimit. Kur është



rasti, shoqërohet edhe me urdhrin e ekzekutimit. Ai i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, ku në të gjitha rastet pasqyrohet saktë shkaku dhe baza ligjore (shihni 5 dosjet).

### **Për aftësitë organizative**

**111.3.** Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë: pasi është evidentuar periudha e ushtrimit të detyrës dhe ngarkesa në punë është konstatuar se rendimenti i përfundimit të çështjeve si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është 82.8 %. Referuar germës “e”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari Kastriot Gramshi për periudhën e rivlerësimit 10.7.2014 – 8.10.2016, 2 vjet e 3 muaj, ka gjykuar 468 çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare, tregtare e familjare. Rrjedhimisht, ngarkesa e tij sasimore ka qenë mbi standardin minimal.

**111.4.** Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore: subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, pavarësisht konstatimeve në 3 nga 4 çështjet civile, të cilat janë të justifikuar. Orari i fillimit dhe i mbarimit të seancës gjyqësore është dokumentuar, përgjithësisht, saktësisht dhe vonesat janë dokumentuar në procesverbalin e seancave gjyqësore respektive, të cilat kanë qenë për shkaqe objektive dhe nuk kanë sjellë asnjë pasojë për palët në proces. Vendi i zhvillimit të seancave gjyqësore (sallë apo zyrë) nuk është dokumentuar, si dhe seancat gjyqësore nuk janë regjistruar audio, me përjashtim të seancës 3 të dosjes 2, si dhe seancës 6 të dosjes 4, të cilat janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe regjistruar me audio. Në analizën e kësaj të dhëne duhet mbajtur në konsideratë infrastruktura e dobët që ka pasur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë gjykimit, gjyqtari Kastriot Gramshi, përgjithësisht, ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit, dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar, i kushton shumë rëndësi kërkimeve procedurale të palëve, në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit.

**111.5.** Aftësia për të administruar dosjet: nga vëzhgimi i dosjeve të analizuara nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet. Në dosjen e masës së sigurimit nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore, por ka akte për njoftimin e palëve për datën e seancës, e cila ka vijuar rregullisht në datën e caktuar për gjykim.

### **Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale**

**111.6.** Etika në punë: sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Kastriot Gramshi.

**111.7.** Integriteti: nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

**111.8.** Paanësia: nga dokumentet ligjore të vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve, nuk janë konstatuar shkelje ts ts drejtave për shkak të pabarazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar as përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

## **Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional**

**111.9** Aftësitë e komunikimit: gjyqtari Kastriot Gramshi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore dhe gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve.

**111.10** Aftësia për të bashkëpunuar: nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Kastriot Gramshi për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. Vonesat në arsyetimin e vendimeve për çështjet e ankimuarra kanë qenë të vogla dhe nuk janë bërë pengesë për të realizuar palët të drejtën e ankimit në gjykatën më të lartë, që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

**111.11.** Gatishmëria për t'u angazhuar: subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë në 1 seminar dhe 3 trajnime organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me misionin EURALIUS. Lidhur me trajnime të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe vërtetuar se ka "Master në Shkencat Politike dhe Juridike" B. College of the C. University of New York në periudhën 2.2007 - 6.2008.

## **Informacioni i marrë në rrugë ligjore marrë nga burimet ligjore si vijojnë:**

**112.** Me kërkesë të Komisionit, KLGJ-ja<sup>110</sup> vuri në dispozicion praktikën e ankesës nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2015, të "\*\*\*\*", në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së gjyqtarit Kastriot Gramshi për zvarritje të gjykimit, në shqyrtimin e çështjes civile me objekt: "kundërshtimi i veprimit përmbartimor për caktimin e ekspertëve dhe vlerësimin e pronave të shoqërisë debitorë "\*\*\*\*" sh.p.k. Pavlefshmëria e veprimeve të kryera nga përmbartuesi privat "\*\*\*\*" sh.p.k.", KLD-ja ka shqyrtuar çështjen civile me nr. regj. them \*\*\*, datë 7.11.2014, e cila ka përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2015. Nga verifikimi i kryer prej inspektorëve të KLD-së, është evidentuar se gjyqtari Kastriot Gramshi, ka tejkualuar afatin e gjykimit dhe afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar dhe ka vendosur "tërheqje vëmendjeje me shkrim".

**112.1** Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të paraqesë shpjegime dhe dokumente shkresore për të kundërshtuar konstatimet e inspektorëve mbi: (i) afatin e tejkualuar prej 7 muaj e 19 ditë; (ii) vendimin e dorëzuar më 16.9.2015, pas 1 muaj e 16 ditë duke tejkualuar afatin ligjor, parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, prej 1 muaj e 6 ditë; (iii) zvarritje gjykimi tej afatit të përcaktuar në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile.

**112.2.** Në parashtrimet e veta subjekti ka deklaruar në mënyrë të përmbledhur se: (i) çështja është regjistruar më 7.11.2014, e gjykuar nga ana e tij dhe ka përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2015, ndaj të cilit është ushtruar ankim; (ii) çështja ka qenë komplekse dhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë regjistruar disa kërkesëpadi me të njëjtin objekt, gjykuar nga gjyqtarë të ndryshëm pranë kësaj gjykate, fakt që hedh dritë mbi natyrën komplekse të çështjes; (iii) vështirësia e shqyrtimit të kësaj kërkesëpadie ka të bëjë me faktin se domosdoshmërisht duheshin realizuar veprime procedurale, të cilat donin kohën e tyre si realizimi i aktekspertimit dhe më tej pyetja e ekspertëve; (iv) lidhur me objektet që do t'i nënshtroheshin vlerësimit, referuar pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, ka disponuar në mënyrë të arsyeshme dhënien e një kohe të mjaftueshme për realizimin e kryerjes së aktekspertimit; (v) seancat gjyqësore janë shtyrë vetëm me kërkesë të palëve ndërgjyqëse dhe

<sup>110</sup>Shih shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, të KLGJ-së, në dosjen e Komisionit.

për shkaqe të arsyeshme; (vi) subjekti ka pasur ngarkesë shumë të madhe në punë dhe përtej çdo limiti. Subjekti sjell në vëmendje të Komisionit vendimin nr. \*\*\*, datë 12.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit referuar parimeve të së drejtës vendase dhe ndërkombëtare, me afat të arsyeshëm ligjor do të kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në dhënien/shpalljen e vendimit përfundimtar nga gjykata, por edhe koha që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut kërkon garantimin e procesit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjyqimit, të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes.

**112.3.** Në seancën dëgjimore datë 15.2.2020, subjekti shpjegoi se kohëzgjatja e kësaj çështjeje ka pasur si shkak vlerën e lartë të objektit të padisë apo kompleksitetin e çështjes dhe se, sipas tij shkaqet kanë qenë objektive, si dhe paraqiti vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2015, ashtu sikurse edhe fotokopje të akteve të dosjes gjyqësore.

**112.4.** Në analizë të akteve shkresore të dosjes, në lidhje me këtë çështje u administruan aktet si vijojnë:

- “\*\*\*\*” ka paraqitur kërkesëpadi me datë 6.11.2014, me palë të paditur shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., person i tretë “\*\*\*\*” me objekt, kundërshtimi i veprimit përmbartimor për caktimin e ekspertëve dhe vlerësimin e pronave, pavlefshmëri të veprimeve të kryera nga përmbartuesi privat “\*\*\*\*” sh.p.k. në kuadër të urdhrave të ekzekutimit sipas vendimeve nr. \*\*\* datë 27.6.2014, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* datë 30.6.2014, marrja e masës së përkohshme për sigurimin e objektit të padisë.

- “\*\*\*\*” ka paraqitur kërkesën për bashkimin e çështjes civile nr. \*\*\* akti, me objekt “kundërshtimi i veprimit përmbartimor për caktimin e ekspertëve dhe vlerësimin e pronave etj.” me çështjen civile nr. \*\*\* akti, me objekt “kundërshtimi i veprimeve përmbartimore”, që po gjykohej nga subjekti i rivlerësimit.

- Subjekti ka marrë një vendim për marrje mase sigurimi nr. \*\*\* regj., datë 4.3.2015.

- Me kërkesëpadi datë 3.11.2014, paditësi \*\*\* sh.p.k. ka paditur shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., person i tretë “\*\*\*\*”, me objekt kundërshtimin e vendimit për caktimin e çmimit të sendit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

- Me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 12.11.2014, gjyqtari Kastriot Gramshi ka vendosur caktimin e seancës përgatitore.

- Me procesverbale të çështjeje me nr. akti \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* evidentohen kërkesat për shtyrje nga palët.

- Me vendimin datë 16.2.2015 të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për shpallje ankandi, është vendosur që ankandi të fillojë në vlerën totale prej 24.480.000 euro.

- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit Kastriot Gramshi është vendosur: pranimi i pjesshëm i padisë, anulimi i veprimeve përmbartimore duke urdhëruar vazhdimin e veprimeve përmbartimore në vlerën 61.420.273 euro, ligjërimin e masës së sigurimit dhe rrëzimin e padisë për pjesët e tjera.

- Ky vendim është ankimuar edhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit në këtë mënyrë: pranimin e kërkesëpadiës, anulimi i veprimeve përmbartimore duke urdhëruar vazhdimin e veprimeve përmbartimore në vlerën 61.420.273 euro, pavlefshmërinë e veprimeve të kryera nga përmbartuesi gjyqësor privat dhe ligjërimin e masës së sigurimit të objektit të padisë.

**112.5.** Në analizë të akteve shkresore të sipërpërmendura, pa iu futur themelit të çështjes, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, nga Komisioni vlerësohet se pretendimet e subjektit qëndrojnë dhe se kohëzgjatjet në tejkalim të afateve ligjore, si dhe në lidhje me dorëzimin e vendimit tej afatit, kanë qenë përgjithësisht për shkaqe objektive dhe të justifikuara ligjërisht, pasi buronin nga kompleksiteti i çështjes, kërkesat e palëve, kryerjes së aktekspertimit apo ngarkesës në punë të subjektit dhe jo për shkak të neglizhencës së subjektit të rivlerësimit.

**113.** Me kërkesë të Komisionit, KLGJ-ja<sup>111</sup> vuri në dispozicion praktikën e ankesës nr. \*\*\* prot., datë 20.6.2016, të shtetasit A. L., në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së gjyqtarit Kastriot Gramshi për zvarritje të gjykimit, në shqyrtimin e çështjes civile me objekt: “konstatimi i pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes me kusht”. Nga aktet e kësaj praktike ankese rezultoi se gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit, 6 muaj e 19 ditë, në kapërcim të afatit 6-mujor, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2 prot., datë 14.4.2010, të KLD-së, Aneksi 1 pika 5/e dhe pavarësisht këtij afati, çështja nuk është zgjidhur me vendim përfundimtar. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti të paraqesë sqarime dhe dokumente shkresore në lidhje me këtë konstatim.

**113.1.** Në parashtrimet e veta subjekti ka dhënë sqarime mbi arsyet e kohëzgjatjes, sipas të cilave mbarëvajtja e procesit është kondicionuar nga mosmarrja dijëni e palës/ve ndërgjyqëse, si dhe sjellja e palëve në proces. Subjekti ka sjellë në vëmendje sjelljen e përfaqësuesit ligjor të palës paditëse, av. A. L., i cili ka bërë kërkesa të vazhdueshme për dorëheqjen e subjektit, e cila është pranuar dhe, për pasojë, kjo çështje nuk është përfunduar me vendim përfundimtar nga subjekti, por i ka kaluar një tjetër trupi gjykues. Në seancën dëgjimore të datës 15.2.2022, subjekti dha të njëjta shpjegime si dhe paraqiti si prova shkresore aktet: (i) kthim përgjigje të KLD-së drejtuar z. A. L., me anë të cilës informohet për konstatimet pas verifikimit të ankesës; dhe (ii) kërkesë të av. A. L. drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili pretendon për rast korruptiv dhe shkelje procedurale nga gjyqtari Kastriot Gramshi.

**113.2.** Në analizë të pretendimeve të subjektit, sipas akteve dhe procesverbaleve përcjellë nga KLGJ-ja, janë zhvilluar 30 seanca të shtyra kryesisht për shkaqe të justifikuara si kërkesat e palëve, mosmarrje dijëni të palëve dhe kryerja e aktekspertimit. Sa i takon pretendimit të subjektit se avokati A. L. ka paraqitur kërkesa për dorëheqjen e tij, rezulton se sipas procesverbalit të seancës gjyqësore datë 27.5.2016, ka pasur një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit nga av. A. L., të cilit i është lënë afat për paraqitjen me shkrim pranë sekretarisë së gjykatës, duke u shtyrë seanca gjyqësore e kësaj date. Sipas shënimit të gjyqtarit datë 3.6.2016, rezulton se pas verifikimit në kryesekretari, nuk është paraqitur kërkesë e tij me shkrim për përjashtimin e trupit gjykues. Në këto kushte, subjekti i është drejtuar kryetarit të gjykatës me kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, dorëheqje që është pranuar me vendim datë 24.6.2016. Për këtë arsye seanca e datës 22.6.2016 është shtyrë pikërisht për shkak të kësaj dorëheqjeje të subjektit.

**113.4.** Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, në analizë të çdo pretendimi dhe dokumenti shkresor të administruar, nga Komisioni u vlerësua se pavarësisht se disa seanca nuk kanë qenë produktive (ashtu sikurse KLD-ja kishte evidentuar), mosmenaxhimi i mirë i procesit dhe tejkalimi i afatit 6-mujor të shqyrtimit të çështjes nga subjekti, kanë ardhur kryesisht për shkaqe të justifikuara ligjërisht dhe objektivisht, të cilat janë evidentuar në procesverbalet e seancave gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>111</sup>Shih shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, të KLGJ-së, në dosjen e Komisionit.

## Informacioni i marrë nga denoncimet e publikut

**114.** Në adresë të subjektit janë paraqitur pesë denoncime, trajtuar si vijojnë:

**114.1.** Në denoncimin e paraqitur nga shtetasi H. A.<sup>112</sup>, ngrihet pretendimi për vendimmarrje të padrejtë nga ana e disa subjekteve të rivlerësimit. Konkretisht, për subjektin Kastriot Gramshi pretendon se ka dhënë vendim të njëanshëm për ndërrimin e një gjyqtareje kur ajo nuk ishte shprehur ende me vendim. Denoncuesi nuk ka paraqitur asnjë rrethanë, fakt a provë për të vërtetuar pretendimin e tij. Për më tepër, vendimmarrja e subjektit nuk ka të bëjë me procedura ligjore, por me vlerësimin e tij në trajtimin e një kërkesë dhe, si e tillë, nuk është në tagër të Komisionit vlerësimi i kësaj vendimmarrjeje.

**114.2.** Në denoncimin e paraqitur nga shtetasi A. D.<sup>113</sup>, ngrihet pretendimi për disa subjekte rivlerësimi, ndërsa për subjektin Kastriot Gramshi ngrihet pretendimi për vendimmarrje të padrejtë dhe të njëanshme, duke mos vlerësuar drejt faktet dhe provat e paraqitura, pasi ai në aksident ka qenë pala e dëmtuar. Nga dokumentet bashkëngjitur denoncimit konstatohet se me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.2.2018, të gjyqtarit Kastriot Gramshi, denoncuesi është dënuar për veprën penale “drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, akuzë e cila është pranuar nga denoncuesi edhe gjatë kohës kur është marrë në pyetje nga prokuroria në cilësinë e të pandehurit. Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të gjyqtarit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e atij që vlerësohet, vlerësimi i pretendimeve të denoncuesit del jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit, duke çmuar se një pretendim i tillë duhet të ishte objekt i ankimit në një shkallë më të lartë. Ndërkohë denoncuesi nuk ka dhënë informacion nëse ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim ose jo.

**114.3.** Në denoncimin e paraqitur nga shtetasi K. G.<sup>114</sup> ngrihen disa pretendime në lidhje me dy pasuri në pronësi të subjektit: (i) apartamenti me sip. 63.5 m<sup>2</sup> me vendndodhje në Tiranë; dhe (ii) banesë në SHBA dhe kredia e marrë për blerjen e saj, pretendime të cilat janë verifikuar nga Komisioni për efekt të procesit të rivlerësimit të kriterit pasuror, duke u kryer hetime të plota, pasqyruar hollësisht në këtë vendim në paragrafët që kanë lidhje me rivlerësimin e pasurisë.

Denoncuesi, gjithashtu, pretendon se subjekti nuk ka deklaruar saktë adresën gjatë qëndrimit në SHBA në formularin për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të cilin e ka vënë në dispozicion për periudhën e qëndrimit në SHBA, shtator 2003 – korrik 2014, ku ka deklaruar adresë vendqëndrimi: “\*\*\* N. A., B., NY \*\*\*; USA”. Nga hetimi administrativ rezultoi se kjo është adresa e banesës që subjekti ka blerë në SHBA në vitin 2012, deklaruar në deklaratën *Vetting*, ndërsa i pyetur mbi vendqëndrimin e tij, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: (i) në periudhën 18.8.2003 – 1.9.2010, ka banuar në adresën: \*\*\* G. C., Apt. \*\*\*, B., NY, \*\*\* (me qira me vlerë 1.500 USD), për të cilën ka deklaruar se nuk disponon kopje kontrate; (ii) në periudhën 1.9.2010 – 31.8.2012, në adresën: \*\*\* W. A. B., NY, \*\*\* (me qira me vlerë 1.800 USD), për të cilën deklaroi se nuk disponon kopje kontrate.

---

<sup>112</sup>Shih denoncimin nga shtetasi H. A., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2017, në dosjen e Komisionit.

<sup>113</sup>Shih denoncim nga shtetasi A. D., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>114</sup>Shih denoncim nga shtetasi K. G., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, në dosjen e Komisionit.

Në përfundim të hetimit administrativ ka qenë e paqartë se përse subjekti në formularin “për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” ka deklaruar si adresë vendqëndrimi për periudhën 2003 – 2014, adresën e shtëpisë që ka blerë në SHBA në vitin 2012. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë paqartësi.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se në përgjigje të pyetjes 8 të formularit, *a keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj*, ka çmuar të japë si adresë vendqëndrimi adresën e fundit që përkon me adresën e banesës në pronësi. Referuar formularit të vitit 2016, subjekti e ka pasur në pronësi banesën në SHBA (fituar në vitin 2012) dhe, për rrjedhojë, argumenti i përdorur nga subjekti konsiderohet i drejtë. Për më tepër, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar në lidhje me dy adresat e banimit në SHBA dhe qiratë e paguara gjatë periudhës përpara se të blinte shtëpinë në SHBA në vitin 2012.

**114.4.** Në denoncimin e paraqitur nga shtetasja Sh. K.<sup>115</sup>, ngrihen pretendime për paaftësi profesionale të subjektit sepse ka dhënë një vendim, i cili nuk mund të regjistrohet në ZVRPP, pasi mungon harta treguese që identifikon pronën dhe se eksperti që ka caktuar gjyqtari nuk e ka përfshirë hartën, e cila është e domosdoshme për regjistrimin e saj. Denoncuesja i ka bashkëngjitur denoncimit vendimin nr.\*\*\*, datë 2.3.2017, të gjyqtarit Kastriot Gramshi, sipas të cilit është pranuar padia e paditëses J. M. (nëna e denoncueses), si dhe kërkesa drejtuar gjykatës për sqarim dhe interpretim të vendimit nr.1616, datë 2.3.2017. Për sa pretendohet në lidhje me subjektin, vlerësohet se nuk qëndron pasi harta treguese nuk është dokument që i bashkëngjitet vendimit gjyqësor, por është pjesë e aktekspertimit, me të cilin palët janë njohur që në fazën e shqyrtimit gjyqësor. Për më tepër, konstatohet se denoncuesja ka paraqitur pranë gjykatës kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e vendimit.

**114.5** Në denoncimin e paraqitur nga shtetasi M. K., avokat<sup>116</sup>, pretendohet se gjyqtari Kastriot Gramshi nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.11.2019. Po kështu, në këtë denoncim ngrihen dyshime për përfshirje të gjyqtarit Kastriot Gramshi në korrupsion, duke dhënë vendim të padrejtë në shkelje të ligjeve. Denoncuesja nuk ka paraqitur dokumente për të vërtetuar këto pretendime.

Sa i takon vendimmarrjes nuk është në kompetencë të Komisionit shqyrtimi i çështjes në themel. Sa i takon pretendimit se nuk janë zbatuar detyrat e Gjykatës së Apelit, me kërkesë të Komisionit, Gjykata e Lartë<sup>117</sup> ka vënë në dispozicion kopjet e akteve të dosjes me nr. \*\*\*, datë regjistrimi 25.1.2021, të Gjykatës së Lartë. Nga shqyrtimi i akteve shkresore, rezultoi se:

- Nga subjekti i rivlerësimit, në rigjykim, palët janë njoftuar rregullisht.
- Ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 8.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtarit Kastriot Gramshi, denoncuesi ka paraqitur ankim drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.10.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 8.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Nga përmbajtja e vendimit nr. \*\*\*, datë 13.10.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë rezultoi se në arsyetimin e saj në lidhje me ankimin e denoncuesit ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 8.6.2020,

<sup>115</sup>Shih denoncimin nga shtetasja Sh. K., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>116</sup>Shih denoncimin nga shtetasi M. K., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>117</sup>Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2021, të Gjykatës së Lartë dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtarit Kastriot Gramshi, kjo gjykatë është shprehur se: “... i pabazuar mbetet dhe pretendimi i të kallëzuarve në ankim se organi i akuzës nuk ka thirrur trashëgimtarët e të kallëzuarit. Së pari: rezulton se procedimi penal është regjistruar pa autor në regjistrat e veprës penale, nuk është shënuar emri i asnjë personi që i atribuohet vepra penale. Gjithashtu, ndryshe sa pretendohet në ankim nga shtetasja L. Ç. se proceduara nuk kanë pasur dijeni për procedimin penal, nga shqyrtimi i akteve të hetimit paraprak nuk rezulton që prokurori të ketë ngritur akuzë apo të ketë regjistruar emrin e shtetasës L. M. (Ç.) për veprën penale 287/a të Kodit Penal”.

- Në përfundim, Gjykata e Apelit është shprehur se në analizë të pretendimeve të paraqitura në ankim në raport me dispozitat procedurale penale që lidhen me kontrollin gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur drejt.

Sa më sipër, pretendimet e paraqitura në denoncim, të ngritura edhe në ankim, janë bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata e Apelit Tiranë, të cilat janë gjetur të pabazuara. Po kështu, ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 13.10.2020, të Gjykatës së Apelit, denoncuesi ka paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe ndodhet me status “studim çështjes”. Në këto rrethana, nga Komisioni është vlerësuar se nuk ka qenë e domosdoshme kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore në lidhje me këtë denoncim.

### **Një informacion i marrë nga mediat online**

**115.** Sipas një informacioni të marrë nga mediat online <https://rd.al/2019/04/13/kush-eshte-gjyqtari-sherbetor-i-rama-alizotit-dhe-historia-e-tij-e-korrupsionit/>, ngrihen dyshime se subjekti është përfshirë në veprime korruptive përpara se të transferohej në SHBA. Duke marrë shkas nga ky informacion, nga Komisioni u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

**115.1** Iu kërkua subjektit të japë informacion për kohën e saktë të largimit të tij në SHBA, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: “Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kam vajtur si vizitor (datë 18.8.2003). Nga kjo datë dhe në vijimësi kam banuar në mënyrë permanente në SHBA deri sa më 8.2010 kam marrë pasaportën amerikane. Të gjitha dokumentet e poseduara gjatë kësaj periudhe janë dorëzuar në momentin e marrjes së certifikatës së natyralizimit”.

**115.2** Nga disa informacione të bëra me dije nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti, në vitin 2004, ka filluar procesin e azil-kërkuesit në SHBA. Për t’u qartësuar në lidhje me periudhën e largimit në SHBA, iu kërkua subjektit të japë sqarime në lidhje me statusin ligjor të qëndrimit të tij deri në vitin 2010, si dhe arsyen e kërkimit të azilit. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5 subjekti ka deklaruar se ka aplikuar për vizë pranë Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe në datën 16.7.2003 është pajisur me vizë turistike dhe ka hyrë në Shtetet e Bashkuara më 18.8.2003. Më pas ka depozituar aplikimin së bashku me dokumentet pranë Zyrës së Emigracionit, e cila është një nga agjencitë e Departamentit të Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Në datën 13.7.2004 është aprovuar kërkesa për azil dhe më 21.6.2006 është pajisur me Kartën e Përhershme të Rezidentit dhe në vitin 2010 është bërë nënshtetas.

Sa i përket arsyes së largimit, subjekti deklaroi se gjatë ushtrimit të detyrës ka refuzuar dhe ka përbuzur marrjen e vendimeve nën presion të çdo forme të mundshme duke deklaruar, ndër të tjera, se: “Mënyra klasike për të ndikuar në vendimmarrje ka qenë përmes presioneve të ushtruara te familjarët. Është koha kur elementë të botës së krimit kanë pasur lidhje dhe me segmente të caktuara shtetërore. Ushtrimi i detyrës me përkushtim dhe refuzimi konstant i familjarëve (babait) për të ndërhyrë dhe ndikuar në punën time për interesa të caktuara, ka qenë arsyeja e vetme që ka përcaktuar vendimmarrjen për lënien e parakohshme të detyrës, pavarësisht kohës së shkurtër të ushtrimit të saj. Në detaje, arsyet e lënies së detyrës janë bërë

*prezente pranë autoriteteve amerikane në momentin e paraqitjes së kërkesës/aplikimit për azil”.* Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, paraqiti kopje të aprovimit të azilit datë 13.7.2004 dhe kopje të kartës së përhershme të rezidentit.

**115.3.** Me qëllim zbardhjen e rrethanave të dorëheqjes së subjektit, si dhe të procedurës së ndjekur nga KLD-ja, iu kërkua informacion Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi procedurën e ndjekur për lirim të tij nga detyra, mbi çdo procedim disiplinor/penal, dhe jo vetëm, deri në vitin 2003, si dhe mbi mënyrën e kthimit në detyrë, duke vënë në dispozicion të gjithë praktikën. KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2021, ka informuar se:

- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.5.2004, KLD-ja ka pranuar kërkesën e subjektit Kastriot Gramshi për lirim nga detyra dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.5.2004, ka miratuar lirim nga detyra. Ndërsa me Dekretin nr. \*\*\*, datë 10.7.2014, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Deri në vitin 2003 nuk ka kërkesa për procedim disiplinor dhe ankesa për subjektin e rivlerësimit.

Bashkëngjitur shkresës, KLD-ja vuri në dispozicion: (i) kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2004, për dhënie dorëheqjeje nga detyra e gjyqtarit Kastriot Gramshi; (ii) procesverbalin datë 20.5.2004; (iii) vendimin nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2004, për lirim nga detyra të subjektit Kastriot Gramshi; (iv) kërkesën nr.\*\*\* prot., datë 12.05.2014, për emërim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të subjektit Kastriot Gramshi; (v) procesverbalin datë 30.6.2014; (vi) vendimin nr. \*\*\*, datë 30.6.2014.

**115.4.** Nga analiza e dokumenteve shkresore të paraqitura nga KLD-ja, vërehet se:

- Subjekti, në kërkesë për dorëheqje në KLD ka shpjeguar se *në gusht të vitit 2003 ka shkuar në SHBA, ku ka aplikuar për Master Degree pranë dy universiteteve në NY, C. University dhe F. University. Në pritje të përgjigjeve të aplikimeve, ka pasur probleme serioze shëndetësore për një kohë të gjatë dhe për këtë shkak nuk ka pasur mundësi të ndjekë procedurën normale për akordim leje apo paraqitje në detyrë. Për këto arsye ka kërkuar pranimin e dorëheqjes, në mënyrë që t'i jepej mundësia për kthim të mundshëm në detyrë.*

- Me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2004, KLD-ja ka vendosur lirim nga detyra të subjektit Kastriot Gramshi, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998: *“Gjyqtarët nuk mund të lëvizin nga detyra, përveç kur: 1. japin dorëheqjen;”*

- Me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2014, drejtuar KLD-së, subjekti ka paraqitur kandidaturën për vendin vakant në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të shpallur me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.4.2014, të KLD-së, duke parashtruar se i plotëson kriteret për konkurrim.

- Sipas procesverbalit të mbledhjes së datës 30.6.2014 me rend dite shqyrtimin e kandidaturave për katër vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku morën pjesë 12 anëtarë të KLD-së, subjekti Kastriot Gramshi ka marrë 9 vota.

- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.6.2014, KLD-ja ka vendosur t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e z. Kastriot Gramshi magjistrat në proflin gjyqtar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**115.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, nga informacioni dhe dokumentacioni i dhënë nga KLD-ja, është konstatuar se: (i) nuk rezultojnë problematika në lidhje me largimin e subjektit nga detyra në vitin 2003, si dhe me rikthimin e tij si gjyqtar në vitin 2014; (ii) ka mospërputhje sa i përket arsyes së largimit nga detyra, dhënë në kërkesën për dorëheqje në vitin 2004 drejtuar KLD-së dhe arsyes së dhënë në shpjegimet e pyetësorit nr. 5. Me njoftimin e rezultateve të



hetimit, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me këtë mospërputhje në deklaramë.

**115.6.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar në mënyrë të përmbledhur se: (i) nuk ka mospërputhje të pohimeve dhënë në kërkesën për dorëheqje në vitin 2004 dhe deklaramëve në përgjigje të pyetësorit nr. 5, pasi deklaramet nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, duke shpjeguar se shkak ligjor i largimit nga detyra është legjitim dhe duhet dalluar motivi dhe arsyeja e largimit nga detyra, me shkakun ligjor; (ii) deklaramet e paraqitura në pyetësorin nr. 5, reflektojnë rrugën ligjore për qëndrimin në SHBA dhe fakti i të ndjerit i pasigurtë në Shqipëri, nuk përbën kundërtënie me dëshirën për të studiuar në SHBA apo të pasurit probleme shëndetësore; (iii) kërkesa për azil është pranuar dhe kjo nuk pasqyron në vetvete asnjë rrethanë apo të dhënë që mund të kompromentonte figurën, profesionalizmin apo gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit; (iv) referuar dispozitave kushtetuese dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, kjo gjetje ndikon në figurën e subjektit dhe duke qenë se bëhet fjalë për fakte dhe ngjarje para vitit 2012, një rrethanë e tillë nuk mund të jetë objekt hetimi, vlerësimi.

**115.7.** Në seancën dëgjimore të datës 15.2.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim me atë të paraqitur në parashtrimet e tij. Sa i takon pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar Elka Ermenkova, në lidhje me arsyet e kërimit të azilit të në SHBA, se çfarë persekutimi ka pasur në Shqipëri, subjekti deklaroi se ligji amerikan dhe ai ndërkombëtar garanton mosdhënien e informacionit për arsyet e azilit. Edhe në seancën e datës 24.3.2022, subjekti nuk iu përgjigj pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar Gerit Sprenger, duke deklaruar se në respektim të ligjit federal amerikan mbi emigracionin dhe atë ndërkombëtar pyetje të tilla nuk mund të bëhen në seancë publike, por edhe nëse do të bëhej në seancë me dyer të mbyllura nuk shikon ndonjë relevancë në lidhje me procesin e rivlerësimit. Sipas tij, tashmë janë standarde të njohura qoftë në legjislacionin amerikan dhe në konventa ndërkombëtare që një informacion i tillë nuk mund të ndahet as brenda për brenda institucioneve amerikane, aq më tepër me institucione të tjera, pasi një informacion i tillë është i rregulluar me të drejtën e konfidencialitetit dhe shpjegimi i dhënë është i mjaftueshëm.

**115.8.** Në analizë të parashtrimeve të subjektit, pavarësisht deklaramëve të tij, Komisioni vlerëson se ka mospërputhje në deklaramet e subjektit në lidhje me shkaqet e dorëheqjes nga detyra. Sa i takon shkakut të deklaramëve të ndryshme, Komisioni çmon me rezervë deklaramin e subjektit, sipas të cilit shkaqet e paraqitura nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, pasi në deklaramet në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar: *“Ushtrimi i detyrës me përkushtim dhe refuzimi konstant i familjarëve (babait) për të ndërhyrë dhe ndikuar në punën time për interesa të caktuara, ka qenë arsyeja e vetme që ka përcaktuar vendimmarrjen për lënien e parakohshme të detyrës”*. Nga ana tjetër, edhe shkaqet e paraqitura në kërkesën drejtuar KLD-së në vitin 2004 për dorëheqje, për arsye shëndetësore dhe studimesh, nuk mund të konsiderohen të pavërteta, për më tepër kur është vërtetuar që me shkuarjen në SHBA, subjekti ka ndjekur studime në B. College në vitet 2007 - 2008. Gjithashtu, në vlerësimin përfundimtar, Komisioni mbajti në konsideratë faktin se në vitin 2004 mund të qenë e vështirë për subjektin të paraqiste shkaqe që kishin lidhje me presionin për shkak të ushtrimit të detyrës si gjyqtar. Fakti që subjekti, realisht, ka paraqitur një kërkesë për azil politik në SHBA, e cila i është pranuar, tregon që ai ka pasur (dhe) arsye të tjera që e kanë nxitur të dorëhiqet nga detyra (të cilat nuk përjashtojnë shkaqet e paraqitura në KLD) dhe për të cilat, ka bërë kërkesën për azil politik, arsye të cilat me të drejtë ka refuzuar t'i bëjë publike përpara Komisionit, në ushtrim të së drejtës së mosdhënies së informacionit. Komisioni e vlerëson të bazuar pretendimin e subjektit se ligji amerikan dhe ai ndërkombëtar garanton mosdhënien e informacionit për arsyet e azilit. Sipas publikimit në internet të aktit, Kodi i Rregulloreve Federale, Titulli 8 – Të huajt

dhe Kombësia <sup>118</sup>, Seksioni. 208.6, përhapja ndaj palëve të treta, ndër të tjera, përcaktohet se: “(a) informacioni që përmban ose ka të bëjë me çdo kërkesë për azil nuk do të përhapet pa pëlqimin me shkrim të aplikantit, përveç rasteve kur lejohet nga ky seksion ose sipas gjykimit të Prokurorit të Përgjithshëm”.

**115.9.** Në përfundim të procesit nuk u vërtetua asnjë fakt a rrethanë që të hidhte dritë mbi dyshimet e ngritura në median *online*, sipas së cilës subjekti është përfshirë në veprime korruptive përpara se të transferohej në SHBA, referuar fakteve si vijojnë:

- i) dorëheqja e subjektit nga funksioni i gjyqtarit nuk ka lidhje me ndonjë veprim të parregullt gjatë ushtrimit të detyrës, pasi nuk u vërtetua (dhe nuk ka pasur asnjë të dhënë të bazuar në prova) që përpara largimit në SHBA, ndaj tij të ishte marrë ndonjë masë disiplinore apo të kishte ndonjë kallëzim a procedim penal në ngarkim të tij;
- ii) nuk ka pasur asnjë provë apo të dhënë, sipas së cilës subjekti të ketë blerë pasuri në SHBA në vitin 2003 kur është sistemuar për të banuar aty familjarisht e deri në vitin 2012, kur ka blerë shtëpinë së bashku me vëllain e tij. Përkundrazi, gjatë kësaj periudhe, subjekti ka deklaruar dhe vërtetuar se ka banuar me qira në shtetin amerikan;
- iii) të gjitha këto rrethana tregojnë se largimi i subjektit në SHBA nuk ka qenë për të fshehur, justifikuar apo shmangur pasoja të veprimeve të paligjshme të tij.

#### **Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**

**116.** Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:

- i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
- ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.
- iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
- iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. SEANCAT DËGJIMORE**

Në datat 15.2.2022 dhe 24.3.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesve ndërkombëtarë Elka Ermenkova dhe Gerrit Sprenger u zhvilluan seancat dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi. Gjatë seancave dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime

<sup>118</sup><https://www.govinfo.gov/content/pkg/CFR-1998-title8-vol1/pdf/CFR-1998-title8-vol1.pdf>

të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejuara nga anëtarët e trupit gjykues. Në datën 25.3.2022 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi.

## **V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancave dëgjimore. Në të gjitha komunikimet z. Kastriot Gramshi ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar e duke paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar pretendimet e tij. Gatishmëria dhe qëndrimi bashkëpunues gjatë gjithë procesit janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Kastriot Gramshi ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi kreu bisedimet për marrjen e vendimit në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kastriot Gramshi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.3.2022.

**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*